

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER: PEDAGOGJI E PËRGJITHSHME



TEZA MASTER

**PËRCEPTIMET E BASHKËSHORTËVE DHE TË
ORGANIZATAVE JOQEVERITARE PËR NDARJEN E TË
DREJTAVE DHE PËRGJEGJËSIVE NË BASHKËSHORTËSI**

Mentori: Demë Hoti

Kandidatja: Bjondina Çanta

Prishtinë, Mars, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER: PEDAGOGJI E PËRGJITHSHME



MASTER THESIS

**PERCEPTIONS OF SPOUSES AND NON-
GOVERNMENTAL ORGANIZATIONS ON SHARING
RIGHTS AND RESPONSIBILITIES IN MARRIAGE**

Mentori: Demë Hoti

Kandidatja: Bjondina Çanta

Prishtinë, Mars, 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	3
ABSTRAKT	7
ABSTRACT	8
HYRJJE	9
Objekti i studimit	9
Pyetjet e hulumtimit	10
Hipotezat	10
1 SHQYRTIMI I LITERATURËS	11
1.1 Konceptet familje, bashkshortësi, bashkëshort/e, rol gjinor	11
1.2 Barazia gjinore në familje	12
1.3 Modelet e reja në funksion të strukturimit të familjes mbi bazën e aktiviteteve që kryejnë	13
1.3.1 Ndryshimet në jetën familjare	13
1.3.2 Inkuadrimi i grave në punën me pagë	15
1.4 Hendeku gjinor në ndjekjen e karrierës	16
2 ROLET GJINORE	18
2.1 Transmetimi vertikal i roleve gjinore	19
2.1.1 Familja dhe legjisllacioni	20
2.1.2 Familja dhe kultura	20
2.1.3 Rolet shoqërore dhe stereotipet gjinore në Kosovë	21
2.2 Puna në familje dhe rolet gjinore	22
2.2.1 Roli gjinor i gruas në ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në familje	23
2.2.2 Roli gjinor i burrit në ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në familje	24
2.3 Lloji i punëve në familje në kuadër të dallimeve gjinore biologjike	27
3 Koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore të bashkëshortëve në familje	30
3.1 Kujdesi për fëmijët	30
3.2 Mëmësia	31
3.3 Atësia	33
3.3.1 Prindërimi dhe karriera	34
4 MAKROPOLITIKAT PËR NDARJE MË TË DREJTË TË PUNËVE NË FAMILJE DHE NDIKIMI I TYRE	
36	

4.1.1	Përfshirja e grave në tregun e punës	37
4.1.2	Kuotat e babait apo pushimi i atësisë	38
4.1.3	Subvencionet për kujdesin për fëmijë	40
4.2	Kontributi i OJQ-ve në ndarjen më të drejtë të punëve në familjet kosovare	40
4.2.1	Demokracia në zhvillim (D4D).....	40
4.2.2	Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)	41
5	METODOLOGJIA.....	44
5.1	Pjesëmarrësit	44
5.2	Metodat e hulumtimit	44
5.3	Pritshmëritë në lidhje me përdorimin e rezultateve të hulumtimit	45
5.4	Procesi i mbledhjes së të dhënave.....	45
6	REZULTATET	47
6.1	Rezultatet e pyetësorit.....	47
6.1.1	Të dhënat demografike.....	47
6.1.2	Qëndrimi i pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkshortësi	49
6.1.2.1	Ndikimi i faktorëve bio-social në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkshortësi.....	50
6.1.2.1.1	Ndikimi i moshës në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen tradicionale të të drejtave dhe përgjegjësive në bashkshortësi.....	51
6.1.2.1.2	Ndikimi i nivelit arsimor në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkshortësi.....	53
6.1.2.1.3	Ndikimi i statusit të punësimit në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkshortësi.....	56
6.1.2.1.4	Ndikimi i strukturës së familjes, ku pjesëmarrësit jetojnë në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkshortësi	58
6.1.3	Ndarja e punëve në familje në mes të bashkshortëve	60
6.1.4	Koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore të bashkshortëve në familje.....	63
6.1.4.1	Koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore të bashkshortëve në familje në raport me nivelin arsimor të pjesëmarrësve	63
6.1.4.2	Koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore të bashkshortëve në familje në raport me statusin e punësimit të pjesëmarrësve.....	66
6.1.4.3	koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore të bashkshortëve në familje në raport me strukturën e familjes, ku ata jetojnë.....	68

6.1.5	Kujdesi për fëmijë	70
6.1.5.1	Ushqyerja	70
6.1.5.2	Larja.....	71
6.1.5.3	Ndrirrimi i pelenave	72
6.1.5.4	Kujdesi gjatë natës	72
6.1.5.5	Tregimi i përrallave para gjumit.....	73
6.1.5.6	Dërgimi dhe marrja nga çerdhja/shkolla dhe ndihma në mësimë	74
6.1.5.7	Shëtitja në park apo lodra për fëmijë	74
6.1.5.8	Sigurimi i të mirave materiale për rritjen e fëmijëve.....	75
6.1.6	Marrja e përgjegjësive të kujdesit për fëmijë në mungesë të bashkëshortit/ es	76
6.1.7	Qëndrimi i pjesmarrësve në lidhje me ideologjinë për kujdesin e magët për fëmijët nga ana e nënave të punësuarë në raport me statusin e punësimit.....	77
6.1.7.1	Qëndrimi i grave në lidhje me ideologjinë për kujdesin e magët për fëmijët nga ana e nënave të punësuarë në raport me statusin e punësimit.....	77
6.1.7.2	Qëndrimi i burrave në lidhje me ideologjinë për kujdesin e magët për fëmijët nga ana e nënave të punësuarë në raport me statusin e punësimit.....	78
6.1.8	Qëndrimi i pjesëmarrësve në lidhje me pushimin e atësisë	78
6.1.9	Qëndrimi i pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e pushimit prindëror	79
6.2	Rezultatet e intervistës	81
6.2.1	Të dhënat demografike dhe sociale të të intervistuarve	81
6.2.2	Përceptimi i OJQ-ve për rolet gjinore dhe diskriminimit gjinor në familje	81
6.2.3	Përceptimi i OJQ-ve për ndikimin e faktorëve biologjik në ndarjen gjinore të punës	83
6.2.4	Ndikimi i përgjegjësive familjare në ngritjen në karrierë	83
6.2.4.1	Përceptimi i OJQ-ve për dallimet gjinore në lidhje marrjen përsipër të përgjegjësive familjare për të lënë menjëanë karrierën	84
6.2.4.2	Ndikimi i rritjes së kapacitetit në çerdhet publike dhe në shtëpitë e të moshuarve në punësimin më të madh të grave?	84
6.2.5	Përceptimi i OJQ-ve në lidhje me ndarja e të drejtave dhe përgjegjësive në bashkshortësi dhe të kujdesit për fëmijët.....	85
6.2.6	Përceptimi i OJQ-ve në lidhje me ligjin në fuqi për pushimin e lehonisë	86
7	DISKUTIMI.....	88
7.1	Hipoteza e parë: Gratë janë më të ngarkuara me punë të shtëpisë se sa burrat, Për kryerjen e obligimeve ditore në familje ato shpenzojnë 2 herë më shumë kohë se sa burrat është konfirmuar ..	88

7.2	Hipoteza e dytë: Ideologjia gjinore ndikon në qëndrimin e grave dhe të burrave në lidhje me ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare është konfirmuar	89
7.2.1	Ndikimi i ideologjisë gjinore në ndarjen tradicionale të punëve në familje	89
7.2.2	Ndikimi i ideologjisë gjinore në ndarjen e kujdesit për fëmijë	90
7.3	Hipoteza e tretë: makropolitikat adekuate ndikojnë në zbehjen e ideologjisë gjinore për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në bashkëshortësi është konfirmuar	91
7.3.1	Ndikimi i krijimit të institucioneve shtetërore në zbehjen e rendit zakonor të manifestuar me ideologji të fortë gjinore për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në bashkëshortësi	91
7.3.2	Ndikimi i punësimit në intenzitetin e përfshirjes së grave në punët e shtëpisë.....	92
7.3.3	Ndikimi i punësimit në intenzitetin e përfshirjes së burrave në punët e shtëpisë	93
8	PËRFUNDIM	94
8.1	Konkludime	94
8.2	Rekomendime	95
8.3	<i>Kufizimet e studimit dhe rekomandime për hulumtime të mëtejshme</i>	96
8.4	Përmbledhje.....	97
9	LITERATURA	99
9.1	Burimet nga interneti.....	103
	Shtojcë	104
	Shtojca I: Pyetësi.....	104
	Shtojca II – Protokoli i Intervistimit.....	108

ABSTRAKT

Në shoqëritë pakriakale ndarja e punës së paguar dhe të papaguar është pasojë e ekzistencës së roleve gjinore, falë të cilave arrihet stabiliteti në funksionimin e familjes dhe negociatat e bashkëshortëve për mënyrën e ndarjes së punëve në familje janë të panevojshme. Secili nga bashkëshortët, ka rolin e vet dhe përmbushë obligimet që ka mësuar nga fëmijëria. Për zhdukjen e këtyre roleve është bërë luftë e gjatë, falë së cilës përveç punëve brenda shtëpisë, gruas i është shtuar edhe vendi në tregun e punës, përderisa roli i burrit ka mbetur i njëjtë.

Me qëllim të identifikimit të ekzistencës së roleve gjinore në Kosovë dhe mënyrës së perceptimit të këtyre roleve, janë anketuar 152 prindër të fëmijëve më të vegjël se 5 vjeç, përgjigjet e të cilëve na kanë mundësuar të konkludojmë se 81% e punëve në familje, ndahen në mënyrë tradicionale: gratë pastrojnë, hekurosin, kujdesen për fëmijë...; ndërsa burrat kujdesen për automobilin, riparimet në shtëpi,... Edhe gjatë kujdesit për fëmijë, burrat përzgjedhin detyrat më argëtuese: shetisin me fëmijë, i dërgojnë në kopsht..., kurse gratë i ushqejnë, lajnë, ua ndërrojnë pelenat, etj. Një ndarje të tillë, burrat e perceptojnë si të drejtë. Ata madje e kundërshojnë futjen e pushimit të atësisë në ligjin e punës, kurse gratë iu kanë nënshtruar sistemit patriakal dhe hezitojnë të shfaqin qëndrimin e tyre kundër kësaj ideologjie, edhe pse një ndarje të tillë e perceptojnë si jo të drejtë.

Këto rezultate tregojnë se ideologjia gjinore për ndarjen e detyrave në mes të bashkëshortëve luan rol kryesorë, mposhtja e së cilës është në program të shumë OJQ-ve, por për tu përmirësuar gjendja, është e domosdoshme që lufta për barazi gjinore të bëhet pjesë e strategjisë kombëtare, që përmes ligjit për pushimin e atësisë, përfshirjes masive të grave në tregun e punës dhe hapjes së kopshteve për fëmijë, të ndikojë të ndërthurjen e roleve gjinore në familje dhe shoqëri.

Fjalët kyçe: role gjinore, stereotipa gjinor, punë në familje, të drejta dhe përgjegjësitë, bashkëshortë, bashkëshortësi

ABSTRACT

In patriarchal societies the division of paid and unpaid work is a consequence of the existence of gender roles, thanks to which stability is achieved in the functioning of the family and the negotiations of the spouses on the way of division of work in the family are unnecessary. Each of the spouses has his / her role and fulfills the obligations he / she learned from childhood. To eliminate this traditional separation of tasks, long battles have been done, thanks to which, in addition to housework, the woman has been given a place in the labor market, while the role of the husband has remained the same.

In order to identify the existence of gender roles in Kosovo and the way of perception towards these roles, 152 parents of children under the age of 5 were surveyed, whose responses included 81% in a traditional way: women clean, iron, take care of children ...; men take care of the car, repairs at home,... Even when caring for children, men choose the most fun tasks: walking with the children, sending them to the garden..., leaving the women, change diapers, etc. Men perceive such a division as right way. They even oppose the introduction of paternity leave in the labor law, while women have submitted to the patriarchal system and are reluctant to express their opposition to this ideology, even though they perceive such a division as unjust.

These results show that the gender ideology of segregation of responsibilities between spouses plays a key role, the defeat of which is in the program of many NGOs, but in order to improve it is necessary for the national struggle to be equal. Through the law on paternity leave, the mass inclusion of women in the labor market and opening of kindergartens for children, to influence the interplay of gender roles in the family and society.

Key words: gender roles, gender stereotypes, family work, rights and responsibilities, spouse, marriage

HYRJE

Përpjekjet për të kuptuar më mirë se si gratë dhe burrat ndajnë punën e paguar dhe të papaguar në familje, kanë qenë dhe mbeten objekt studimi i shumë hulumtimeve në mbarë botën. Pjesa dërmuese e hulumtimeve të tilla tregojnë se ndarja e të drejtave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve nuk është simetrike. Si pasojë e kulturës patriakale, ideologjisë gjinore për ndarjen e punëve në familje, por edhe faktorëve të paevitueshëm biologjik, gratë janë më të involvuara në punët e shtëpisë dhe në kujdesin ndaj fëmijëve. Ndarja më simetrike e të drejtave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve në familje, bëhet në shtetet ku janë përdorur strategji të ndryshme për të inkuadruar burrat në punët e shtëpisë, që janë: inkuadrimi masiv i grave në tregun e punës, pushimet e atësisë dhe kuotat e babait, lufta për përmbysjen e stereotipave gjinorë, etj. Meqë në Kosovë nuk ka pasur iniciativa të tilla, madje deri në periudhën e pas luftës, si pasojë e mospërfshirjes së popullsisë në institucionit e shtetit okupues, në shumicën e familjeve ka ekzistuar një kulturë patriakale, ku gruaja ka qenë e privuar nga çdo e drejtë, natyrën e hulumtimit e kemi formuluar duke u nisur nga mënyra e ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare dhe faktorët që ndikojnë në ndarjen simetrike/asimetrike të këtyre përgjegjësi.

Objekti i studimit

Objekti i studimit të këtij punimi mund të përkufizohet nga dy perspektiva. Nga këndvështrimi i bashkëshortëve, duke u nisur nga fakti se vet bashkëshortët janë ata të cilët ballafaqohen me detyra dhe përgjegjësi në familje, dhe shumica prej tyre mundohen të gjejnë mënyra të përshtatshme për ta bërë një ndarje, që e konsiderojnë të drejtë.

Duke qenë se mënyra e ndarjes së përgjegjësi në familje është një pasqyrë e interesit të shtetit që përmes rregullimit të legjislacionit dhe strategjive të ndryshme ndikon në mënyrën e jetesës së secilës familje, e shohim të rëndësishme ta analizojmë legjislacion në fuqi dhe shkallën e përshtatjes me nevojat e shoqërisë.

Këto dy perspektiva do të na mundësojnë që të paraqesim gjendjen reale të ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare, si dhe problemet që shkaktojnë ndarjet jo simetrike të këtyre përgjegjësi në vendin tonë.

Pyetjet e hulumtimit

Pyetja kërkimore është:

Si ndikon ideologjia gjinore në ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësitë në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare?

Nënpyetja:

A ekziston ndonjë strategji kombëtare, përmes së cilës ndikohet në ndarjen më të drejtë në mes të këtyre përgjegjësive?

Hipotezat

Duke u bazuar në pyetjet kërkimore që ky hulumtim do të tentojë t'u përgjigjet, janë ngritur hipotezat në vijim:

H1: Gratë janë më të ngarkuara me punë të shtëpisë se sa burrat. Për kryerjen e obligimeve ditore në familje ato shpenzojnë 2 herë më shumë kohë se sa burrat.

H2: Ideologjia gjinore është faktori kryesor që ndikon në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare.

H3: Makropolitikat adekuate ndikojnë në zbehjen e ideologjisë gjinore për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në bashkëshortësi.

Në këtë pjesë të punimit u munduam të paraqesim një pasqyrë të përgjithshme të problemeve me të cilat lidhet ndarja e të drejtave dhe përgjegjësive në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare, nevoja e trajtimit të të cilëve ishte arsye për kryerjen e këtij studimi. Këtë pjesë e përmbyllëm me paraqitjen e pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të studimit. Në kapitulli I do të ofrojmë një përmbledhje të hollësishme të literaturës, duke përfshirë pasqyrën e studimeve dhe kërkimeve mbi konceptet e perceptimit të mënyrës së ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësive në mes të bashkëshortëve në familje dhe faktorëve që ndikojnë në ndarjen simetrike/asimetrike të këtyre përgjegjësive. Në Kapitullin, ku përshkruhet metodologjia e hulumtimit do të paraqiten karakteristikat e mostrës, instrumentet, metodat e mbledhjes së të dhënave, si dhe qasja ndaj analizës. Kapitulli i rradhës paraqet në detaje gjetjet e studimit. Në fund, do të diskutohen rezultatet, konkludimet kyçe dhe rekomandimet tona, do të shtjellohen pikat e forta dhe kufizimet e studimit, si dhe udhëzimet e ardhshme për kërkime.

1 SHQYRTIMI I LITERATURËS

1.1 Konceptet familje, bashkshortësi, bashkëshort/e, rol gjinor

Familja përcaktohet nga një sërë përkufizimesh të cilat janë të kushtëzuara nga rrethanat gjeografike, kohore, shoqërore dhe kulturore dhe ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëra-tjetra. Vetë prania e numrit të madh të përkufizimeve, tregon që sistemi i marrëdhënieve brenda familjes është shumë kompleks.

Nëse nisemi nga terminologjia. (në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe) familjen do ta përkufizonim si “*njësi të vogël të organizimit të jetës shoqërore, që përbëhet nga burri, gruaja, fëmijët ose edhe nga njerëz të tjerë të afërt të cilët jetojnë a banojnë bashkë.*” Një përkufizim i tillë, mund të konsiderohet i pranueshëm nëse do t’i referoheshim çështjeve të ndërlidhura me banim, lidhjeve të ngushta të bazuara në gjak ose martesë dhe kujdesit ndaj fëmijëve, por studimet për familjen përfshijnë koncepte më të gjera, siç janë: mënyra e organizimit të familjeve brenda një shoqërie të caktuar, mënyra e organizimit të jetës së përditshme brenda familjes dhe mënyra e perceptimit të kësaj mënyreje nga pjestarët e saj; rrethanat sociale të ofruara nga nivelet më të larta shoqërore për mënyrën e organizimit të jetesës; punësimi, kultura, niveli ekonomik, politikat për mirëqenie sociale, diverziteti dhe pabarazia gjinore, etj.

Duke u munduar t’i përmendim të gjitha konceptet e lartëpërmendura, familjen do ta përkufizonim si “*një grup individësh ku ekziston një lidhje ndërmjet brezave (d.m.th., gjendet një marrëdhënie prind-fëmijë). Anëtarët e familjes kanë kontakte të ngushta që karakterizohen nga angazhimi, besimi, respekti dhe ndjenja e detyrimit afatgjatë... Ata punojnë si një grup drejt plotësimit të nevojës reciproke, sipas Edwards & Graham (2009), dhe ndajnë të gjitha detyrimet që vijnë nga bashkëjetesa e përbashkët... Secili grup familjar kërkon të arrijë qëllimet e veta duke përvetësuar, alokuar dhe shpërndarë burimet (dmth., kohën, paratë, hapësirën dhe kontaktet e ngushta personale)*” (Dey, 2010).

Duke qenë se në të gjitha definicionet për familjen, përmendet lidhja e bashtëshortëve në martesë, po ndalemi në shpjegimin e koncepteve bashkëshort/e.

Konceptet bashkëshort/bashkëshorte, mund t’i shpjegojmë si *burri i martuar kundrejt gruas së vet apo gruaja e martuar kundrejt burrit të vet* (FGJSSH, 1980). Pra, nëse nisemi nga terminologjia, themi se bashkëshortët e lidhur në martesë krijojnë bashkëshortësi. Kjo lidhje

manifestohet në mënyra të ndryshme, varësisht nga faktorët social, kulturor e gjeografik, që ndikojnë në krijimin e lidhjes bashkëshortore dhe ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësive të përbashkëta në familje, që në shumicën e rasteve diktojnë rolet që bashkëshortët luajnë në jetën e njëri-tjetrit, në familje dhe shoqëri, pra, rolet gjinore.

Rolet gjinore, në familje përfshijnë një ndarje të të drejtave dhe përgjegjësive midis bashkëshortëve, në mënyrë të tillë që secili të jetë përgjegjës për detyra të ndryshme që janë të nevojshme brenda familjes (Crossman, 2020).

Sociologu amerikan Talcott Parsons (në: Crossman, 2020) shkroi mbi këtë temë dhe përshkroi një teori të roleve brenda një martese, ku gratë/nënat luajnë rolin ekspresiv të një kujdestareje që kujdeset për socializimin dhe nevojat emocionale të anëtarëve të tjerë të familjes, ndërsa burri/babai ka për detyrë të fitojë para për të mbajtur familjen. Në përputhje me këtë mendim, një martesë shpesh shërben për funksionin e diktimit të statusit shoqëror të bashkëshortëve dhe çiftit, si dhe krijimin e një hierarkie pushteti midis çiftit.

Për prezencën e një mendësie të tillë në Kosovë flasin shpjegimet plotësuese të koncepteve bashkëshort/e në FGJSSH: *Një bashkëshort i ndershëm* përkatësisht *Një bashkëshorte dhe nënë e mirë*. Ku koncepti bashkëshorte na aludon në rolin e saj, si kujdestare e fëmijëve, përderisa koncepti bashkëshort nuk është shoqëruar me asnjë term që na aludon në jetën brenda shtëpisë.

1.2 Barazia gjinore në familje

Familja është njësia bazë e shoqërisë, gjithçka fillon në familje dhe transmetohet në shoqëri. Kultura e organizimit të familjes, në të gjitha studimet trajtohet se është faktori kryesorë që dikton diskriminimin gjinorë në familje, i cili diskriminim transmetohet pastaj edhe në shoqëri. Baza patriakale e shumicës së familjeve në Kosovë është pasojë e mosbesimit të popullsisë në qeveritë e kaluara, kryesisht pushtuese dhe përzgjedhjes së organizimit të familjes në baza zakonore, i cili gruan e privonte nga shumë të drejta si të karakterit politik, ashtu edhe të atij ekonomik dhe social (Latifi, 2016). Si rezultat i organizimit të tillë të familjeve për shekuj me radhë, rolet gjinore të bashkëshortëve në familje janë prezente edhe sot, prezenca e të cilëve manifestohet me përjashtimin e vullnetshëm të shumë grave nga aktivitetet politike, kulturore e shoqërore.

Sipas Rrahmanit (2020), përveç fuqisë absolute të së drejtës zakonore, e sidomos në sektorin shtëpiak dhe në rregullimin e marrdhënieve në çift, ekzistenca e stereotipave gjinorë dhe ndarja

gjinore e të drejtave dhe përgjegjësive në familje, lidhet edhe me miratimin e Ligjit për Barazi Gjinore, që në Kosovë nuk ka qenë në fuqi deri më sot, respektimi i të cilit ende nuk është shndërruar në normë. Për pasojë, shumë gra kosovare as nuk e dallojnë diskriminimin gjinorë dhe shkeljen e të drejtave të tyre në familje dhe më gjerë.

Është e vështirë të përkufizohet barazia gjinore duke përfshirë gjithë elementet që karakterizojnë thelbin e saj. Meqenëse në këtë punim po trajtojmë ndarjen e përgjgjësive në mes të bashkëshortëve, po ndalemi në mosvlerësimin e kontributit të grave në punët e shtëpisë dhe kujdesit për fëmijë (2020), i cili sipas Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore (2015) vlerësohet si kontribut për zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë, por si pasojë e mosvlerësimit të këtij kontributi, gratë që kanë të ardhura mujore më të vogla ose nuk janë të punësuar, nuk marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me shit-blerjen e pronave familjare (Buxhetimi gjinor në Kosovë, 2020), madje edhe gjatë divorceve (në shumë raste) nuk u kompenzohet ky kontribut (2020).

1.3 Modelet e reja në funksion të strukturimit të familjes mbi bazën e aktiviteteve që kryejnë

1.3.1 Ndryshimet në jetën familjare

Gjatë dekadave të fundit, tregues të ndryshëm na shpiejnë në konkludimin se familjet dhe jeta familjare në shtetet e zhvilluara po ndryshojnë ndjeshëm. Ndryshimet që po ndodhin në fushën e sociologjisë familjare dhe ato që e përcaktojnë jetën familjare, nuk janë thjesht rezultat i ndryshimeve brenda familjes, por përfshihen në kontekstin e ndryshimeve më të gjera sociale (Stavb 2001).

Pas luftës së fundit në Kosovë, janë bërë dhe po vazhdojnë të bëhen ndryshime të mëdha edhe në organizimin e familjeve kosovare. Krijimi i institucioneve legjislative, kulturore e sociale të shtetit të Kosovës, hapja e vendeve të punës, hapja e qendrave universitare në komunat e mëdha, etj. janë manifestuar me ndryshime të dukshme edhe në jetën familjare. Struktura e përbërjes së familjeve në Kosovë ka ndryshuar në favor të familjeve bërthamë dhe ashtu si në vendet e tjera, nataliteti ka rënë. Krahasuar me periudhën e paraluftës, numri i lindjeve ka shënuar ulje. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) në 1997 janë regjistruar 42.920 lindje, kurse në vitin 2019 janë regjistruar 21.798 lindje (ASK, 2019). Moshja e nënës në lindjen e fëmijës së parë është rritur, gjithashtu është rritur edhe numri i fëmijëve të lindur jashtë martesë. Në vendet fqinje, kanë

ndodhur edhe ndryshime strukturore në mëmësi dhe është shfaqur atësia "e re", e si pasojë, kanë ndodhur edhe ndryshime në ndërtimin seksual të punës në familje, ku theksohet gjithnjë e më shumë barazia e të dy bashkëshortëve.

Përveç ndryshimeve të lartëpërmendura që po ndodhin brenda jetës familjare, ka edhe ndryshime që kanë të bëjnë me shoqërinë më të gjerë, që gjithashtu ndikojnë në jetën familjare. Këto janë ndryshimet në tregun e punës që kanë prekur kryesisht jetën e grave, plakjen e popullatës, etj., si dhe në rritjen e lirisë për të zgjedhur bashkëshortin/en, lirisë seksuale, njohjen e të drejtave të grave dhe të fëmijëve.

Përveç numrit në rënie të natalitetit, në periudhën e pas luftës ka ndryshuar edhe ndërtimi strukturor i familjes kosovare, i cili deri atëherë është dalluar për nga solidariteti social (Kamberi, 2017). Familjet me 2 e më shumë bërthama që kanë qenë prezente, sidomos në zonat rurale, tani më janë zëvendësuar me familje bërthamë dhe familje të gjera, ku për shkak të mungesës së ndihmës dhe kujdesit social, ekziston një ndihmë reciproke ndër breza (Latifi, 2016).

Edhe familja patriakale, me kalimin e kohës është moderuar dhe kështu një model i tillë familjar në aspektin e socializimit është moderuar dhe janë shfaqur dukuri që në periudhën e para luftës ishin tema tabu, si p.sh. shkaqja e prirjes për martesë dhe familje "të hapur", me të drejta, detyrime e përgjegjësi të barabarta; prirjes për barazi e ndihmesa të përbashkëta; prirjes për largimin e jetës personale nga kriteri moral, etj. Modeli familjar ka ndryshuar dhe po ndryshon edhe në aspektin e planifikimit familjar, me shfaqjen e familjeve të riorganizuara (me fëmijë nga martesa të mëparshme apo familje të përbëra nga partner të të njejtës gjini), parapëlqimit për të mos lindur fëmijë, për të birësuar e marrë në kujdestari, etj. (Kamberi, 2017). Vlenë të theksohet se partnerët në familjet e riorganizuara, kanë më pak pamje tradicionale për kryerjen e roleve gjinore dhe ndajnë detyrat dhe përgjegjësitë në familje në mënyrë të barabartë (Coltrane 2000). Prezenca e këtyre familjeve ka bërë që të ndikojë, që përgjegjësitë dhe të drejtat familjare që ndahen në mënyrë më simetrike edhe në familjet bërthamë, me të cilat kanë kontakte të vazhdueshme. Kjo na bënë që të mbështesim edhe një herë tezën që shoqëria është ajo që ka ndikim vendimtarë në krijimin e roleve gjinore dhe ndarjen e punës në bazë të gjinisë..

1.3.2 Inkuadrimi i grave në punën me pagë

Kur flasim për ndryshimet në jetën familjare, nuk mund të anashkalohet inkuadrimi i grave në tregun e punës, që është ngjarja më e rëndësishme në historinë e zhvillimit të jetesës familjare dhe në historinë e luftës për barazi gjinore në përgjithësi.

Në kohën kur Parson (në: Hakim, 2004) përmendi familjen bërthamë, ekzistonte një model i veçantë i etikës së punës që fliste për burrin si përgjegjës për mirëqenien materiale të familjes. Me zhvillimin e kapitalizmit industrial, veçanërisht me përhapjen e tij, brenda familjeve kishte lëshuar rrënjë një model i ri i punës. Si punë, konsiderohej aktiviteti që bëhej jashtë shtëpisë për arsye të përfitimeve materiale dhe kryhej nga burrat, ndërsa aktiviteti i grave kufizohet brenda sferës private, ku përfshihet prodhimi shtëpiak dhe shërbimet që i referohen anëtarëve të familjes.

Arsyeja e mostrajtitimit të punëve që bëhen në sferën private si punë formale, ka rrënjët në ideologjinë borxheze (në shek. e 19), kur puna në shtëpi konsiderohej si punë e grave që bëhet nga dashuria. Nga kjo kohë, dimensionimi emocional i punës në familje vazhdoi të përdoret si një argument për ta përkufizuar këtë punë si joproduktive, si një "punë dashurie" që nuk duhet t'i nënshtrohet instrumentalizimit të tregut (Novak, 2015, Studen, 2015).

Pjesëmarrja absolute e burrave në punën me pagesë, vazhdoi deri në kohën e Luftës së Dytë Botërore, kur për shkak të mungesës së burrave që shkuan në luftë, numri i grave të punësuar ishte mjaft i lartë. Pas luftës, kur burrat u kthyen nëpër vendet e tyre të punës, edhe gratë u kthyen në "vendet e tyre të punës" në shtëpi, kurse në punën me pagë, një numër i vogël i tyre, vazhdoi të punojë me kohë të pjesëshme. Pavarësisht faktit se burrat zunë vendet e tyre që kishin para luftës, sistemi ishte thyer dhe gratë asnjëherë nuk u mbyllën më plotësisht.

Edhe pse nga kjo kohë gjendja është përmirësuar dukshëm në favor të grave dhe në shumë vende, kjo mënyrë e ndarjes së punëve njihet si çështje që i takon historisë, në vendet në zhvillim, ku merr pjesë edhe Kosova, ende vërehen elemente të këtij sistemi. Këto elemente po i paraqesim duke krahasuar të dhënat për pjesëmarrjen e grave dhe të burrave në tregun e punës, pozitat e tyre në këtë treg, si dhe dallimet në paga.

- Pas Luftës së Dytë botërore për një kohë të gjatë, gratë vazhduan të kenë kontrata të veçanta të punës, paga më të ulta se burrat dhe punë të përkohshme,
- ushtruan profesione tipike për gra (teknike medicinale, edukatore, etj.) dhe

- kishin vende të punës më pak kërkuese (Koliqi: 2009).

Sa i përket statistikave për burrat dhe gratë në Kosovë:

- Në vitin që po lëmë pas, në Evropë ishin të punësuar 66.5 për qind gra, në krahasim me 78.5 për qind burra (Eurostad, 2019), kurse në Kosovë kanë qenë të punësuar 12.3 për qind gra në krahasim me 46.6 për qind burra (ASK, 2018).
- Gjithashtu, numri i burrave që punojnë në vende më të paguara dhe në pozita vendimmarrëse është më i madh sesa ai i grave (81% në krahasim me 19%) (RrGK, 2017).
- Edhe sot, numri i grave që ushtrojnë profesionin e edukatores në Kosovë, që konsiderohet si profesion tipik për gra është 576. Këtë profesion, në vitet 2017/2018 e kanë ushtruar vetëm 2 burra, çka tregon se burrat në Kosovë, konsiderohen si të papërshtatshëm për tu kujdesur për fëmijët (Gratë dhe Burrat në Kosovë 2016-2017).

Dallime marramendëse, kemi në postet drejtuese të ministrive, agjensive ekzekutive dhe në nivele lokale. (shih kapitullin 1.4 të këtij punimi).

1.4 Hendeku gjinor në ndjekjen e karrierës

Orientimi në karrierë bëhet një pjesë e rëndësishme e jetës familjare të një individi kur ndikon në mënyrën e vlerësimit të roleve të tij në jetë. Nëse një individ është i orientuar në karrierë, kjo do të thotë se ai ia kushton një pjesë të rëndësishme të kohës së tij punës, që do të thotë se në rolin e pjesëtarit të familjes nuk është shumë prezent (Encyclopedia.com, 2020).

Hulumtimet e fundit tregojnë se ndjekja e karrierës, nuk është e ndarë në mënyrë të barabartë midis gjinive dhe midis punonjësve të aftë e të kualifikuar, dhe atyre më pak të aftë e me kualifikim më të ulët. Burrat tregojnë dëshira dhe impulse më të mëdha për përparim në vendin e punës se sa gratë. Sa i përket karrierës së grave, ajo vazhdon me pengesa të natyrave të ndryshme. Nizam, et. al (2018) kur flasin për aftësitë e grave dhe ngritjen e tyre në karrierë, përmendin faktorët që ndikojnë në të, që janë: vazhdimësia e perceptimeve të shekullit 19-të, në lidhje me karrierën e grave nga punëdhënësit; nënshtrimi i grave në lidhje me rolin e tyre tradicional në shoqëri dhe heshtja për të sfiduar mendësinë e krijuar shekuj me rradhë, si dhe fakti që shumica e vendeve udhëheqëse janë në thelb patriarkal (ku dominojnë burrat, të cilët kanë krijuar mjedise të vështira për të prosperuar gratë).

Përveç faktorëve social dhe kulturor, ata përmendin edhe përgjegjësitë familjare të grave që i detyrojnë ato ta ndërpresin karrierën në faza të caktuara të jetës së tyre. Këto faza janë: faza e hershme, kur gratë lënë pas dore karrierën për shkak të shqetësimeve martesore dhe të lindjes, si dhe kujdesit për fëmijët; faza e mesme, për shkak të rritjes së përgjegjësive familjare dhe nevojës për tu kujdesur për prindërit e moshuar dhe faza e vonë, për shkak të nevojës për t'u kujdesur për partnerët dhe nipërit e tyre (Nizam, 2018).

Duke pasur parasysh faktin se 40 për qind e të punësuarve në botë, e humbin vendin e punës për shkak të përgjegjësive të kujdesit ndaj fëmijëve, mund të themi se faza më kritike e ndërprerjes së karrierës është faza e hershme. Ndërprerja e karrierës në këtë fazë, kushtëzohet sidomos nga mungesa e institucioneve përgjegjëse për kujdes, që i detyron nënat ta braktisin vendin e punës për shkak të pamundësisë për të gjetur kujdesin e duhur për fëmijët (Enciclopedia.com, 2020). Ky problem është evident edhe në Kosovës, ku çështja e kujdesit për fëmijë është përgjegjësi që e mbajnë ekskluzivisht gratë. Mundësia e regjistrimit të fëmijëve në kopsht, për t'i mundësuar nënës ndjekjen e karrierës është shumë e vështirë. Për shkak të numrit të vogël të kopshteve publike për fëmijë dhe kostos së lartë të kopshteve private në krahasim me nivelin financiar në vend, 28 për qind e grave të papunësuar në Kosovë nuk kërkojnë punë (Abazi, 2017). Edhe gratë e punësuar, që arrijnë ta mbajnë vendin e punës dhe të kthehen me sukses pas pushimit të lehonisë, për shkak të mungesës së tyre të gjatë, ngritja e tyre në karrierë bëhet më e vështirë (Abazi, 2017). Ekzistencën e këtyre problemeve për orientimin e grave kosovare në karrierë, e kanë mundësuar jo vetëm faktorët social e kulturor, por edhe iniciativat shtetërore e legjislacioni në fuqi, sipas të cilit barra kryesore për rritjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve i takon nënës. Në këtë rast po përmendim nenin 7, paragrafët 1, 4, 5, 7 dhe 8 të Ligjit për Pushimin e Lehonisë dhe Pushimit Prindëror të miratuar më 2018, sipas të cilit pushimi fillestar (prej 6 muajsh) i atësisë nuk mund të shfrytëzohet nga babai, përveç nëse nëna braktis fëmijën ose vdes. Poashtu, në planin strategjik të komunave nuk shihet ndonjë iniciativë për ndërtimin e kopshteve për fëmijë, që do të rriste kapacitetin e pranimit të fëmijëve dhe do të ndikonte në përfshirjen më të madhe të grave në tregun e punës. Në këtë rast po përmendim konkludimet e Pettit dhe Hook (në: Noonan, 2013) që zbuluan se pushimet prindërore në periudhë më të gjatë se 2 vjet, kanë një efekt negativ në mundësinë e punësimit të nënave të fëmijëve të vegjël, prandaj mundësia e nënave të reja për të mbetur gjithmonë të papunësuar është shumë e madhe.

Ekzistenca e problemeve të tilla na bënë të themi se vendosja nëse karriera është apo nuk është për gratë, është njësoj e vështirë sikur gjatë periudhës së borxhezisë, kur bëhej fjalë nëse gratë mund të bëjnë karrierë. Ligji për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror (2018) i detyron punëdhënësit që tre muajt e parë të pushimit të lehonisë, të bëjnë kompensim prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pagës bazë, prandaj, shumica e punëdhënësve në Kosovë, e sidomos ata të sektorit privat përpiqen të shmangin punësimin e grave që kanë predispozita për marrjen e pushimit të lehonisë. Në hulumtimin për joaktivitetin e grave në Kosovë, shumica e grave pjesëmarrëse janë deklaruar se gjatë intervistës së punës janë pyetur për jetën e tyre familjare dhe planet për të krijuar familje. Në hulumtime të tjera gratë raportojnë se nuk marrin oferta pune nëse kanë plane për të mbetur shtatzënë. Ndërsa, disa kanë raportuar se u janë anuluar kontratat e punës pasi kanë njoftuar punëdhënësin se janë shtatzënë (Rrahmani, 2020).

Këto fakte tregojnë se në Kosovë, ende ekzistojnë barrierat e nivelit social, kulturor por edhe legjislativ e shtetëror që i pengojnë gratë të bëjnë karrierë në mënyrë të njëjtë si burrat.

2 ROLET GJINORE

Bindjet se përveç dallimeve biologjike midis burrave dhe grave, ekzistojnë edhe dallime të tjera, që janë dallimet në sjellje, dallimet psikologjike dhe në personalite, janë prezente gjithandej. Prezente janë poashtu edhe bindjet për ekzistencën e dallimeve, të cilat nuk është e vështirë të vërehen, siç janë dallimet në pamjen fizike, veshje, sjelljen në publik dhe familje, në statusin shoqëror, preferencat për punë, etj. Prezenca e këtyre dallimeve, ka zgjuar kureshtjen e shumë studiuesve për të shqyrtuar çështjen se a janë këto dallime shprehje e ekzistencës së dallimeve biologjike midis gjinive apo ato janë krijuar për shkak të rolit të grave dhe burrave në shoqëri (Roof, 2020) .

Parson (në: Wikipedia.com, 2020) pohon se diferencimi i roleve sipas gjinisë është në funksion të ruajtjes së stabilitetit të familjes si nënsistem shoqëror, që luan një rol shumë të rëndësishëm në procesin e socializimit të fëmijës. Diferencimi më i rëndësishëm është ai i roleve në atësi dhe amësi. Sipas Parsonit, babai ka një rol instrumental. Ai kujdeset për të mirat materiale në familje dhe ruan marrëdhëniet familje-shoqëri, kurse nëna brenda familjes ka një rol ekspresiv.

Baza e rolit instrumental të babait është profesioni i tij nga i cili varet statusi i familjes. Nga kjo paraqitet skica për rolin e gruas brenda familjes, sipas së cilës ajo duhet të kujdeset për punët e shtëpisë dhe natyrisht të kujdeset për fëmijët (Novak 2015). Pra, sipas Parsonit dallimet biologjike midis gjinive, krijojnë themelet mbi të cilat ndërtohet ndarja e punëve midis gjinive.

Për shkak të funksionit biologjik të lindjes dhe ushqyerjes me gji, gruaja është e lidhur në shtëpi. Kjo teori është kundërshtuar nga shumica e sociologëve, ekonomistëve dhe antropologëve. Duke kundërshtuar këtë teori, në një studim thuhet se: “Vetëm gratë mund të lindin dhe të ushqejnë fëmijë, por gjinia e njerëzve që gatuajnë ose pastrojnë nuk është as fikse dhe as e paracaktuar”. Kulturat njerëzore janë të larmishme dhe pafundësisht të ndryshueshme. Zhvillimi i tyre detyrohet nga qëndrimet e shoqërisë e jo nga faktet e paevitueshme biologjike, prandaj, ndarja e punës sipas gjinive nuk është universale dhe nuk ka ndonjë arsye për të qenë e tillë (Novak, 2015). Me fjalë të tjera, njerëzit e kultivojnë sjelljen e pranueshme për burrat dhe gratë nga shoqëria, kështu që është kultura e shoqërisë ajo që ndikon më së shumti në krijimin e sjelljes mashkullore dhe asaj femërore. Pra, kultura e një shoqërie të caktuar përcakton se cilat role janë të pranueshme për anëtarët e një gjinie të caktuar.

2.1 Transmetimi vertikal i roleve gjinore

Pas diferencimit të roleve të bashkëshortëve në martesë, Parsons familjen e konsideron si fabrikë që prodhon personalitete njerëzore. Pra, personalitete që kopjojnë rolet e prindërve nga fëmijëria e hershme. Rolet shoqërore fillojnë të krijohen me krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve në mes të anëtarëve të familjes. Krijimi i këtyre marrëdhënieve fillon qysh në fëmijëri, kur nevoja për mbijetesë është primare, madje nëse marrim në konsideratë vendet në zhvillim, siç është Kosova, ku tregu i punës është i varfër dhe shteti nuk ofron kushte për pavarësi ekonomike, fëmijët, deri në një moshë të shtyer, varen nga familjarët për mbijetesën e tyre. Kjo varësi i lejon anëtarët më të moshuar, që të kërkojnë nga fëmijët të sillen në përputhje me rolet e paracaktuara në familje (IEMF, 2020). Në të njëjtën mënyrë mund të shprehemi edhe për pushtetin e anëtarëve më të fuqishëm ekonomikisht (burrave) në imponimin e rolit gjinor të anëtarët e varur (gratë dhe fëmijët).

Rolet shoqërore, brenda familjes aplikohen në mënyra të ndryshme. Sipas Latifit (2016), ndryshe nga vendet e zhvilluara, në Kosovë kopjimi i roleve të të rriturve është i lidhur ngusht me mënyrën e jetesës brenda familjes dhe strukturën e përbërjes së saj, e nëse marrim parasysh solidaritetin

ndërbrezësh në familjet kosovare, themi se në rastin e Kosovës në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me një transmetim ndër breza të roleve familjare, respektivisht gjinore (Elezi, 2017).

2.1.1 Familja dhe legjislacioni

Rolet familjare të paracaktuara dhe të dëshiruara në familje, në shumicën e rasteve ndikohen edhe nga rrethanat gjeografike e socio-politike, siç janë: vendbanimi, sistemi arsimor, feja, sistemi politik, etj. Kemi të bëjmë me koncepte kulturore e legjislative që ndikojnë në krijimin e sjelljeve shoqërore të individëve, ku gjinia është një paracaktim kyç për krijimin e statusit të tyre në shoqëri. Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë të prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, në krijimin e roleve gjinore ndikon edhe legjislacioni. Përmes tij paracaktohen elementet që përbëjnë njësinë familjare. P.sh. përcaktimi ligjor për numrin e partnerëve/partnereve të gruas ose burrit, që siç dihet në të kaluarën ka qenë i rregulluar në favor të burrave (Encyclopedia.com. 2020); Përcaktimi i bartjes së pasurisë familjare, që në Kosovë deri vonë bëhej sipas gjinisë, çka do të thotë se gjinia konsiderohej si faktori kryesor në krijimin e statusit familjar të secilit anëtarë (Latifi, 2016); Përcaktimi ligjor për pushimin e lehonisë, që siç dihet edhe sot ndikon në paracaktimin e pozitës së gruas si përgjegjëse kryesore për rritjen e fëmijëve etj.

2.1.2 Familja dhe kultura

Në krijimin e sjelljeve shoqërore të anëtarëve të familjes ndikon edhe kultura, p.sh. në shumicën e kulturave rolet e burrave dhe të grave dallohen në mënyrë absolute. Roli i burrit në kulturat e hershme përshkruhet si gjahtar-luftëtar dhe roli i gruas si mirëmbajtëse dhe kujdestare e fëmijëve. Me ndryshimin e kushteve të jetesës dhe me kërkesat e tregut të punës, rolet gjinore filluan të zbehen dhe gratë u inkuadruan në tregun e punës, pra në “botën mashkullore”. Mirëpo, inkuadrimi i burrave në “botën femërore” apo në punët e shtëpisë, mbetet çështje që kërkon angazhim të shtetit. Duke u marrë me këtë çështje Anvares and Miles (2008) (në: Elezi, 2017), konstatuan se edhe pse fëmijët në moshë të hershme krijojnë konceptet për rolet e tyre gjinore duke kopjuar prindërit, ndikimi i babait tek djali (transmetimi vertikal) nuk mund të izolohet nga ndikimi i shoqërisë (transmetimi indirekt), sepse vetë shoqëria ndikon në rolet shoqërore tek baballarët.

Pra secili ndryshim në shoqëri, duhet të fillojë nga familja, përmes shembullit të mirë të prindërve tek fëmijët.

2.1.3 Rolet shoqërore dhe stereotipet gjinore në Kosovë

Në shoqërinë moderne, rolet që gratë supozohet të kryejnë kanë të bëjnë me jetën private (me vlerë më të ulët shoqërore) dhe burrat supozohet të kryejnë role në jetën publike. Një ndarje e tillë e roleve është akoma e ngulitur në shoqërinë kosovare, në të cilën vlerat tradicionale janë ende të pranishme.

Rezultatet e hulumtimit nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (2013), kanë radhitur disa nga karakteristikat të stereotipeve për gratë në Kosovë, që janë: *Të gjitha femrat duhet të bëhen nëna, kjo është mënyra e vetme për të qenë të kënaqura në jetë; Vetëm femrat janë përgjegjëse për kujdesje ndaj fëmijëve dhe për punët e shtëpisë; Është e zakonshme që një femër t'i lë pas dore miqtë kur ka të dashur; Nuk është e pëlqyeshme që femra të punojë në një institucion, ku dominon numri i të punësuarve meshkuj*, etj. Kurse sa i përket stereotipeve për burrat, veçuan karakteristikat si: *Meshkujt duhet ta mbajnë familjen; Ata duhet të sigurohen që gratë e tyre të nderojnë të gjithë anëtarët e familjes; Nuk duhet të ndihmojnë me punët në shtëpi, pasi që kjo është punë e grave*. Për të verifikuar nëse këto tipare i dallojnë edhe tani stereotipet e grave, përkatësisht të burrave në shoqërinë tonë, QKSGJ më 2013 ka bërë një sondazh, rezultatet e të cilit tregojnë se mbi 40% e burrave dhe afër 40% e grave pajtohen me dallimin e roleve gjinore sipas karakteristikave të lartpërmendura. Rezultate të tilla tregojnë se në Kosovë është akoma prezente mendësia se roli i grave përcaktohet me kujdesin dhe edukimin e fëmijëve, kujdesin për shtëpinë dhe familjen, pastrimin, kujdesin për të moshuarit, madje edhe për bashkëshortin e tyre. Ndërsa roli i burrit përcaktohet si shtylla financiare që mban familjen, në këtë mënyrë përcaktohet edhe sundimi i tij mbi gruan (dhe fëmijët).

Prania e këtyre konstrukteve shoqërore të roleve "të përshtatshme" për gratë dhe burrat, që janë përcaktuar nga paragjykimet kulturore, zakonet, traditat por edhe interpretimet e besimeve dhe praktikave fetare (Rekomandimi KM/Rek: 2019), ka bërë që grave në Kosovë edhe sot tu ngarkohet roli shtëpiak si diçka e natyrshme, universale dhe e pashmangshme; Kosova të jetë një ndër vendet me nivelin më të ulët të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës; Në legjislacionin në fuqi, ende ekziston termi "pushim i lehonisë" e jo "leje prindërore", tekstet mësimore për shkolla fillore janë të mbushura me nëna në kuzhinë dhe baballarë me automobil apo me kravatë, etj. (Hernmarck Ahliny: 2020);

Ekzistenca e stereotipeve dhe e ndarjes së punës në bazë të dallimeve biologjike në Kosovë, vërehet më së miri në pozitat e punës, që janë tipike për gratë apo burrat, p.sh. në FSK deri në vitin 2017 vetëm 5 përqind e të punësuarve kanë qenë gra, kurse 95 përqind burra; Në policinë e Kosovës, vetëm 14 përqind kanë qenë gra, kurse 85 përqind burra. Dallime edhe më të mëdha ka pasur në pozitat drejtuese në ministri, agjenci ekzekutive dhe në nivelin lokal të administratës (5 me 70 ose 391 me 1031 në favor të burrave, etj) (Gratë dhe Burrat në Kosovë 2016-2017).

2.2 Puna në familje dhe rolet gjinore

Puna në familje është forma më e përhapur dhe një nga format më të rëndësishme të aktiviteteve joformale që plotësojnë nevojat e përditshme të një individi. Bëhet fjalë për një ndërthurje të veprimtarive të ndryshme të nevojshme për funksionimin e familjes dhe anëtarëve të saj.

Puna familjare ndahet në:

- punë shtëpiake, që përfshin punët e mirëmbajtjes, siç është pastrimi i shtëpisë, larja e enëve, larja e rrobave, hekurosja, përgatitja e ushqimit, etj.;
- punët që lidhen me kujdesin, siç janë: kujdesi për fëmijët, ushqimi i tyre, pastrimi, edukimi, ndihmesa në mësim, dërgimi në kopsht-shkollë dhe marrja, pjesëmarrja në takime me prindër, etj. Në familjet e zgjeruara në kuadër të punëve që lidhen me kujdesin përfshihen edhe kujdesi për të moshuarit dhe të sëmurët në familje.
- punët që kanë të bëjnë me riparimet, siç janë: riparimet teknike, mirëmbajtja e automobilit, etj. si dhe
- punët financiare, administrative dhe konsumatore, siç janë: organizimi i transportit, përdorimi i shërbimeve, komunikimi me institucionet e përditshme, etj.

Autorë të ndryshëm, si punë familjare e konsiderojnë edhe kujdesin për disponimin e mirë të anëtarëve të familjes, zbutjen e frustrimeve dhe sigurimin e mirëqenies emocionale, etj. (Coltrane 2000; Oakley 2000; Svab 2001, Elezi, 2017).

Quditërisht, edhe pas luftës shekullore për barazi gjinore, puna në familje mbetet fushëveprim i gruas. Falë kësaj lufte, gratë janë futur me sukses në tregun e punës, është ngushtuar hendeku gjinor në paga dhe baballarët po kalojnë gjithnjë e më shumë kohë me fëmijët e tyre, por hendeku

gjinorë në punët e shtëpisë ka ndaluar së ngushtuari, dhe kështu, rolin kryesor në punët në familje e mbajnë gratë shtëpiake.

Sipas Zyrës për Statistikat Kombëtare Britaneze, në vitin 2016, gratë bëjnë pothuajse 60 për qind më shumë punë të papaguar sesa burrat. Madje edhe në Suedi, ku baballarët zgjedhin vullnetarisht atësinë me kohë të plotë, për çdo ditë, gratë shpenzojnë 45 minuta më shumë se burrat për kryerjen e punëve të shtëpisë (Burgeman, 2018).

Literatura e referuar në vijim do të bëhet me qëllim që të theksojmë ekzistencën e stereotipeve gjinore, sa i përket ndarjes së të drejtave dhe të përgjegjësive në familje. Duke shqyrtuar këtë literaturë, do të paraqesim gruan e sotme, të cilës po t'i heqim punën e paguar është “borxhezja e shekullit të 19”, e cila duke u kujdesur për një shtëpi të pastër, fëmijë të ushqyer e të edukuar mirë, për pamjen e saj të rregullt etj., i siguron burrit të saj një ambient miqësorë për tu relaksuar pas një dite të gjatë në tregun e egër të punës (Studen, 2018).

2.2.1 Roli gjinor i gruas në ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në familje

Duke u munduar që ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësive në bashkëshortësi t'i heqë nuancën e barazisë gjinore, Burgeman (2018) pohon se një shtëpi e rregullt dhe e pastër është pasion i shumcës së grave, përderisa burrat nuk i kushtojnë rëndësi të madhe rregullit në shtëpi. Për të argumentuar këtë mendim i referohet Marche (2017), dhe pohon se burrat që nuk shqetësohen për rrëmujën në shtëpi, nuk do të thotë se bëjnë diskriminim gjinor duke mos u angazhuar për përmbushjen e këtij “standardi” që e konsideron me origjinë seksiste. Në këtë mes ai citon mendimin e një të intervistuarit, i cili shprehet: *“Mua më pëlqen t'i kem gazetatat e shpërndara në tavolinën e kafesë. Gruaja ime e urrenë këtë. Megjithëse nuk protestoj kur ajo i heq gazetatat nga tavolina, nuk e konsideroj këtë si pjesëmarrje të saj në detyrat e përbashkëta të shtëpisë”*.

Pasioni i grave për mbajtjen e rregullit dhe pastërtisë në shtëpi, është emërtuar në mënyra të ndryshme, si: “sëmundja për shtëpi të rregullt” (Dufu, 2017), “fanatizmi për perfeksion”, etj. për të cilin Burgeman (2018) shprehet se është e paimagjinuashme që ky pasion të mbillet edhe tek burrat.

Duke shqyrtuar literaturën e shtjelluar, nuk mund të kufizohemi vetëm në pasionin e grave për rregull dhe pastërti në shtëpi pa u zgjeruar në obligimet e tjera familjare, siç është kujdesi për fëmijët. Për këtë flasin rezultatet e hulumtimit të Mary Noonan (2013), e cila pasi ka përmendur

faktet rreth mënyrës së përdorimit më të dendur të pushimit të lehonisë se sa atij të atësisë në Suedi dhe Norvegji, ku ligji i punës nuk bënë dallime gjinore në lidhje me shfrytëzimin e pushimit të tillë, ka ardhur në përfundim se gratë ndjejnë më shumë përgjegjësi për kryerjen e punëve të shtëpisë dhe për kujdesin ndaj fëmijëve sesa burrat. Këtë fenomen, Fursman dhe Callister (2009) e kanë trajtuar si barrierë për burrat që dëshirojnë ta marrin lejen prindërore për kujdesin ndaj fëmijëve. Ndjenjën e lartë të përgjegjësisë së grave në lidhje me kujdesin për fëmijët/të moshuarit e ka paraqitur edhe Abazi Morina (2017), e cila ka pohuar se 11.6 përqind e grave të papunësuar në Kosovë janë deklaruar se duhet të jenë ato, të cilat duhet të kujdesen për fëmijët/të moshuarit, prandaj nuk do të zgjidhnin të punojnë edhe nëse qasja në shërbime për kujdesë ndaj fëmijëve (kopshte) apo ndaj të moshuarve do të ishte më e përballueshme. Nga kjo mund të themi se gratë krijojnë rolin e tyre gjinor që në fëmijëri, përmes lojërave me kukulla dhe barbi. Prandaj, në punën e kujdesit ato përgaditen shumë kohë para shtatëzanisë. Edhe krijimi i lidhjes emocionale nënë-vajzë, që është i ndryshëm nga lidhjet nënë-djalë ndikon që ato të mos hezitojnë të marrin përsipër detyrat me ngarkesë emocionale.

2.2.2 Roli gjinor i burrit në ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi në familje

Siç e kemi tashmë të ditur, roli kryesor i burrit në familje është sigurimi i mirëqenies financiare. Sidomos në shtetet në zhvillim, ku pjesëmarrja e grave në tregun e punës është më e vogël, burri është shtylla financiare e familjes. Kjo detyrë i ka dhënë burrave statusin e kryefamiljarit në familje, status i cili i ka penguar ata që të marrin pjesë në kryerjen detyrave brenda shtëpisë. Duke shqyrtuar literaturën, kemi parë që statusi socio-ekonomik i burrave është krijuar në normë shoqërore dhe është ndër pengesat kryesore të përfshirjes së tyre në punët në familje.

Me qëllim që të paraqiten barrierat që i pengojnë burrat afrikan në mospërfshirjen e tyre në punët e shtëpisë, Akaine, et. al (2016) ka cituar një të intervistuar, i cili është shprehur: *“Burri mund të kryej punët e gruas së tij, kur nuk është i denjë ta sigurojë ushqimin e sajë dhe të fëmijëve të tij”*. Rezultatet e këtij studimi tregojnë se ideologjia gjinore e ndarjes së punëve në familje është aq e shprehur në vendet në zhvillim, sa shumica e burrave, kontributin e tyre në punët në familje e konsiderojnë si shprehje e dashurisë dhe thyerje e barrierave ideologjike, dhe ndalojnë të japin këtë kontribut në momentin kur gratë fillojnë ta vlerësojnë atë si çështje normale dhe të drejtë, vlerësim, të cilin e konsiderojnë si abuzim ndaj tyre dhe “mirësisë së tyre”.

Arsyja tjetër e mospërfshirjes së burrave në punët familjare është edhe mungesa e përvojës dhe aftësive për kryerjen e punëve në familje, të cilat duhet të krijohen nga fëmijëria, pra, roli i tyre gjinor i krijuar në familje. Akaine, et. al (2016) ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të burrave që u pëlqen të bëjnë punë të shtëpisë, siç janë larja e enëve, gatimi etj. por pastaj hasin në kritika të grave se këto detyra nuk i kanë kryer si duhet dhe tërhiqen.

Duke pretenduar se paga më e madhe e grave ndikon në negocimin e bashkëshortëve për ndarjen e drejtë të punëve në familje, Luke, N., et al. (2014) kanë bërë një hulumtim në lidhje me angazhimin e burrave hindus të familjeve të punëtorëve të plantacioneve të çajit, ku gratë me dekada përbëjnë fuqinë kryesore të punës dhe njihen si shtylla financiare e familjes. Pas analizimit të 49 intervistave dhe 3181 anketave kanë arritur në përfundim se kontributi i burrave hindus cilësohet “si ndihmë” jo si pjesëmarrje e pavarur e tyre në punë familjare. Ata ndihmojnë gratë e tyre duke prerë perimet, apo vleruar ujin për zierje të orizit, por nuk marrin iniciativa për kryerjen e këtyre detyrave në rastet kur gruaja nuk është në shtëpi. Kur ata janë pyetur pse nuk e bëjnë këtë punë pa pjesëmarrjen e grave, disa janë shprehur se nuk dijnë të gatujnë, të tjerë kanë thënë se këtë punë dijnë ta bëjnë mirë, por kur kanë gratë apo vajzat në shtëpi, nuk kanë nevojë të hynë në kuzhinë. Në të njëjtën mënyrë janë shprehur edhe për aktivitetet e tjera, si sjellja e drunjëve, bartja e ujit, etj, që nuk cilësohen tradicionalisht si punë të njëjës apo tjetrës gjini. Ndërsa, kur pjesëmarrësit u pyetën për larjen e rrobave, që në komunitetin hindus njihet si punë specifike për gra, shumica deklaruan se nuk e bëjnë kurrë këtë punë madje për këtë detyrë as nuk negociojnë me gratë e tyre. Edhe ata që kishin larë këmishën e tyre në ndonjë rast të veçantë, këtë detyrë e kishin kryer në ambiente të fshehura, për të mos humbur dinjitetin e tyre burror. Rezultatet e këtij hulumtimi, kanë treguar se edhe burrat të cilët nuk punojnë fare dhe angazhohen në punët në familje nuk e bëjnë larjen e rrobave. Ky fakt tregon se në ndarjen e punëve në familje, ndikojnë më shumë normat kulturore dhe ideologjia gjinore për statusin e burrave në familje se sa të ardhurat më të larta të grave. Pra, përfshirja e grave në tregun e punës nuk e ka zbehur rezistencën e burrave për pjesëmarrje të plotë në sferën e punëve të shtëpisë në përgjithësi, veçanërisht në detyrat me natyrë femërore.

Deri tani veçuan rolin e ideologjisë gjinore, që sidomos në shtetet në zhvillim është faktori kryesorë për mospërfshirjen e burrave në punët e shtëpisë. Përveç këtij faktori, veçuan edhe luksin e burrave për të ndihmuar gratë e tyre e jo për të marrë përsipër detyrat që duhet të kryhen. Ky

luks u mundëson burrave të mos marrin përsipër punët degraduese, siç janë larja e tualetit, pastrimi i rrobave, etj. Sa i përket përfshirjes së burrave në punët në familje në shtetet industriale, ku ideologjia gjinore është më pak e shprehur, nuk mund të themi se situata është më e mirë. Edhe në vendet industriale ekzistojnë barrierat që pengojnë angazhimin e burrave në punët në familje, shumicën e të cilave i kanë paraqitur Fursman dhe Callister (2009). Pasi kanë analizuar llojin e përfshirjes së burrave në punët e kujdesit për fëmijë, të moshuar dhe të sëmurë, ata janë shprehur se burrat nuk mund të veprojnë në mënyrë të pavarur në detyrat që lidhen me kujdesin. Për çështje të tilla, në shumicën e rasteve kërkojnë ndihmën e gruas apo të motrës (kur bëhet fjalë për kujdesin ndaj të sëmurëve). Sa i përket kujdesit për fëmijë, ata janë shprehur se burrat nuk rezistojnë për të marrë përsipër kujdesin për fëmijët ashtu siç rezistojnë kur bëhet fjalë për ndarjen e punëve të shtëpisë, duke vazhduar se me zhvillimin e makro politikave të duhura, ata do të përfshiheshin plotësisht në këtë detyrë. Faktorët që i pengojnë burrat në përfshirje të plotë në punët e kujdesit, sipas këtij hulumtimi janë:

- **dallimet gjinore biologjike**, që ia imponojnë gruas marrjen e lejes prindërore, e cila gjatë kësaj kohe kryen edhe shumicën e punëve të shtëpisë, prandaj edhe ndarja edhe më asimetrike e detyrave dhe përgjegjësi në bashkshortësi fillon të bëhet pas lindjes së fëmijës. Në këtë mënyrë konstatojnë se në familjet ku fëmija i parë lind kur prindërit janë në moshë më të re, ndarja e punëve në familje është më padrejtë.
- **faktorët e vendit të punës**, që janë orari i punës, kulturat e vendit të punës dhe karakteristikat e punës, si dhe hendeku gjinor në pagë.
- **preferencat e grave për marrjen e kujdesit**, të cilat në shumicën e rasteve këmbëngulin për shfrytëzimin e pjesës së lejes prindërore të rezervuar për burra.
- **pengesat strukturore për kujdesin e burrave**, si p.sh. vendosja e ambienteve për ndërrimin e pelenave në banjot e grave, stafi i përbërë ekskluzivisht nga gratë në shërbimet për përgatitje për tu kujdesir për foshnjat (new born class), ambientet e përshtatshme për gra në kopshtet e fëmijëve, etj.
- **kultura dhe ideologjia**, që edhe pse me nuanca më të lehta se sa në vendet në zhvillim, janë faktorë të rëndësishëm për mosgadishmërinë e burrave për marrjen e kujdesit.

2.3 Lloji i punëve në familje në kuadër të dallimeve gjinore biologjike

Në vija të trasha, tanimë e kemi bërë të ditur se në shumicën e familjeve gratë janë përgjegjëse për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve dhe punët e shtëpisë, kurse burrat për punët "joshtëpiake", në kopsht, në garazhë, në arë, në institucione administrative si dhe në sferën publike.

Në këtë mënyrë, punët e shtëpisë mbeten obligim i grave, riparimet eventuale në shtëpi gratë ua lënë burrave, ose paguajnë shërbimet përkatëse. Kujdesi për anëtarët e sëmurë të familjes, si dhe kujdesi dhe edukimin e fëmijëve janë barrë e grave. Kjo fotografi ndryshon pak nëse të dy bashkëshortët janë të punësuar, por prap se prap ka shumë pak çifte që ndajnë punët e shtëpisë në mënyrë të barabartë.

Për këtë flasin të dhënat statistikore të hulumtimit se si evropianët e kolojnë kohën e tyre (2014), ku është vërejtur një angazhim dukshëm më i madh i burrave se sa i grave në riparime teknike, kopshtari dhe kryerje të pazareve dhe shërbimeve të tjera për dallim nga aktivitetet e tjera siç janë përgaditja e ushqimit, larja dhe hekurosja e rrobave, pastrimi dhe mirëmbajtja madje edhe kujdesi për fëmijë. Nga kjo mund të themi se punët që kërkojnë fuqi fizike, apo kryhen jashtë shtëpisë bëhen nga burrat. Punët rutinore që nuk kërkojnë fuqi fizike, bëhen brenda shtëpisë dhe kërkojnë përfshirje emocionale bëhen nga gratë.

Rezultate të ngjashme dalin edhe nga hulumtimi i Juan F. et. al. (2016), të cilët duke dashur të identifikojnë nëse ekzistojnë dallime qenësore në mes punëve shtëpiake të kryera nga gratë dhe burrat, kanë anketuar 200 persona dhe kanë pohuar se ndarja e punëve të shtëpisë sipas gjinisë është pasojë e ideologjisë e jo e kohës së disponueshme, duke përfunduar se ideologjia është ajo që përcakton frekuencën me të cilën individët kryejnë punët e shtëpisë brenda një konteksti të caktuar shoqëror. Pra, punët rutinore dhe ekspresive janë fushveprimtari e grave, meqë ato përkujdesen për mirëqenien emocionale të anëtarëve të familjes (kujdesi për fëmijët, kujdesi për të moshuarit), si dhe bëjnë punët e lidhura me mirëmbajtjen, kuzhinën dhe pazaret. Në anën tjetër janë detyrat që tregojnë një lidhje më të fortë me gjininë mashkullore, siç janë: fryerja e gomave, riparimi i prizave, sinkronizimi i TV-së, riparimi i rezervuarit të WC-së, ndërrimi i rrezeve të dymit, etj. të cilat vazhdojnë të kryhet nga burrat. Autorët e këtij hulumtimi paraqesin një grup të tretë të punëve që janë kryer nga të dy gjinitë. Në këtë mes, përfshihen përgatitja e ushqimit dhe kositja e barit, që bëhet nga të dy palët. Ekzistenca e grupit të tretë na bënë të themi se ndarja e

punëve sipas gjinisë ka filluar mos jetë më absolute, edhe pse këto dy lloje të aktiviteteve janë shumë pak në krahasim me aktivitetet e lartpërmendura, tipike për një tërësi ose tjetër gjini.

Dallime të ngjashme për ndarjen e punëve e shtëpisë në familjet kosovare me gra të punësuar, i gjejmë në rezultatet e hulumtimeve të Riinvest (2017), sipas të cilave 72 për qind e burrave bëjnë riparimet në shtëpi, ndryshe nga punët e tjera, siç janë pastrimi dhe mirëmbajtja, përgatitja e ushqimit, kujdesi ndaj fëmijëve, ku angazhohen vetëm 1 për qind e burrave.

Rezultate interesante janë paraqitur në hulumtimin e Hochschild (2012), i cili pasi analizoi llojet e punëve të shtëpisë që bëjnë burrat dhe gratë pohon: “Ajo çfarë bëjnë burrat është shumë e ndryshme nga çfarë duan gratë. Është sikur shtëpitë tona të ishin ndarë në “zona” diskrete – të tij dhe saj – dhe bashkëshortët e bashkëshortet kishin sferën e tyre të përgjegjësisë. Fusha “e tij” ishte jashtë dyerve – në oborr, rrugë me pemë – ose në një hapësirë jashtë dyerve të zhvendosura në ambiente të mbyllura, si bodrum, garazh, kontejnerë të plehrave; fusha “e saj” ishte gjithmonë brenda dyerve – kuzhinë, dhomë larjeje, dhomë gjumi dhe banjo. (Nëse ajo lëviz jashtë dyerve, është gjithmonë me një element “të brendshëm” – duke hapur rrobat, duke u kujdesur për kopshtin). Këto dy fusha kërkojnë lloje të ndryshme aktiviteteve. Në një studim, gratë dhe burrat u pyetën për të listuar të gjitha gjërat e ndryshme që ata bëjnë rreth shtëpisë. Numri total i njësive në secilën listë ishte afërsisht ekuivalent. Por kur detyrat specifike u ekzaminuan, burrat listuan njësi si “të lajë makinën” dhe “të kosis barin”, ndërsa gratë listuan “të gatuj” dhe “të rregulloj shtretërit”, punë të cilat duhet të kryhen për çdo ditë, në krahasim me larjen e makinës apo kositjen e barit, që bëhen më rrallë.

Nga këto të dhëna mund të vijmë në përfundim se punët rutinore dhe ato ekspresive bëhen nga gratë dhe ato janë:

- punët që bëhen mbrenda në shtëpi, siç janë: pastrimi i shtëpisë, larja e rrobave, hekurosja, krijimi i listave për pazare javore/mujore etj.;
- punët që kërkojnë përfshirje emocionale, siç janë: kujdesi ndaj fëmijëve, të moshuarve në familje apo të sëmurëve etj.

Ndërsa punët që bëhen nga burrat janë: .

- punët që kërkojnë fuqi fizike, siç janë fryerja e gomave, riparimi i prizave, riparimi i rezervuarit të WC-së, ndërimi i rrezeve të dyerve, etj.;
- punët që kryhen jashtë dyerve të shtëpisë, siç janë: larja e makinës, kositja e barit, pagesa e faturave, bërja e pazareve, heqja e borës, etj.

Karakteristikë e të gjitha aktiviteteve që kryhen nga burrat është se ato mund të maten dhe nga përvoja jetësore, themi se në shumicën e rasteve edhe kryhen nga persona të tjerë pa humbur vlerën e tyre, p.sh. larja e makinës rrallë bëhet në shtëpi, poashtu ndërimi i rrezeve të dyerve apo riparimi i rezervuarit të WC-së, në shumicën e familjeve kryhen nga shërbimet ekskluzive për këto punë, etj., ndryshe nga punët e kryera nga gratë, të cilat të cilësuar si “punë dashurie” nuk maten dhe e humbin vlerën po të bëhen nga një palë e tretë, p.sh. kujdesi për fëmijët mund të bëhet për disa orë nga kujdestarja ose edukatorja, por nuk mund të bëhet gjatë gjithë kohës, po ashtu pastrimi, larja e rrobave, gatimi, etj. nuk mund të bëhen gjithnjë nga persona të tjerë ose shërbime përkatëse.

Karakteristika tjetër e aktiviteteve që kryhen nga burrat, na asocion në definicionin e parë të ndarjes së punës, ku përmendet puna jashtë shtëpisë, e cila ishte dhe si duket me ndryshime shumë të vogla mbeti punë burrash. Edhe aktivitetet e kryera brenda shtëpisë nga ana e burrave, siç janë riparimet e ndryshme, prap na asocion me dallimet biologjike të Parsonit si pasojë e të cilave lindën stereotipet gjinore, pra, ndarja e punës duke u mbështetur në fuqi trupore dhe riprodhim të shoqërisë.

Nga kjo mund të themi se, kur bëhet fjalë për ndarjen e punëve të shtëpisë në mes të bashkëshortëve, edhe pas përfshirjes së burrave në punë të shtëpisë ende koincidojnë me definicionet e para të punës (shih kapitullin 1.3.2 të këtij punimi) dhe dallimet e roleve gjinore të Parsonit (shih kapitullin 2 të këtij punimi), çka do të thotë se rregullat shoqërore të vendosura shekuj më parë, janë kthyer në ideologji gjinore, për rrëzimin e së cilës kërkohet angazhim i madh nga një seri institucionesh.

3 Koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore të bashkëshortëve në familje

Nëpër studime të ndryshme, matja e kohës në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore në familje, është bërë në mënyra të ndryshme. Në disa studime thuhet se mënyra më e mirë e matjes është intervali kohorë brenda ditës, ndërsa të tjerë pohojnë se të gjithë kanë një ditë që nuk duan ose nuk mundën të angazhohen fare në punë të shtëpisë, prandaj matjen e kohës në interval javorë e konsiderojnë më të përshtatshme. Pavarësisht se në çfarë mënyre janë bërë matjet, në të gjitha studimet vërehen dallime të mëdha në kohën e shpenzuar nga ana e burrave dhe e grave për përmbushjen e obligimeve ditore në familje. Gratë vazhdojnë të kalojnë më shumë kohë në punët e shtëpisë sesa burrat dhe ky model është i vërtetë edhe në rastet kur gratë janë të punësuar (Shalter, 2006).

Në Shtetet e Bashkuara, ku nuk ekzistojnë politika të përshtatshme për pushimin prindëror, shumë studiues kanë ardhur në përfundim se gratë kryejnë 65 - 80 për qind të punëve të shtëpisë (Greenstein, 1996, në Shalter 2006). Edhe studimet e bëra në vendet e tjera, tregojnë se gratë bëjnë pjesën më të madhe të punëve në shtëpi, megjithëse madhësia e hendekut gjinor është e ndryshme nëpër vende të ndryshme. Rezultatet e studimit, se si e kalojnë evropianët kohën e tyre, tregojnë se në shtetet e Europës Perëndimore, ku ekzistojnë politika më të përshtatshme të pushimeve prindërore se sa në SHBA, gratë kalojnë 4 orë dhe 57 minuta në ditë në punët e shtëpisë dhe burrat 2 orë e 39 minuta. Nëse e shikojmë kohën si përqindje, gratë bëjnë 65 për qind të punëve të shtëpisë dhe burrat 35 për qind. Kjo do të thotë që gratë bëjnë dy të tretat e të gjitha detyrave në shtëpi dhe familje (Eurostat, 2004).

Dallime edhe më të mëdha shohim në rezultatet e Forumit Ekonomik Botëror (WEF) për gratë dhe burrat në mbarë botën, ku përfshihen edhe shtetet në zhvillim, në të cilat përveç politikave jo të përshtatshme për pushimet prindërore, ekziston një dozë më e lartë e ideologjisë gjinore për ndarjen e punëve në mes të bashkëshortëve. Sipas këtyre rezultateve, burrat shpenzojnë vetëm 1 orë e 30 minuta në punë pa pagesë dhe punë të kujdesit, ndërsa gratë shpenzojnë deri në 4 orë e 47 minuta në ditë për të kryer punë të tilla (WEF, 2016, në: Riinvest, 2017)..

3.1 Kujdesi për fëmijët

Hendeku gjinor në kohën e shpenzuar në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore në familje, është i pranishëm edhe kur nuk ka fëmijë, “por përkeqësohet nga prania e fëmijëve në familje.”

(Shelton, 2006). Kur burrat bëhen baballarë, ata kanë prirjen të shpenzojnë më shumë kohë në punë, pjesërisht për shkak se ata duan të fitojnë më shumë për të mbështetur fëmijët e tyre dhe pjesërisht për shkak se ata duan ose janë të aftë për ta bërë një gjë të tillë. Bashkëshortet e tyre, sigurisht, shpenzojnë më pak kohë në punë, duke rritur në këtë mënyrë hendekun gjinor në punë dhe në shtëpi.

Nënat shpenzojnë më shumë kohë me fëmijët, veçanërisht kur fëmijët janë foshnje, kohë gjatë së cilës familjet raportojnë “nivele më të ulëta të angazhimit të baballarëve.” Nënat shpenzojnë 50 për qind më shumë kohë me fëmijët në kopsht deri në klasën e katërt se sa baballarët (PRC, 2013). Hendeku gjinor i ndarjes së kujdesit ndaj fëmijës zvoglohet kur fëmija rritet, që kërkon një lloj tjetër angazhimi dhe ndoshta ofron më shumë “argëtim” për baballarët. Por kur studiuesit pyetën se sa kohë shpenzonte secilin prind vetëm me fëmijët, baballarët kishin një mesatare prej 5.5 orë në javë kurse nënat kishin një mesatare prej 20 (19.5) orësh në javë.

3.2 Mëmësia

Në shoqëritë patriakale, nocioni i një nëne të modernizuar – një nënë që punon, në shumë raste ka një konotacion negativ, pasi na aludon në një nënë të keqe, që devijon nga roli i saj si përkujdesëse dhe ka ndikim të keq në familje (Hasani, 2019). Në jetën e përditshme, cilësori “i modernizuar” shpesh përdoret me kuptim negativ. Nëse diçka modernizohet, do të thotë që tërhiqet nga tradita, trashëgimia etj. dhe është dukuri negative që nuk sjell asgjë të mirë.

Edhe pse përkufizimet e familjeve me të dy bashkëshortët e punësuar datojnë qysh më 1969, ende bëhen kritika për gratë e punësuar që kanë fëmijë. Debati nëse nënat duhet të punësohen ose jo është ende në vazhdim, si në fushat profesionale ashtu edhe në ato jo-profesionale të jetës. Nëpër media, politikë e sidomos në popull, shumica e debateve mbështeten në shembuj të ndryshëm nga jeta e grave që kanë përvoja negative në ndërthurjen e punës dhe familjes (Hasani, 2019). Disa autorë e vënë në diskutim çështjen nëse nënat që punojnë janë të tepërta në vendin e punës sepse biologjia e tyre e ka përcaktuar vendin e tyre në familje.

Ashtu si në domenin e punëve të shtëpisë, edhe gjatë kujdesit për fëmijët nënat kanë më shumë ngarkesë. Ndër arsytet e tjera, autorët përmendin tiparet e imazhit të nënës si një qenie e fortë, që jep ngrohtësi, afërsi dhe ushqim. Përgatitjen për rolin e nënës, gratë e fillojnë shumë kohë përpara shtatzënisë. Edhe vajzat e vogla tërhiqen nga ky rol, përmes lojërave me bebe dhe kukulla. Në këtë

mënyrë detyra për kujdesin ndaj fëmijëve, grave u imponohet jo vetëm nga shoqëria, burrat e tyre, por edhe nga vetë ato. Edhe pse numri i grave të punësuar me fëmijë të vegjël po rritet, atyre u "ngarkohen" përgjegjësi shtesë për mirëqenien e fëmijëve. Gjithnjë e më shumë ngarkohen me produkte që fëmijët duhet t'i kenë, me aktivitete që duhet t'i bëjnë me fëmijët e tyre dhe me ligjërime publike ku theksohet fakti se procesi i edukimit të fëmijëve mund të qalojë, duke shkuar deri te imtësitat, si: prishja e gjumit të fëmijës në orët e hershme të mëngjesit për arsye se nëna duhet të shkojë në punë. Në këtë mënyrë, nënat ende privohen nga qëndrimet tradicionale ndaj punës dhe punësimit, në kuptimin se "fëmijët e tyre do të vuajnë" (Gatrell 2005; Hasani, 2019).

Ideologji të tilla janë të dukshme në shoqërinë kosovare, për këtë flet më së miri pjesëmarrja e vogël e grave në tregun e punës e sidomos rezultatet alarmante të hulumtimit të Abazi Morina (2017), e cila pas anketimit të grave të papuna në Kosovë, ka konstatuar se shoqëria patriakale, e pasuar nga politikat jo adekuate të pushimit të lehonisë janë arsyet kryesore për mospjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Këtë e vërtetojnë përgjigjet e 26 për qind të grave të papuna, të cilat duke u ndjerë si përgjegjëse të vetme për rritjen e fëmijëve nuk shprehën gadishmëri për të punuar, edhe nëse do të mund t'i dërgonin fëmijët në ndonjë kopsht apo nëse do të kujdesej dikush tjetër për ta.

Rezultatet e hulumtimit të McGinn (2015) japin argumente të fuqishme kundër këtij stereotipizimi negativ për nënat që punojnë. Ky hulumtim u bie me grusht etiketimeve të llojit "nënat të cilat punojnë e shkatërrojnë familjen" dhe "nënat e punësuarat i lënë anash dhe i braktisin fëmijët". Sipas këtij hulumtimi, nënat e punësuarat jo vetëm që kanë ndikim pozitiv tek vajzat e tyre, por edhe te djemtë. Fëmijët që rriten në familje ku nëna është në marrëdhënie pune mësohen të jenë më të pavarur, mësohen t'i ndajnë obligimet brenda familjes dhe kështu i përmbysin gradualisht konceptet mbi rolet tradicionale gjinore jo vetëm në familje e shoqëri, por edhe në tregun e punës. Të dhënat për këtë studim janë mbledhur nga 24 shtete të ndryshme. Sipas këtij studimi, vajzat e rritura të nënave të punësuarat kanë më shumë gjasa për t'u punësuar, për të fituar më shumë dhe për të pasur pozita udhëheqëse në krahasim me vajzat e rritura të nënave të cilat qëndrojnë në shtëpi kur fëmijët e tyre janë të vegjël. Në anën tjetër, djemtë e rritur të nënave të punësuarat janë më të përkushtuar ndaj familjes, ata kalojnë më shumë kohë në përkujdesjen ndaj anëtarëve të familjes. Studimi gjithashtu tregon se ata kanë gjasa më të mëdha të martohen me vajza të punësuarat, në krahasim me djemtë e nënave që qëndrojnë në shtëpi.

3.3 Atësia

Studime të shumta tregojnë se burrat kanë dëshirë të jenë "baballarë të mirë" dhe se çdo ditë e më shumë dëshirojnë të marrin pjesë në kujdesin për fëmijë. Problemi qëndron në standardet shoqërore, sipas të cilave babai i mirë ende mbështetet vetëm në funksionin e tij si sigurues i ushqimit, ndërsa (siç cekëm më lartë) kërkesat dhe standardet për mëmësinë e mirë po rriten në mënyrë të qëndrueshme, baballarët, nga ana tjetër, gjithmonë e përjetojnë rolin e tyre prindëror si palë apo si ndihmës. Poashtu edhe pas lindjes së fëmijës burrat kthehen menjëherë në vendin e punës dhe kështu nuk ndiejnë rolin e tyre si baba (Rener, et al. 2008).

Ideja e stereotipeve për baballarët si kujdestar financiar të familjes krijon imazhin e tyre, që është krejt i ndryshëm nga ai i nënave. Nëse nënave u bëhet presion se pse janë të punësuar, baballarëve u bëhet presion që të punësohen. Edhe nëse disa baballarë dëshirojnë të kalojnë kohën me fëmijët e tyre, pritjet e shoqërisë i pengojnë të bëjnë një gjë të tillë.

Faktor shumë i rëndësishëm që e krijon ndryshimin e madh të të qenit baba nga të qenit nënë është miti rreth mëmësisë sipas të cilit të jesh nënë është një instinkt, një rregull, një pjesë e biologjisë femërore. Kurse, të qenit baba është një sjellje kulturore që lidhet me përvojat individuale të personit të caktuar.

Në atësi ndikojnë shumë pritjet e përgjithshme të shoqërisë, mjetet e komunikimit masiv dhe ndërveprimet e babait me individë të tjerë. Duke qenë se shoqëria tashmë e konsideron si dytësorë rolin e babait në kujderin ndaj fëmijëve, në shumë shtete, profesionet e dominuara nga burrat kanë rregullore të tilla që nuk e lejojnë aranzhimin e orëve të punës me ato të kujdesit. Gratë, si të paracaktuara për kujdesë, para fillimit të karrierës zgjedhin profesione si mësimdhënia, infermiera, etj., që i lejojnë ato të përmbushin përgjegjësitë e tyre të kujdesit. Në të njëjtën mënyrë ndikon edhe kultura e punëdhënësve, të cilët nuk reagojnë kur gruaja kërkon leje prindërore, por jo në të gjitha rastet ndahen pa reagime baballarët që dëshirojnë të marrin pjesë në kujdesin për fëmijë (Fursman dhe Callister, 2009).

Ne dhjetëvjeçarin e fundit, kanë filluar të bëhen ndryshime në nivelin makro përmes të cilave pritjet të bëhen ndryshime edhe në nivelin mikro të familjes. Disa nga këto ndryshime janë politikat familjare, politikat e mundësive të barabarta, etj. Nëse ecim nëpër një rrugë, në park apo në qytet, shohim gjithnjë e më shumë baballarë me karroca, në shesh lojërash, etj. Rezultatet e shumë studimeve tregojnë se ndarja e kujdesit për fëmijë në mes të partnerëve bëhet në mënyrë më të

drejtë se sa ndarja e punëve të shtëpisë. Burrat kalojnë gjithnjë e më shumë kohë me fëmijë, por nëse shtrojmë pyetjen se me cilat aktivitete merren, shohim se rolet e prindërve në familje janë ende të ndara sipas gjinisë së prindit. Nëna kujdeset për fëmijën e porsalindur. Babai ka një rol më pasiv, veçanërisht në formën e ndihmësit. Edhe më vonë, kur baballarët përfshihen në mënyrë aktive në jetën e fëmijëve, nëna kujdeset për ta. Baballarët kanë të drejtë të zgjedhin në cilat veprimtari të përfshihen dhe në cilat jo (Svab, 2001). Sidoqoftë, studimet tregojnë se baballarët kujdesen plotësisht për fëmijët e tyre kur janë vetëm me ta. Atëherë, ku është problemi? Padyshim që ekziston një e vërtetë në ideologjinë e mëmësisë dhe mosgadishmërisë të saj për të lënë pjesën e kujdesit dhe të ushqyerit te partneri i saj/babai. Vet natyra e nënës ndikon që ajo të marrë përgjegjësi më të mëdha për rritjen e fëmijëve. Rezultatet e studimeve të Rhoads & Rhoads (2012) tregojnë se shumica e nënave suedeze, lejën prindërore e përdorin me vetëdëshirë sepse kujdesin për foshnjat e tyre e shijojnë më shumë sesa burrat. Këto të dhëna na bëjnë të themi se, edhe pse babai i ri është më aktiv në përkujdesjen ndaj fëmijëve, angazhimi i tij kufizohet në aktivitete më të këndshme. Pushimi mjeksor, ushqyerja, larja janë fushëveprimtari e grave: loja, aktivitetet e kohës së lirë janë ato në të cilat përfshihen burrat, çka do të thotë se konceptet për mëmësinë si natyrore dhe atësinë si shoqërore janë akoma të pranishme. Kështu që, ndarja ekzistuese e punës vazhdon më tej dhe gratë mbeten kujdestare dhe burrat siguroes të të mirave materiale (Humer et al. 2008).

3.3.1 Prindërimi dhe karriera

Në teori, shumica e nënave sot nuk janë të detyruara të vendosin nëse do t'i përkushtohen plotësisht mëmësisë ose do të kthehen në vendin e punës edhe pas lindjes së fëmijëve të tyre. Nënmat mbesin të punësuar në çdo kohë, me përjashtim të pushimit të lehonisë me një fëmijë të porsalindur. Në shikim të parë politika familjare në Kosovë ka një legjislacion mjaft miqësor. Ky legjislacion, nënave u lejon të kalojnë muajt e parë me fëmijët e tyre. Ato kthehen në punë pas pushimit të lehonisë. Problemi qëndron në faktin se ato i detyron ligji që të shkojnë në pushim të lehonisë 6 muajt e parë pas lindjes, kurse sa i përket muajve pasues, që sipas ligjit në fuqi mund t'i ndajnë me burrin, ato i detyron ideologjia shoqërore që të vazhdojnë kujdesin për së paku 1 vit. Kjo përshkak se shumica e burrave nuk mund të marrin përgjegjësi që të kujdesen për fëmijën, dhe se gjatë kësaj periudhe nuk mund t'i shfrytëzojnë kopshtet për fëmijë, ku pranohen vetëm fëmijët më të mëdhenjë se një vit.

Shkëputja njëvjeçare nga tregu i punës është një periudhë relativisht e gjatë për t'i munguar atyre pozicioni i favorshëm shoqëror, që e fitojnë gjatë kohës sa janë të punësuar dhe fillojnë të ndihet si nëna të papuna. Institucioni i mëmësisë nënkupton kapital më të ulët shoqëror dhe pabarazi brenda partneritetit. Shumë hulumtime kanë treguar se gjatë pushimit të lehonisë nënave u mungon vendi i tyre i punës dhe se është e vështirë që ato të mësohen me jetën pa punë. Mbajtja e një pune ka një efekt pozitiv për gratë dhe rrit vetëbesimin e tyre. Hulumtimet kanë treguar se nënat që nuk largohen plotësisht nga vendi i punës janë më të kënaqura se nënat e papuna. Punësimi ka efekt pozitiv, falë të cilit ato krijojnë marrëdhënie më të ekuilibruar dhe emocionale me fëmijën. Kur edhe nëna është e punësuar lidhja e babait me kujdesin ndaj fëmijëve rritet, ata vendosin marrëdhënie me fëmijët pa marrë parasysh nënën (Gatrell 2005). Ndikimi i pjesëmarrjes së baballarëve në jetën e fëmijëve që nga lindja ka rezultuar të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e aftësive kognitive dhe emocionale dhe në shëndetin fizik të fëmijëve. *Sipas Zogjanit (2020), përfshirja më e madhe e tyre në kujdesin e fëmijëve ka përfitime të mëdha edhe për gratë. Prandaj është e domosdoshme të krijohen politika familjare që i lejojnë të dy prindërit të ndajnë kohë në mënyrë të barabartë në kryerjen e përgjegjësive prindërore dhe profesionale. Meqë modeli aktual i lejes së lindjes tek nënat në Kosovë dhe modeli i ri i propozuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në mandatin e kaluar nuk kujdesen për kërkesat e popullatës, instituti D4D ka avokuar për dispozita ligjore që janë në drejtim të ekuilibrit më të madh në jetë dhe punë në familje, duke u munduar të krijojë parakushtet që baballarët kosovarë të kenë të drejtën për t'u përfshirë aktivisht në kujdesin ndaj fëmijëve. Politikat duhet t'i mbështesin familjet me prindër që punojnë në dy mënyra:*

1. Duke siguruar që prindërit kanë të drejtë të marrin leje prindërore, për t'u kujdesur për fëmijët e tyre; dhe
2. Me sigurimin ose përkrahjen e përkujdesjes për fëmijët, nga të dy prindërit (Zogjani, 2020).

4 MAKROPOLITIKAT PËR NDARJEN MË TË DREJTË TË PUNËVE NË FAMILJE DHE NDIKIMI I TYRE

Siç theksuam deri më tani, puna në familjare pasqyron ndarjen gjinore të roleve në familje (Coltrane 2006; Oakley 2000; Švab 2001, Javier Cerrato & Eva Cifre, 2018). Me qëllim të zhdukjes së stereotipeve gjinore, të përfshirjes së burrave në punët familjare dhe mbajtjen e grave në tregun e punës, vendet perendimore kanë krijuar politika, shumica e të cilave lidhen me pushimet prindërore. Kështu p.sh. në Suedi, që nga viti 1974 qeveria ka ofruar pushim prindëror të barabartë për babanë ose nënën (Hernmarck Ahliny, 2020). Në Norvegji për të respektuar neutralitetin gjinorë, qeveria ofron programin cash-for-care (para të gatshme për përkujdesje), në vende të ndryshme pushimet e lehonisë kanë filluar të jenë përherë e më të shkurtëra (Noonan, 2013), etj.

Ndikimi i këtyre politikave në ndarjen e përgjegjësive në mes të partnerëve në familje, kanë qenë objekt studimi i shumë hulumtimeve, kështu p.sh. afati më i shkurtër i pushimeve të lehonisë me kompenzim që është bërë me qëllim të kthimit më të lehtë të nënave në vendet e punës, ka ndikuar në vazhdimësinë e historisë së punës për gratë, në përfitime më të mira materiale nga ana e tyre, në shkurtimin e kohës për të kryer punë pa pagesë si dhe në rritjen e kohës së burrave të tyre në punën pa pagesë. Studimet kanë treguar, (shih: Noonan, 2013) se kthimi i përshpejtuar i gruas në tregun e punës shton mundësitë e negociimit të saj me burrin, për një ndarje më të drejtë të të drejtave dhe përgjegjësive në familje, poashtu i mundëson asaj që të ketë mundësi financiare të shtrytëzojë shërbime për të zëvendësuar mungesën e saj në shtëpi (p.sh., të blejë ushqime të gatshme, të paguaj shërbime të pastrimit të shtëpisë, etj.). Në këtë mënyrë, pushimi i shkurtër i lehonisë në mënyrë indirekte mund të ndikojë në një ndarje më të drejtë të të drejtave dhe përgjegjësive familjare midis burrave dhe grave (Geist & Cohen, 2011; Hook, 2010).

Në hulumtime të ngjashme është konstatuar se në vendet që ofrojnë pushime të lehonisë me kohëzgjatje më të gjatë, ka tendenca që në këto vende të vazhdohet me ekzistencën e ideologjive gjinore për prindërim, sepse nënat janë ato që zakonisht i përdorin këto pushime (Hook, 2006, në: Noonan, 2013) madje ka autorë (Bergmann, 1998, në: Noonan, 2013) që pohojnë se me anë të këtyre politikave, shtetet e cakuara kanë forcuar "sistemin tradicional të klasave shoqërore-stereotipave gjinorë". Në këtë mes, po përmendim rastin e Kosovës, që në krahasim me shtetet fqinje rradhitet e para për nga kohëzgjatja e periudhës së pushimeve të lehonisë. Kjo, jo vetëm që

ka ndikuar në hezitimin e punëdhënësve për të punësuar gra të moshave potenciale për tu bërë nëna, por edhe për krijimin e kushteve negative që gratë të kërkojnë punë dhe nëse përmendim konkludimin e Noonan (2013), i cili pohon se pas dy viteve të largimit nga tregu i punës mundësitë e gjetjes së një pune janë shumë të vogla, mund të themi se shteti i Kosovës është duke kontribuar në mbajtjen e grave jo aktive në tregun e punës.

Përveç pushimeve të lehonisë me kohëzgjatje më të shkurtër, përmendëm edhe më lart se shtetet e zhvilluara kanë krijuar politika të tjera që kanë ndikuar në ndarjen më të drejtë të përgjegjësiave familjare, ndër to është pushimi i atësisë. Me një legjislacion të tillë, qeveria u mundëson familjeve të marrin vendime progresive në favor të barazisë gjinore (Hernmarck Ahliny, 2020). Disa nga praktikat e shfrytëzimit të pushimit të atësisë janë marrëveshja në mes të prindërve se si ta ndajnë pushimin prindëror (në Suedi), puna me orar të shkurtuar e të dy prindërve (40-60 për qind të orarit të plotë) (në Danimarkë dhe Finland), detyrimi i babait që të shfrytëzojë pjesën e pushimit të atësisë, i cili nuk mund të përdoret nga çifti nëse babai nuk e përdorë atë, (në Norvegji), etj.

Duke parë këto përpjekje nga ana e qeverive për të arritur barazinë gjinore dhe duke e shqyrtuar ligjin e punës në fuqi, sipas të cilit babai mund të shfrytëzojë pushimin e atësisë, në vend të pushimit të lindjes së nënës, për 3 muaj, pasi nëna të ketë shfrytëzuar 6 muajt e saj. Kurse gjatë 6 muajve të parë, babai mund të shfrytëzojë pushimin e atësisë, vetëm nëse nëna vdes ose e braktisë fëmijën, mundemi lirisht të themi se kultura patriarkale, mosangazhimi i qeverisë për të gjetur politika për barazi gjinore, legjislacioni në fuqi, janë faktorët kryesor që ndikojnë që kujdesi për fëmijë në Kosovë të konsiderohet ekskluzivisht si çështje e nënave. Edhe përkundër përpjekjeve nga ana e shumë OJQ-ve, vet ligji e mundëson largimin e gruas nga tregu i punës.

Me qëllim të ndarjes më simetrike të punëve në familje, vendet e industrializuara kanë krijuar politika të ndryshme siç janë, përfshirja e grave në tregun e punës, pushimet e atësisë, subvencionet për kujdesin për fëmijë, krijimi i politikave më miqësore të punëdhënësve, etj.

4.1.1 Përfshirja e grave në tregun e punës

Duke u nisur nga fakti se një politikë që prek kohën e një gruaje në punën me pagë, duhet me doemos të ketë ndikim edhe në kohën e saj në punë të papaguar dhe anasjelltas dhe nga fakti se ndryshimet në përdorimin e kohës së gruas duhet të ndikojnë në përdorimin e kohës së burrit, punësimi i grave nga shumë autorë, është trajtuar si një nga politikat kryesore për barazinë e

ndarjes gjinore të punëve në familje (shih Stier & Lewin-Epstein, 2007, D4D, INDEP). Por, rezultatet e shumë studimeve kanë treguar se edhe pse gratë e punësuar bëjnë më pak punë familjare sesa gratë e papuna, ngarkesa me punë familjare e burrave të martuar në shtëpi nuk është shumë e ndjeshme ndaj statusit të punësimit të grave të tyre (Blau, Ferber, & Winkler, 2010). Kështu, një politikë që ndikon në caktimin e kohës së një gruaje, jo domosdoshmërisht ndikon në alokimin e kohës së partnerit të saj (Connelly & Kimmel, 2009). Për këtë flasin rezultatet e hulumtimit të Zyres së Statistikave Kombëtare, që më 2015 kanë raportuar se si pasojë e rritjes së punësimit të grave në SHBA, sasia e kohës që gratë kalojnë në aktivitete të kohës së lirë, ka rënë nga një mesatare prej 39.24 orë në javë në vitin 2000 në 38.25 orë në 2015. Ndërkohë, burrat po kalojnë edhe më shumë kohë për veten e tyre. 43 orë në javë më 2015, shifër që është më e lartë se 42.88 orë, që ishte në vitin 2000.

Në të njëjtën mënyrë, është vërejtur se statusi i burrit të papunësuar nuk ndikon në detyrimet e tij rreth shtëpisë, apo burrat e papunë nuk përfshihen më shumë në ndarjen e punës familjare se sa burrat e punësuar. Prandaj, edhe pse intensiteti i përfshirjes së grave në sferën e punësimit është rritur dukshëm, në të gjitha vendet gratë janë akoma ato që ende kryejnë pjesën më të madhe të punës familjare (Beaujot dhe Ravanera 2003).

Duke qenë se nuk është bërë ndonjë ndryshim i madh në ndarjen e punëve në familje, pjesëmarrja e grave në tregun e punës ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e ekonomisë familjare por edhe në rritjen e konfliktit punë-familje. Pas intervistimit të 2033 personave Clarie, M. Et. al (2012) kanë ardhur në përfundim se mospjesëmarrja e burrave në punët e shtëpisë shoqërohet me tension, konflikt dhe cilësi të dobët martesore. Në familjet me shumë fëmijë, këto efekte mund të përkeqësohen, pasi që kërkohet më shumë punë shtëpiake. Këtë e konfirmojnë edhe rezultatet e kërkimit të Coleman dhe Ganong (2004), që pohojnë se parashikuesi më i fortë i mundësisë së konflikteve martesore është vlerësimi i gruas për ndarjen jo të drejtë të punës në familje. Një studim tjetër zbuloi se fraksioni i burrave që ndajnë plotësisht punët e shtëpisë është një e pesta, por kjo një e pesta ishin bashkëshortët në çiftet më të lumtura në studim.

4.1.2 Kuotat e babait apo pushimi i atësisë

Në mënyrë që të arrihet një ndarje më e barabartë e kujdesit për fëmijët, punëve të shtëpisë dhe punësimit midis nënave dhe baballarëve, disa vende siç janë: Norvegjia, Suedia, Islanda, Gjermania, Franca, etj., kanë prezantuar “kuotat e babait” për pushimin prindëror. Këto kuota, që

ndryshe quhen muajt e baballarëve, kanë për qëllim të stimulojnë baballarët të marrin pushimin dhe të merren më shumë me kujdesin për fëmijët dhe punët e shtëpisë.

Krijimi i këtyre politikave ka pasur efekt të drejtpërdrejtë pozitiv në krijimin e përgjegjësive të baballarëve për tu kujdesur për fëmijët. Gjatë kësaj kohe, ata krijojnë aftësi për përkujdesje dhe empati për familjen, që ndikon pozitivisht në kujdesin për fëmijën në vitet pasuese.

Përdorimi i pushimit të atësisë në mënyrë indirekte ka ndikuar pozitivisht në kohën e përkujdesjes ndaj fëmijëve por edhe ka sjellur ndryshime në pritjet e shoqërisë dhe normat në lidhje me rolin e burrit në familje. Rezultatet e hulumtimeve të Vandeweyer dhe Glorieux (2008), tregojnë se meshkujt belg që ndërprejnë karrierën gjatë pushimit të atësisë, pjesën më të madhe të kohës së tyre të lirë e përdorin duke kryer punë të shtëpisë dhe duke u përkujdesur për fëmijët, dhe kështu rezultatet përfundojnë se inkurajimi i burrave që tërhiqen nga puna, mund të jetë mënyra më e mirë për të arritur barazinë gjinore në familje. Madje në rezultatet e studimit për mënyrën e përdorimit të kohës nga ana e burrave në 20 vende të ndryshme, Hook (2006) (në: Nooman, 20) tregon se në vendet ku burrave u ofrohet mundësia e lejes prindërore, baballarët shpenzojnë 2 orë në javë më shumë për të kryer punë të shtëpisë sesa baballarët që jetojnë në vendet ku pushimet prindërore, nuk janë në dispozicion për burrat.

Duke u munduar ta paraqes ndikimin e pushimit dymujor të atësisë tek baballarët gjerman, Tamm (2018) ka analizuar të dhënat nga viti 2000 deri më 2015 të Panelit Socio-Ekonomik (SOEP), ku kanë marrë pjesë rreth 30000 pjesëmarrës në secilin vit. Fokusi i tij ishte paraqitja e dallimeve të sjelljeve të baballarëve, që kanë marrë pushimin e atësisë dhe atyre që nuk e kanë shfrytëzuar këtë pushim.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se pushimi prindëror i baballarëve, ka ndikim të rëndësishëm në kohën që baballarët i kushtojnë kujdes fëmijëve, dhe kjo çon në zvogëlimin e dallimeve gjinore në ndarjen e punëve të shtëpisë. Ai pohon se periudhat e shkurtëra të pushimit prindëror të baballarëve kanë efekte afatgjata jo vetëm në përfshirjen e baballarëve në kujdesin për fëmijët dhe punët e shtëpisë, por edhe në përfshirjen e grave në tregun e punës.

Rezultate të ngjashme shohim edhe në studimin e Kotsadam dhe Finseraas (2011), që pohojnë se të anketuarit që kishin fëmijë menjëherë pas futjes në fuqi të ligjit për shfrytëzimin e pushimit 4 javorë të atësisë në Norvegji, raportuan një nivel më të ulët të konflikteve për ndarjen e punës në

familje (vetëm 11 për qind) dhe se ata kanë 50% më shumë gjasa t'i ndajnë në mënyrë të barabartë punët e tjera, siç është detyra e larjes së rrobave sesa të anketuarit që kishin fëmijë pak para reformës.

4.1.3 Subvencionet për kujdesin për fëmijë

Një politikë tjetër familjare që mund të ndikojë në ndarjen më të barabartë të punëve të shtëpisë në mes të bashkëshortëve është subvencionimi i kujdesit për fëmijë dhe hapja e institucioneve publike. Me subvencionimin e kujdesit për fëmijë, punëdhënësit ose qeveria mbajnë një pjesë ose të gjitha shpenzimet e familjes për kujdesin ndaj fëmijëve, në këtë mënyrë u mundësohet nënave të punojnë jashtë shtëpisë, si pasojë, reduktohet koha e shpenzuar nga ato për tu kujdesur për fëmijët. Për të vërtetuar këtë teori Van der Lippe (2010) ka përdorur të dhëna nga 17 vende evropiane dhe ka përfunduar se më shumë shpenzime për kujdesin e fëmijëve në nivelin e vendit lidhen me më shumë kohë në punën e paguar nga gratë, veçanërisht kur fëmijët janë të vegjël. Në të njëjtin studim ai ka konstatuar se edhe pse subvencionimi për kujdesin ndaj fëmijëve lidhet me reduktimin e kohës që gratë shpenzojnë për kryerjen e punëve të shtëpisë dhe për kujdesin ndaj fëmijëve, ky subvencionim nuk ndikon në ndarjen simetrike të këtyre përgjegjëseve me burrat e tyre. Të njëjtat rezultate i shohim edhe te Hook (2020), e cila pohon se mundësia për regjistrimin e fëmijëve në institucionet e kujdesit të subvencionuara për fëmijë ndikon drejtpërdrejtë në zvoglimin e kohës që gratë e kalojnë për të bërë punët e shtëpisë, kurse sa i përket kohës së burrave, kjo mundësi nuk ndikon as në rritjen e as në reduktimin e kohës që ata kalojnë për të bërë punë në familje.

Pra, disponueshmëria e kujdesit publik ndaj fëmijëve nuk ndikon drejtpërdrejtë në ndarjen e barabartë të punëve në familje midis bashkëshortëve. Ndikimi i subvencionimit është i tërthortë. Me të u mundësohet grave të mos shkëputen nga tregu i punës, por edhe duke u lënë institucioneve përkatëve barrën kryesore për kujdesë, me ndihmën e subvencionimit do të zbeheshin stereotipet gjinorë dhe modeli i familjes borgjeze i shek. të 19.

4.2 Kontributi i OJQ-ve në ndarjen më të drejtë të punëve në familjet kosovare

4.2.1 Demokracia në zhvillim (D4D)

Për të zvogëluar hendekun gjinor për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare, Organizata Joqeveritare D4D ka krijuar disa politika që

lidhen sidomos me inkuadrimin e grave në tregun e punës dhe lejen prindërore. Në këtë mes po përmendim projektin “Rritja e qasjes së grave në punësim”, në kuadër të të cilit, në vitin 2020 janë sponsorizuar dhe vazhdon tu ofrohet ndihmë organizative dhe mentoruese 7 organizatave, që më 2020 kanë fituar grante. Projekte të tilla kanë qenë pjesë e aktiviteteve kyçe të kësaj organizate.

Duke qenë se, kjo organizatë ka punuar papushim për barazi gjinore, në kuadër të projektit “Leja prindërore për barazi gjinore” (2017) është publikuar punimi “Ndryshimi i paradigmës – Barazi përmes lejes prindërore, i përgatitur nga Kërçeli (2017), në të cilin është protestuar për ndryshimin e ligjit aktual për pushim të lehoisë, të cilin autorja e konsideron diskriminues jo vetëm në raport të mos-lejimit të burrave të marrin pjesë në jetën e fëmijëve por dhe për dekurajimin e grave të mos kërkojnë punë. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se burrat kosovarë janë të gatshëm të marrin leje prindërore nëse ju ofrohet kjo mundësi dhe sidomos pas muajit të gjashtë të lindjes së fëmijës. Në të njëjtin punim kërkohet të bëhen ndryshime në sistemin aktual, si dhe në Ligjin e Punës dhe në atë të Mirëqenies Sociale, që të aprovohet një ligj *që garanton lejen e lindjes, të atësisë dhe një leje prindërore të pa transferueshme për nënën dhe babanë*, së bashku me një ndarje të lejes me pagesë dhe pa pagesë. Ky model i lejes prindërore është skema e përgatitur nga D4D, sipas së cilës, *4 muaj i ndahen nënës si leje e lindjes me 70% të pagës së saj bazë; 1 muaj i ndahet babait si leje e atësisë – 70% të pagës së tij bazë*. Përveç kësaj, familja merr 8 muaj leje prindërore, nga të cilët katër muaj ndahen për nënën. Dy muaj të lejes prindërore për nënën mbulohen me shkallen prej 50% të pagës mesatare në vend nga ana e shtetit dhe dy muaj janë pa pagesë. Katër muaj e mbetur i ndahen babait. Dy muajt e lejes prindërore për babain mbulohen me shkallen prej 50% të pagës mesatare në vend nga ana e shtetit dhe dy muaj janë pa pagesë.

Kjo skemë është një përpjekje konkrete për ngushtimin e hendekut gjinorë në ndarjen e punëve në familje nga ana e bashkëshortëve. Këto skema, siç kemi theksuar më lartë janë makropolitika të vendeve të zhvilluara, me ndihmën e të cilave pamë se kanë ndikuar në politikat mikro të punëve në familje. Madje, siç ceket edhe në këtë hulumtim, skema të tilla bëjnë pjesë në direktivat e BE-së (Direktiva 2010/18 /BE, në Kërçeli, 2017), që janë pjesë e standardeve që duhet plotësuar në mënyrë që Kosova të anëtarësohet në Bashkimin Evropian.

4.2.2 Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP)

Përveç aktiviteteve të rregullta të INDEP me nxënës të shkollave fillore, me qëllim që të ndikojnë në zhdukjen e stereotipeve gjinore dhe ngulitjen e idesë për barazi gjinore tek të rinjtë tanë, ky

institut përmes projekteve të ndryshme kontribuon në inkuadrimin e grave në pozita vendimmarrëse dhe në rregullime legjislativë. Vlenë të përmendet hulumtimi i Rrahmanit (2020) e cila ka paraqitur të gjitha ligjet për barazi gjinore në Kosovë, ka analizuar ato dhe mënyrën e zbatimit të tyre, si dhe ka paraqitur mënyra të përmirësimit të tyre.

Po veçojmë analizën e legjislacionit që mbulon vlerësimin e punës së papaguar dhe diskriminimin në bazë të gjinisë në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime, si dhe mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të këtij legjislacioni.

Duke trajtuar nenet dhe rregulloret e lidhura me këtë legjislacion, autorja thekson se Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Neni 17(1.15) parashikon *detyrime për punëdhënësit që të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u mundësuar grave dhe burrave të përshtatin detyrimet e tyre profesionale dhe familjare*. Ky ligj plotësohet, edhe me Nenin 17(2) sipas të cilit, pas kthimit nga pushimi i lehonisë ose pushimi prindëror, punonjësi ka të drejtë të kthehet në të njëjtin vend të punës ose në një vend pune të barazvlershëm, me kushte që nuk janë më pak të favorshme për të dhe të përfitojë nga çdo përmirësim në kushtet e punës në të cilat do të kishte të drejtë gjatë periudhës kur ka munguar (Gazeta Zyrtare e RK, 2015).

Sa i përket respektimit të këtij ligji, flasin rezultatet e hulumtimeve të ndryshme sipas të cilave, grave iu pamundësohet e drejta për të marrë pjesë në tregun e punës (shih: 2.1.1 të këtij punimi). Kjo për shkak se punëdhënësit duhet ta zbatojnë Ligjin e Punës për pushimin e lehonisë por, siç thekson autorja, nuk janë në dijeni në lidhje me LBGj. Madje duke shqyrtuar ankesat e grave në lidhje me padrejtësitë në punë, autorja pohon se, gratë mund të mos kenë dijeni se çka në fakt përbën diskriminim gjinor.

Sipas LBGj, edhe puna e papaguar e grave dhe burrave vlerësohet si kontribut për zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë, dhe përfshinë kujdesin për mirëqenien e familjës, fëmijëve, anëtarit të familjes ose kur merren me bujqësi dhe ekonomi familjare. Por sa i përket zbatimit të këtij ligji në praktikë autorja pohon se kjo dispozitë keqinterpretohet duke qenë se gjyqësori tenton të mos e vlerësojë kontributin jofinanciar të grave në familje gjatë vlerësimit të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve gjatë divorcit dhe përfundon, duke u shprehur se “ndonëse dispozitat e LBGj-së adresojnë fushën e punës detajisht duke shkuar aq larg sa të vlerësojnë shprehimisht edhe punën e papaguar të grave dhe burrave, në realitet këto dispozita nuk gjejnë zbatim”. Përveç pasqyrimin të bazës ligjore të temës që po trajtojmë në këtë punim, shohim se edhe INDEP e vlerëson ligjin për

pushimin e lehonisë si faktorë që ndikon në rritjen e hendekut gjinorë në tregun e punës dhe në ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në mes të bashkëshortëve dhe ka reaguar për ndyshimin e tij, para se ai të miratohet.

5 METODOLOGJIA

5.1 Pjesëmarrësit

Me qëllim që të jemi sa më objektiv në paraqitjen e të dhënave, si instrument të hulumtimit kemi përzgjedhur pyetëtorin, me ndihmën e të cilit do të paraqesim të dhëna statistikore për perceptimet e burrave dhe grave nga komuna të ndryshme të Kosovës, në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkëshortësi, si dhe mënyrën e ndarjes së këtyre përgjegjësive në mes tyre. Të gjithë pjesëmarrësit e këtij hulumtimi janë përzgjidhur në mënyrë rastësore dhe kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur pyetjeve. Para marrjes së pëlqimit të pjesëmarrësve për t'iu përgjigjur pyetjeve, i kemi pyetur a kanë fëmijë dhe çfarë moshe kanë fëmijët e tyre, për arsye se pjesë e hulumtimit kemi dashur të jenë prindërit me fëmijë të moshave 0-5 vjeç.

Sa i përket paraqitjes së perceptimeve të OJQ-ve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkëshortësi, kemi përdorur instrumentin e intervistës, me qëllim që perceptimet e tyre të analizohen në mënyrë kualitative. Edhe para ekzekutimit të intervistës, kemi marrur pëlqimin e pjesëmarrësve, të cilët kanë sugjeruar vendin dhe kohën e ekzekutimit të saj. Për shkak të situatës së krijuar me përhapjen e pandemisë COVID-19, shumica e intervistave janë bërë online.

5.2 Metodatat e hulumtimit

Siç e cekëm më lartë, hulumtimi ka karakter kuantitativ dhe kualitativ. Metodatat për mbledhjen e të dhënave, pra, janë pyetëtori dhe intervista gjysëm e strukturuar.

Pyetëtori përbëhet nga 15 pyetje të mbyllura apo gjysëm të mbyllura, që do të na mundësojnë të paraqesim të dhëna bio-sociale në lidhje me gjininë, moshën, nivelin arsimor, statusin e punësimit të pjesëmarrësve, si dhe strukturën familjare në të cilën ata jetojnë. Në raport me të dhënat bio-sociale, do të paraqesim llojin e obligimeve ditore në familje që i kryejnë bashkëshortët e të dy gjinive, kohën të cilën e shpenzojnë për të përmbushur këto obligime, si dhe qëndrimin e tyre në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në bashkëshortësi, e sidomos kur bëhet fjalë për kujdesin ndaj fëmijëve. Meqë temë kyçe e shumicës së OJQ-ve tani është futja në fuqi e ligjit për leje prindërore dhe pjesëmarrje më aktive të grave në tregun e punës, interes të veçantë i kemi kushtuar qëndrimit të bashkëshortëve në lidhje me gratë e punësuar dhe lejen prindërore, veçanërisht pushimit të atësisë.

Intervista ishte e ndarë në 3 seksione:

Qëndrimi i përfaqësuesëve të OJQ-ve në lidhje me ekzistencën e stereotipeve gjinorë dhe ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve, në varësi nga tiparet e këtyre stereotipeve, si dhe ekzistencën ose jo të diskriminimit gjinor në familjet kosovare.

Qëndrimi i përfaqësuesëve të OJQ-ve në lidhje me ndarjen tradicionale të punës në familje

Qëndrimi i përfaqësuesëve të OJQ-ve në lidhje me pushimin e lehonisë dhe atë të pushimin e atësisë.

5.3 Pritshmëritë në lidhje me përdorimin e rezultateve të hulumtimit

Me anë të këtij hulumtimi, kemi dashur të ndikojmë në ngritjen e ndërgjegjjes së bashkëshortëve, sidomos burrave në lidhje me ndarjen më të drejtë të të drejtave dhe përgjegjësi në familje. E dobishme do të jetë për të gjithë ata që u intereson mënyra e ndarjes së këtyre përgjegjësi në familjet kosovare, veçanërisht për institucionet për mirëqenie sociale dhe ata të drejtësisë, që do të mund të gjejnë një pasqyrë reale të gjendjes së gruas në familje dhe jetën shoqërore, dhe duke u nisur nga sugjerimet e pjesëmarrësve dhe ato të përfaqësuesve të OJQ-ve, të krijojnë strategji më të përshtatshme që të ndikojnë në ndarjen më të drejtë të punëve në familje përmes politikave në nivelin makro.

5.4 Procesi i mbledhjes së të dhënave

Procesi i mbledhjes së të dhënave është bërë nga 01 tetor 2020 deri më 30 tetor 2020, kurse intervistimi ka filluar më 26 nëntor deri me 11 dhjetor 2020. Procesi i mbledhjes së të dhënave ka përfunduar në dhjetor të vitit 2020.

Idea fillestare ka qenë përdorimi i pyetësorit online, por meqë pjesëmarrësit në hulumtim është dashur të jenë prindër të fëmijëve 0-5 vjeç, kemi zbatuar metodën klasike të anketimit, duke përzgjedhur në mënyrë rastësore prindër me karroca apo me fëmijë të vegjël para qendarve tregtare dhe në sheshe qytetesh e parqe, ku nuk kemi pasur qasje në internet. Anketimi është bërë në sheshin e qytetit të komunës së Prishtinës, parkun Gërmia, qendrën tregtare Abi Çarshi, në Prizren, në qendër të qytetit të Podujevës, në qendrën e qytetit të Drenasit dhe në qendër të qytetit të Gjilanit.

Edhe mënyra e ekzekutimit të intervistave, ka qenë e planifikuar të bëhet drejtpërdrejt duke planifikuar vendin dhe kohën e takimit me përfaqësues të OJQ-ve, por për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia, zyrat e OJQ-ve kanë qenë të mbyllura, kështu jemi detyruar të gjejmë kontaktet e shumë përfaqësuesëve, të cilët nuk kanë pranuar të bëjmë takime dhe kanë sugjeruar tu dërgohen pyetjet përmes e-mailit. Në mesin e 5 të intervistave, vetëm dy na kanë ofruar mundësinë, që intervistën ta bëjmë përmes telefonit, ku kemi pasur mundësi të shkurtrojmë përgjigjet e tyre (kur kanë filluar të flasin për çështje që kanë qenë të planifikuara në pyetjet pasuese) ose të bëjmë pyetje shtesë (kur kanë filluar të flasin për fenomene me rëndësi për studimin tonë).

Etika e hulumtimit

I gjithë hulumtimi është bërë duke iu përmbajtur rregullave të Shoqatës Sociologjike Britanike të Praktikës Etike (2001), me respektimin e të cilave jemi detyruar të mbajmë përgjegjësi të plotë për sigurimin e mirëqenies fizike, sociale dhe psikologjike të pjesëmarrësve.

Të gjithë pjesëmarrësit në studim paraprakisht kanë qenë të informuar mbi qëllimin e studimit, u kemi siguruar se të dhënat do të përdoren në mënyrë konfidenciale si dhe do të ruajmë anonimitetin. Përveç kësaj kemi marrë miratimin për pjesëmarrjen vullnetare në hulumtim nga secili pjesëmarrës.

Sa i përket etikës procedurale gjatë gjithë kohës kemi pasur parasysh rëndësinë e përpikmërisë duke shmangur falsifikimin, mashtrimin dhe sajimin. Në këtë mënyrë jemi siguruar që të mos keqpërdorim të dhënat, të shmangim subjektivitetin në mënyrë që punimi të përmbajë të dhëna sa më të besueshme. E njëjta etikë është përdorur gjatë përdorimit të literaturës. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

6 REZULTATET

6.1 Rezultatet e pyetësorit

6.1.1 Të dhënat demografike

Pyetësorit iu kanë përgjigjur 152 pjesëmarrës, prej të cilëve 80 (52.63 %) janë gra, kurse 72 (47.37 %) janë burra.

Vlerat	Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlerave
Gra	80	52.63	52.63
Burra	72	47.37	47.37
Totali	152	100	100

Sa i përket moshës, 15 pjesëmarrës kanë qenë në moshë të re (18-24 vjeç), 15 kanë qenë në moshë të re (25-34 vjeç), 98 në moshë të mesme (35-44 vjeç), kurse 14 pjesëmarrës kanë qenë në moshë të mesme të shtyer (45-55 vjeç) dhe 10 kanë qenë në moshë të shtyer.

Gjinia	Mbi 18-24 vjeç	Mbi 25-34 vjeç	Mbi 35-44 vjeç	Mbi 44-56 vjeç	Mbi 56 vjeç	Totali
Gra	10	10	56	4	0	80
	12.50%	12.50%	70.00%	5.00%	0.00%	100.00%
	66.67%	66.67%	57.14%	28.57%	0.00%	52.63%
	6.58%	6.58%	36.84%	2.63%	0.00%	52.63%
Burra	5	5	42	10	10	72
	6.94%	6.94%	58.33%	13.89%	13.89%	100.00%
	33.33%	33.33%	42.86%	71.43%	100.00%	47.37%
	3.29%	3.29%	27.63%	6.58%	6.58%	47.37%
Totali	15	15	98	14	10	152
	9.87%	9.87%	64.47%	9.21%	6.58%	100.00%

100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%
9.87%	9.87%	64.47%	9.21%	6.58%	100.00%

Sa i përket statusit të punësimit, 15.79 për qind e pjesëmarrësve janë të papunësar, prej të cilëve 66.66 për qind janë gra (16 prej tyre) dhe 50 për qind janë burra respektivisht 8 pjesmarrës. Të punësuar janë 75.65 për qind e pjesëmarrësve, prej të cilëve 60 janë gra (75%) dhe 55 burra (76%), kurse të vetëpunësuar janë 8.55 për qind e pjesëmarrësve prej të cilëve 4 janë gra (5%) dhe 9 burra (12.50%).

Table 3 Statusi i punësimit të pjesëmarrësve sipas gjinisë

Gjinia	I/ e papunësuar	I/ e punësuar	I / e vetëpunësuar	Totali
Gra	16	60	4	80
	20.00%	75.00%	5.00%	100.00%
	66.67%	52.17%	30.77%	52.63%
	10.53%	39.47%	2.63%	52.63%
Burra	8	55	9	72
	11.11%	76.39%	12.50%	100.00%
	33.33%	47.83%	69.23%	47.37%
	5.26%	36.18%	5.92%	47.37%
Totali	24	115	13	152
	15.79%	75.66%	8.55%	100.00%
	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%
	15.79%	75.66%	8.55%	100.00%

Sa i përket të dhënave në lidhje me strukturën e familjes ku pjesëmarrësit jetojnë, janë paraqitur këto rezultate. Pjesëtarë të familjeve të zgjeruara, ku përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre jetojnë edhe prindërit e bashkëshortit/es, janë 56 (36.84 %) pjesëmarrës, prej të cilëve 30 (37.50 %) janë gra dhe 26 (36%) janë burra.

Pjesëtarë të familjeve me dy apo më shumë bërthama, ku jetojnë 2 ose më shumë familje bërthamë janë 3.95 % e pjesëmarrësve (6 prej tyre). 2 (2.50 %) janë gra dhe 4 (5.56 %) burra. Pjesëtarë të familjeve bërthamë janë shumica e pjesëmarrësve, apo 59.21 për qind (90 prej tyre). 48 (60%) janë gra dhe 42 (58.33%) janë burra. Rezultatet më të detajuara ndodhen në tabelën në vijim.

Table 4 Struktura e familjes, ku pjesëmarrësit jetojnë në raport me gjininë					
Gjinia	Familje e zgjeruar	Familje me dy ose më shumë bërthama	Familje bërthamë	Totali	
Gra	30	2	48	80	
	37.50%	2.50%	60.00%	100.00%	
	53.57%	33.33%	53.33%	52.63%	
	19.74%	1.32%	31.58%	52.63%	
Burra	26	4	42	72	
	36.11%	5.56%	58.33%	100.00%	
	46.43%	66.67%	46.67%	47.37%	
	17.11%	2.63%	27.63%	47.37%	
Totali	56	6	90	152	
	36.84%	3.95%	59.21%	100.00%	
	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	
	36.84%	3.95%	59.21%	100.00%	

6.1.2 Qëndrimi i pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësisve në bashkshortësi

Për shkak të prezencës së stereotipave gjinorë në Kosovë, kemi dashur ta verifikojmë se si e vlerësojnë gratë dhe burrat ndarjen tradicionale të punës në familje: *Burrat punojnë - Gratë kryejnë punët e shtëpisë*, dhe si ndikon gjinia, mosha, niveli arsimor, statusi i punësimit dhe struktura e familjes ku ata jetojnë në krijimin e qëndrimit përkatës.

Qëndrimin në lidhje me ndarjen e punëve në familje e kemi matur me pyetjen e parë të objektit të studimit: *A pajtoheni me ndarjen tradicionale të punës në familje, Burrat punojnë - Gratë kryejnë punët e shtëpisë*. Si njësi matëse kemi përdorur parametrat: *pajtohem plotësisht, pajtohem, i/e papërcaktuar, nuk pajtohem dhe nuk pajtohem aspak*.

Table 5 Qëndrimi i pjesëmarrësve për ndarjen tradicionale të punës në familje në raport me gjininë

Gjinia	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	I/e papërcaktuar	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak	Totali
Gra	0	4	2	26	48	80
	0.00%	5%	2.50%	32.50%	60%	100.00%
	0.00%	33.33%	100%	37.14%	82.75%	0.00%
	0.00%	2.63%	1.31%	17.10%	31.78%	52.82%
Burra	2	8	0	44	10	64

	3.12%	12.50%	0.00%	68.76%	15.62%	100.00%
	1.00%	66.66%	0.00%	62.78%	17.24%	44.15%
	1.39%	5.26%	0.00%	30.56%	6.94%	44.15%
Totali	2	12	2	70	58	144
	3.12%	8.33%	3.12%	40.61%	40.27%	95.45%
	1.38%	8.33%	1.38%	48.61%	40.28%	93.72%
	1.39%	8.33%	3.12%	40.61%	40.27%	93.72%

Sipas rezultateve të paraqitura në tabelë, shohim se, qëndrim skajshmërisht të kundërt me këtë mënyrë të ndarjes së punëve në familje kanë 40.27 për qind e pjesëmarrësve, prej të cilëve 31.78 për qind janë gra (48) dhe vetëm 6.94 për qind janë burra (10 prej tyre). Kundër kësaj ndarjeje janë 40.61 për qind (17.10 % gra dhe 30.56 % burra). Qëndrim neutral kanë 3.78 për qind të pjesëmarrësve, prej të cilëve janë 2 gra (1.31 % e shumës totale të pjesëmarrësve) përkatësisht 2.50 për qind e grave. Sa i përket qëndrimit pozitiv në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve, rezultatet tregojnë përqindje më të lartë të burrave se sa të grave. Qëndrim skajshmërisht pro kësaj mënyre, kanë vetëm 1.39 përqind e pjesëmarrësve, prej të cilëve nuk është asnjë grua dhe 3.12 prej pjesëmarrësve të gjinisë mashkullore (2 burra). Qëndrim pozitiv kanë 8.33 përqind të pjesëmarrësve, prej të cilëve 2.63 për qind janë gra (4 apo 5% e tyre) dhe 5.26 për qind janë burra (8 apo 12.50 % e tyre)

6.1.2.1 Ndikimi i faktorëve bio-social në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkshortësi

Për të paraqitur ndikimin e faktorëve bio-social në krijimin e qëndrimit të caktuar në lidhje me ndarjen e punëve në familje, po krahasojmë rezultatet e pyetjes së parë të objektit të studimit me të gjitha të dhënat bio-sociale që i kemi mbledhur nga pyetjet e pjesës hyrëse të pyetësorit, që kanë të bëjnë me moshën, strukturën e familjes, ku pjesëmarrësit jetojnë, nivelin arsimor dhe statusin e tyre të punësimit.

6.1.2.1.1 *Ndikimi i moshës në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen tradicionale të të drejtave dhe përgjegjësive në bashkëshortësi*

Mosha	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	I/e papërcaktuar	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak	Totali
Mbi 18-24 vjeç	0 0.00%	0 0.00%	0 0.00%	7 70.00%	3 30.00%	10 100.00%
	0.00%	0.00%	0.00%	26.92%	6%	33.17%
	0.00%	0.00%	0.00%	8.75%	3.75%	12.50%
Mbi 25-34 vjeç	0 0.00%	0 0.00%	0 0.00%	3 30.00%	7 70.00%	10 100.00%
	0.00%	0.00%	0.00%	11.53%	14.59%	12.50%
	0.00%	0.00%	0.00%	3.75%	8.75%	12.50%
Mbi 35-44 vjeç	0 0.00%	1 1.79%	2 3.57%	15 26.78%	38 67.85%	56 100.00%
	0.00%	25.00%	100.00%	57.69%	79.17%	68.75%
	0.00%	1.25%	2.50%	18.75%	47.5%	70.00%
Mbi 44-56 vjeç	0 0.00%	3 75.00%	0 0.00%	1 25%	0 0.00%	4 100%
	0.00%	75.00%	0.00%	3.84%	0.00%	79%
	0.00%	3.75%	0.00%	1.25%	0.00%	5%
Mbi 56 vjeç	0 0.00%	0 0.00%	0 0.00%	0 0.00%	0 0.00%	0 0.00%
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

Siç e shohim në tabelë mosha është një faktorë që ndikon në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve për ndarjen e punëve në familje. Nga 10 gra të moshës 18-24 vjeçare 7 nuk pajtohen dhe 3 nuk pajtohen aspak me ndarjen tradicionale të punës në familje. Qëndrim negativ kanë edhe gratë e moshës 24-34 vjeçare, 70 për qind e të cilave nuk pajtohen aspak kurse 30 për qind nuk pajtohen me ndarjen tradicionale të punëve në familje. 75 për qind e grave që kanë qëndrim pozitiv në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje, i takojnë moshës 44-56 vjeçare, vetëm 25 për qind e

grave të kësaj grupmoshe kanë qëndrim negativ, kurse pjesa e mbetur e grave që kanë qëndrim pozitiv i takojnë grupmoshës 35-44 vjeçare, të cilat në krahasim me pjesën tjetër të grave të kësaj grupmoshe përbëjnë vetëm 1.79 të tyre. Të kësaj grupmoshe janë edhe 2 gra që kanë qëndrim neutral në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje. Por këto gra përbëjnë vetëm 3.57 për qind të grave të kësaj grupmoshe.

Table 11 Qëndrimi i burrave për ndarjen tradicionale të punës në familje në raport me moshën

Mosha	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	I/e papërcaktuar	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak	Totali
Mbi 18-24 vjeç	0	0	0	2	3	5
	0.00%	0.00%	0.00%	40.00%	60.00%	100.00%
	0.00%	0.00%	0.00%	4.54%	30%	34.54%
	0.00%	0.00%	0.00%	3.12%	4.69%	7.81%
Mbi 25-34 vjeç	0	1	0	8	1	10
	0.00%	10.00%	0.00%	80.00%	10.00%	100.00%
	0.00%	12.50%	0.00%	18.18%	10.00%	40.68%
	0.00%	1.56%	0.00%	12.50%	1.56%	15.62%
Mbi 34-44 vjeç	0	1	0	32	6	39
	0.00%	2,56%	0.00%	82.05%	15.38%	97.43%
	0.00%	12.50%	0.00%	72.72%	60%	145.22%
	0.00%	1.56%	0.00%	50.00%	9.37%	60.93%
Mbi 44-55 vjeç	1	3	0	2	0	6
	16.67%	50%	0.00%	33%	0.00%	100.00%
	50.00%	37.50%	0.00%	4.54%	0.00%	92.04%
	1.57%	4.68%	0.00%	3.12%	0.00%	9.37%
Mbi 56 vjeç	1	3	0	0	0	4
	25.00%	75%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%
	50.00%	37.50%	0.00%	0.00%	0.00%	87.50%
	1.56%	4.69%	0.00%	0.00%	0.00%	6.25%

Rezultatet e paraqitura në tabelë tregojnë se si te gratë, ashtu edhe te burrat, mosha është faktor që ndikon në qëndrimin e tyre në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje. Burrat e rinj kanë qëndrim më negativ se sa burrat më të moshuar. 50% e burrave që pajtohen plotësisht me

ndarjen tradicionale të punëve në familje janë më të moshuar se 56 vjeç, kurse gjysma tjetër e burrave me qëndrim të tillë i takojnë grupmoshës 44-55 vjeç. Edhe 75 përqind e burrave që kanë qëndrim pozitiv janë më të moshuar se 56 vjeç, qëndrim të tillë kanë 50 përqind e burrave të moshës 44-55 vjeçare dhe vetëm 2.6 përqind e burrave të moshës 34-44 vjeçare dhe 10 përqind e burrave të moshës 24-34 vjeçare.

Qëndrim skajshmërisht kundër ndarjes së punëve në familje kanë 60 përqind e burrave të moshës 18-24, kurse 40 përqind prej tyre janë kundër ndarjes së tillë të punëve në familje. Sa i përket të dhënave statistikore, 60 përqind e burrave që janë skajshmërisht kundër ndarjes tradicionale të punëve në familje i takojnë grupmoshës 34-44 vjeçare, kurse pjesa tjetër janë edhe më të rinj (10% -24-34, dhe 30% -18-24 vjeç). Edhe 72.2 përqind të burrave, që janë kundër ndarjes së tillë të punëve në familje janë të moshës 34-44, kurse pjesa e mbetur janë të moshave 24-34 (18%) dhe 18-24 (4.52%). 4.52 përqind e burrave që kanë qëndrim të tillë i takojnë grupmoshës 45-55 vjeçare, por shikuar në tjetër perspektivë ata përbëjnë vetëm 33 % të burrave të kësaj grupmosheje, njëjtë sikur burrat e moshave të reja që kishin qëndrim pozitiv në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje, të cilët përbënin vetëm 10% të burrave të grupmoshave 24-34 vjeç dhe 2.5% të burrave të grupmoshës 34-44.

6.1.2.1.2 *Ndikimi i nivelit arsimor në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkshortësi*

Table 7 Qëndrimi i grave për ndarjen tradicionale të punës në familje në raport me nivelin arsimor

Niveli arsimor	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	I/e papërcaktuar	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Totali
Shkolla e mesme	0	0	0	4	6	10
	0.00%	0.00%	0.00%	40%	60%	100%
	0.00%	0.00%	0.00%	11.77%	1.50%	12.5%
	0.00%	0.00%	0.00%	5%	7.50%	13%
Studimet Bachelor	0	4	2	18	12	36

	0.00%	11.11%	5.56%	50%	33.33%	100.00%
	0.00%	100%	100%	52.94%	30%	45%
	0.00%	5%	2.50%	22.50%	15%	45%
Studimet						
Master	0	0	0	8	22	30
	0.00%	0.00%	0.00%	26.67%	73.33%	100.00%
	0.00%	0.00%	0.00%	23.52%	55.00%	37.5%
	0.00%	0.00%	0.00%	10%	27.50%	38%
Phd	0	0	0	4	0	4
	0.00%	0.00%	0.00%	100%	0.00%	100%
	0.00%	0.00%	0.00%	11.76%	0.00%	5%
	0.00%	0.00%	0.00%	5%	0.00%	5%

Sa i përket ndikimit të shkollimit në krijimin e një qëndrimit të caktuar në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje flasin rezultatet e paraqitura në tabelë, 40% e grave me shkollë të mesme janë kundër dhe 60% e tyre janë skajshmërisht kundër ndarjes tradicionale të punës në familje. Ndryshe nga gratë që kanë kryer studimet Bachelor, 11.11% e të cilave pajtohem me një ndarje të tillë dhe 5.56% kanë qëndrim neutral, kurse qëndrim kundër apo skajshmërisht kundër kësaj ndarjeje kanë 83.33% të grave me të njëjtin nivel arsimor. Edhe gratë, që kanë përfunduar studimet master kanë qëndrim kundër (73.33%) dhe skajshmërisht kundër (26.67%). Kurse të gjitha gratë me Phd kanë qëndrim skajshmërisht kundër ndarjes tradicionale të punëve në familje.

Table 8 Qëndrimi i burrave për ndarjen tradicionale të punës në familje në raport me nivelin arsimor

Niveli arsimor	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	I/e papërcaktuar	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Totali
Shkolla e mesme	0	1	0	0	5	6
	0.00%	16.67%	0.00%	0.00%	83.33%	100%
	0.00%	12.50%	0.00%	0.00%	11.36%	9.38%
	0.00%	1.56%	0.00%	0.00%	7.81%	9.38%

Studimet						
Bachelor	2	5	0	5	28	40
	5%	12.50%	0.00%	12.50%	70%	100%
	100%	62.50%	0.00%	50%	63.63%	62.5%
	3.12%	7.81%	0.00%	7.81%	43.75%	62.5%
Studimet						
Master	0	2	0	3	11	16
	0.00%	12.50%	0.00%	18.75%	68.75%	100%
	0.00%	25%	0.00%	30%	25%	25%
	0.00%	9.37%	0.00%	4.68%	70.40%	25%
Phd	0	0	0	2	0	2
	0.00%	0.00%	0.00%	100%	0.00%	100%
	0.00%	0.00%	0.00%	20.00%	0.00%	3.12%
	0.00%	0.00%	0.00%	3.12%	0.00%	3.12%

Sa i përket ndikimit të shkollimit në krijimin e qëndrimit të burrave në lidhje në ndarjen tradicionale të punës në familje flasin rezultatet statistikore të paraqitura në tabelë. Sipas këtyre rezultateve shohim se 100 për qind e burrave që pajtohen plotësisht me një ndarje të tillë të punëve në familje kanë përfunduar studimet themelore, kurse 25 për qind e burrave që pajtohen me një ndarje të tillë kanë përfunduar studimet master, 65.5 për qind e tyre kanë përfunduar studimet themelore, kurse 12.5 për qind kanë përfunduar shkollën e mesme.

Qëndrim kundër ndarjes së tillë të punëve në familje kanë 44 burra, 25 për qind e të cilëve kanë përfunduar studimet master, prej të cilëve 64 për qind kanë përfunduar studimet themelore kurse 11 për qind shkollën e mesme.

Qëndrim skajshmërisht kundër ndarjen tradicionale të punëve në familje kanë 10 burra, 20 për qind e tyre kanë përfunduar studimet PhD, 30 përqind studimet Master kurse 50 përqind e tyre kanë përfunduar studimet themelore Bachelor.

Nëse nisemi nga një perspektivë tjetër, 100 për qind e burrave që kanë qëndrim skajshmërisht kundër ndarjes së punëve në familje kanë përfunduar studimet PhD, qëndrim të tillë kanë 18.75 % e burrave, që kanë përfunduar studimet Master, kurse 12.50 % e burrave që kanë përfunduar studimet themelore. Këto rezultate na bëjnë të themi se shkollimi ndikon në krijimin e qëndrimit më negativ për ndarjen e punëve në familje. Por nëse analizojmë rezultatet e burrave që pajtohen apo pajtohen plotësisht me ndarjen e tillë të punëve në familje, që përbëjnë 12.55% të burrave me

studime Bachelor dhe me rezultatet e burrave që nuk pajtohen me një ndarje të tillë të cilët përbëjnë 83 për qind të burrave me shkollë të mesme, mund të themi se shkollimi nuk është faktor qenësor që ndikon në krijimin e një qëndrimi të caktuar në lidhje me këtë dukuri.

6.1.2.1.3 *Ndikimi i statusit të punësimit në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkëshortësi*

Table 9 Qëndrimi i grave për ndarjen tradicionale të punës në familje në raport me statusin e punësimit

Statusi i punësimit	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	I/e papërcaktuar	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak	Totali
I/e panësuar	0	3	2	6	5	16
	0.00%	18.75%	12.50%	37.50%	31.25%	100.00%
	0.00%	75%	100%	23.07%	10.41%	20%
	0.00%	3.73%	2.50%	7.50%	6.25%	20.00%
I/e vetëpunësuar	0	0	0	2	2	4
	0.00%	0.00%	0.00%	50.00%	50%	100.00%
	0.00%	0.00%	0.00%	7.69%	41.16%	5.00%
	0.00%	0.00%	0.00%	2.50%	2.50%	5%
I/e punësuar	0	1	0	18	41	60
	0.00%	2%	0.00%	30%	68.33%	100.00%
	0.00%	25%	0.00%	69.23%	85.41%	75%
	0.00%	1.25%	0.00%	22.50%	51.25%	75.00%

Rezultatet e paraqitura në tabelë tregojnë se 75 % e grave që pajtohen me ndarjen tradicionale të punëve në familje janë të papunësuar dhe përbëjnë 18.75% të grave me status të tillë të punësimit. Pjesa e mbetur, 25% janë gra të punësuar, që përbëjnë vetëm 2 % të grave me status të tillë të punësimit.

Sa i përket grave që kanë qëndrim neutral në lidhje me ndarjen e tillë të punëve në familje, të gjitha (100%) janë të papunësuar dhe përbëjnë 12.50% të grave me status të tillë të punësimit. Pjesa tjetër e grave të papunësuar nuk pajtohen (37.50%) apo nuk pajtohen aspak (31.25%) me ndarjen tradicionale të punëve në familje.

Edhe pse shohim se shumica e grave të papunësuar kanë qëndrim negativ në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje, fakti se vetëm 2 % e grave të punësuar kanë qëndrim pozitiv në lidhje me një çështje të tillë, kurse 21.50% të grave të papunësuar kanë qëndrim pozitiv ose neutral, mund të themi se statusi i punësimit ndikon në krijimin e qëndrimit negativ në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje.

Table 10 Qëndrimi i burrave për ndarjen tradicionale të punës në familje në raport me statusin e punësimit

Statusi i punësimit	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	I/e papërcaktuar	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak	Totali
I/ e papunësuar	1	2	0	2	1	6
	16.67%	33.33%	0.00%	33.33%	16.67%	100.00%
	50.00%	25%	0.00%	4.54%	10%	9.37%
	1.56%	3.12%	0.00%	3.12%	1.56%	9.37%
I/ e punësuar	0	5	0	38	9	52
	0.00%	9.62%	0.00%	73.08%	17.30%	100.00%
	0.00%	62.50%	0.00%	83.36%	90%	81.25%
	0.00%	7.82%	0.00%	59.37%	14.06%	81.25%
I/ e vetëpunësuar	1	1	0	4	0	6
	16.67%	16.67%	0.00%	66.66%	0.00%	100.00%
	50.00%	12.50%	0.00%	9.09%	0.00%	9.37%
	1.56%	1.56%	0.00%	6.25%	0.00%	9.37%

Rezultatet tregojnë se si te gratë ashtu edhe te burrat, statusi i punësimit ndikon në krijimin e qëndrimit negativ në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje. 50 % e pjesëmarrësve që pajtohen plotësisht me një ndarje të tillë janë burra të papunësuar, kurse 50 % e tyre janë të vetëpunësuar. Rezultatet e paraqitura në kolonën e dytë janë më të miksuara, ku shohim se 62.50% e burrave që pajtohen me ndarjen tradicionale të punëve në familje janë të punësuar, që përbëjnë 9.62% të burrave me status të tillë të punësimit. Kurse pjesa e mbetur 12.50% janë të vetëpunësuar, që përbëjnë 16.67% të burrave me status të tillë të punësimit dhe 25% janë të papunësuar, që përbëjnë 33.33% të burrave me status të tillë të punësimit.

Meqë statusin e të punësuarit e kanë vetëm 9.37% e burrave që kanë marrë pjesë në hulumtim dhe 4.68% nga ata (gjysma) pajtohen ose pajtohen ose nuk pajtohen plotësisht me ndarjen tradicionale të punëve në familje. Kurse burra të punësuar janë 81.25% e pjesëmarrësve, prej të cilëve vetëm një e dhjeta (7.82%) pajtohem me një ndarje të tillë, themi se statusi i punësimit ndikon në krijimin e qëndrimit negativ në lidhje e ndarjen e punëve në familje.

6.1.2.1.4 *Ndikimi i strukturës së familjes, ku pjesëmarrësit jetojnë në krijimin e qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në bashkëshortësi*

Table 11 Qëndrimi i grave për ndarjen tradicionale të punës në familje në raport me strukturën e familjes ku jetojnë

Struktura e familjes	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	I/e papërcaktuar	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak	Totali
Familje e zgjeruar	0	2	0	10	18	30
	0.00%	6.67%	0.00%	33.33%	60.00%	100.00%
	0.00%	50.00%	0.00%	37.46%	38.00%	37.50%
	0.00%	2.50%	0.00%	12.50%	22.50%	37.50%
Familje me dy ose më shumë bërthama	0	0	0	0	2	2
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	1.17%	2.50%
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
Familje bërthamë	0	2	2	16	28	48
	0.00%	4.17%	4.17%	33.33%	58.33%	100.00%
	0.00%	50.00%	100.00%	61.53%	58%	3.84%
	0.00%	2.50%	2.50%	20.00%	35.00%	60.00%

Rezultate tregojnë se gratë që pajtohen me ndarjen tradicionale të punëve në familje i takojnë familjeve të zgjeruara, ku përveç familjes bërthamë, jetojnë edhe prindërit e bashkëshortit/es (50%), që përbëjnë 6.76% të grave që jetojnë në familje me strukturë të tillë dhe gratë që jetojnë në familje bërthamë (50%), 4.17% të grave që jetojnë në familje me strukturë të tillë. Edhe gratë që kanë qëndrim neutral në lidhje me një ndarje të tillë jetojnë në familje bërthamë (100%), që përbëjnë 4.17% të grave që jetojnë në familje me strukturë të tillë.

Sa i përket grave që jetojnë në familje me dy ose më shumë bërthama, të gjitha janë skajshmërisht kundër ndarjes tradicionale të punëve në familje.

Meqë përqindja e grave që jetojnë në familje të zgjeruara është 37.50%, prej të cilave 6.76% (1/5) pajtohen me ndarjen tradicionale të punëve në familje. Përqindja e grave që jetojnë në familje bërthamë është 60%, 8.34% (1/7) e të cilave kanë qëndrim pozitiv ose neutral në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje, kurse përqindja e grave që jetojnë në familje me dy bërthama është 2.50%, 100 përqind e të cilave nuk pajtohen aspak me ndarjen tradicionale të punëve në familje, mund të themi se sa me e gjerë të jetë familja, qëndrimi i grave kundër ndarjes tradicionale të punëve në familje është më i theksuar.

Table 12 Qëndrimi i burrave për ndarjen tradicionale të punës në familje në raport me strukturën e familjes ku jetojnë

Struktura e familjes	Pajtohem		I/e papërcaktuar	Nuk pajtohem		Totali
	plotësisht	Pajtohem		Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak	
Familje e zgjeruar	2	4	0	14	4	24
	8.33%	16.67%	0.00%	58.33%	16.67%	100.00%
	100.00%	50.00%	0.00%	31.81%	40.00%	37.50%
	3.12%	6.35%	0.00%	21.87%	6.25%	37.59%
Familje me dy ose më shumë bërthama	0	2	0	0	2	4
	0.00%	50.00%	0.00%	0.00%	50.00%	100.00%
	0.00%	50.00%	0.00%	0.00%	20.00%	6.25%
	0.00%	3.12%	0.00%	0.00%	3.12%	6.24%
Familje bërthamë	0	2	0	30	4	36
	0.00%	5.55%	0.00%	83.34%	11.11%	100.00%
	0.00%	50.00%	0.00%	68.18%	40%	56.25%
	0.00%	3.12%	0.00%	46.88%	6.26%	56.26%

Rezultatet tregojnë se 100% e burrave që pajtohen plotësisht me ndarjen tradicionale të punëve në familje jetojnë në familje të zgjeruara. Po ashtu 50% që pajtohe me ndarjen tradicionale të punëve në familje jetojnë në familje të zgjeruara. Pra, 63.15% e burrave që jetojnë në familje të zgjeruara pajtohen plotësisht ose pajtohen me ndarjen tradicionale të punëve në familje. 50% e burrave që jetojnë në familje me dy ose më shumë bërthama dhe vetëm 5.55% e burrave që jetojnë në familje bërthamë pajtohen me ndarjen tradicionale të punëve në familje, themi se sa më e gjerë të jetë familja, ku burrat jetojnë, qëndrimi i burrave për ndarjen tradicionale të punëve në familje është më pozitiv.

6.1.3 Ndarja e punëve në familje në mes të bashkëshortëve

Meqë temë kyçe në këtë punim ka qenë mënyra e ndarjes së detyrave familjare në mes të bashkëshortëve, në pyetësor kemi vendosur disa nga obligimet ditore të bashkëshortëve në familje, ku pjesmarrësit kanë përcaktuar intensitetin e përfshirjes së tyre, duke rrumbullakësuar njërin nga parametrat matës (6= Gjithnjë, 5= Shpeshherë, 4= Herë pas here, 3= Në raste të veçanta/ urgjente, 2= Rrallë dhe 1= Kurrë) në pyetjen: *Ju lutem përcaktoni intenzitetin e përfshirjes suaj në angazhimet ditore në familje duke vendosur një tik √ në vetëm njërin nga opsionet e ofruara në anën e djathtë të tabelës. Mënyrën e përfshirjes së bashkëshortëve në këto detyra e kemi paraqitur me ndihmën e korelacioneve në tabelën në vijim:*

Table 13 Mënyra e ndarjes së obligimeve ditore në mes të bashkëshortëve, sipas intenzitetit të përfshirjes së secilit prej tyre

	Gra							Burra							C(p)
	1	2	3	4	5	6	7	1	2	3	4	5	6	7	
Larja e eneve	10	14	12	14	6	4	30	5	5	7	9	9	12	17	51
	25.5	17.3	15.3	17.3	7.1	5.1	12.2	7	5.8	10.5	22.1	12.8	17.4	24.4	(<.001)
	3.4	2.4				-2.7	-2.1	-3.4	-2.4				2.7	2.1	
Gatimi	0	3	7	10	9	28	23	7	6	9	9	9	21	10	41
	0	5.1	8.2	12.2	11.2	34.7	28.6	10.5	8.1	12.8	12.8	12.8	29.1	14	(.016)
	-3.3						2.4	3.3						-2.4	
Pastrimi i shtëpise	2	1	6	11	12	21	28	5	12	8	17	14	12	2	62
	2	1	7.1	13.3	15.3	26.5	34.7	7	16.3	11.6	24.4	19.8	17.4	3.5	(<.001)
		-3.7					5.3		3.7					-5.3	
Pastrimi i Oborrit	9	8	7	15	10	12	19	37	15	7	7	2	1	0	72
	11.2	10.2	9.2	18.4	12.4	15.3	23.5	52.3	20.9	10.5	10.5	2.3	3.5	0	(<.001)
	-6	-2.2			2.6	2.7	4.8	6	2.2			-2.6	-2.7	-4.8	
Kujdesi per rregullin ne shtepi	1	1	0	6	13	25	35	4	4	11	15	19	15	3	.69
	1	1	0	7.1	16.3	30.6	43.9	5.8	5.8	15.1	20.9	26.7	20.9	4.7	(<.001)
			-4	-2.7			6.1			4	2.7			-6.1	
Sistemi dhe palimi i rrobave	15	0	2	6	14	18	39	22	18	8	13	5	3	1	83
	12.2	0	1	5.1	11.2	22.4	48	31.4	25.6	11.6	18.6	7	4.7	1.2	(<.001)
	-3.1	-5.3	-3	-2.8		3.5	7.2	3.1	5.3	3	2.8		-3.5	-7.2	
Hekuro sja	7	6	7	8	8	11	35	26	15	5	9	7	4	4	.66
	8.2	7.1	8.2	10.2	10.2	13.3	42.9	36	22.1	7	12.8	10.5	5.8	5.8	(<.001)

		14	14	12	12	10	8	11	6	1	3	11	8	12	30	.57
Kosijtja e		18.4	17.3	14.3	14.3	12.2	10.2	13.3	8.1	1.2	4.7	15.1	11.6	17.4	41.9	(<.001)
barit		2	3.7	2.2				-4.3	-2	-3.7	-2.2				4.3	
Ngasja e autom.		38	20	5	9	2	2	5	4	6	5	9	12	11	24	.76
per nevoja		46.9	24.5	6.1	11.2	2	3.1	6.1	5.8	8.1	7	12.8	17.4	15.1	33.7	(<.001)
te Familjes		6.3	3	-3.7				-2.9	-4.7	-6.3	-3	3.7	2.9		4.7	

Edhe pse në pyetja ka qenë e formuluar në atë mënyrë që pjesëmarrësit të vendosin një tik, në vetëm njërin nga parametrat matëse, shumë nga ata kanë përzgjedhur më shumë se një opsion. Duke mos dashur që të manipulohet me të dhëna dhe të përzgjedhim njërin nga opsionet e plotësuara, përgjigjet e tilla i kemi trajtuar si përgjigje të disa persovave, varësisht sa opsione kanë përzgjedhur. Kjo gjë vërehet në numrin total të pjesëmarrësve që në disa raste është më i madh se 152.

Sipas të dalurave në fund të analizës na paraqiten tri grupe të veçanta të punëve:

- Punët ku vlera e koeficientit të variancës është më e lartë se 55 që tregojn distancë të largët në mes të variablave për angazhimin e grave dhe të burrave:

Palimi dhe sistemimi i rrobave të familjes (koeficientit të variancës 83, > 55),

Kujdesi për mbajtjen e rregullit në shtëpi (koeficientit të variancës 69),

Pastrimi i shtëpisë (koeficientit të variancës 62),

Pastrimi i oborrit (koeficientit të variancës 72),

Kujdesi për fëmijët (koeficientit të variancës 63),

Hekurosja (koeficientit të variancës 66),

Përgaditja e listave për blerje (koeficientit të variancës 61) dhe

Bërja e pazareve (koeficientit të variancës 74)

Ngasja e automobilit për nevoja të familjes (koeficientit të variancës 77),

Riparimet në shtëpi (koeficientit të variancës 73),

Ndërrimi i gomave dhe vajit të automobilit (koeficientit të variancës 74),

Kositja e barit (koeficientit të variancës 57),

Rregullimi i prizave (koeficientit të variancës 76),

Sinksonizimi i TV-së (koeficientit të variancës 72) dhe

Larja e automobilit (koeficientit të variancës 59)

- *Aktivitete me vlerë të variancës më të ulët se 55, që tregojnë se distancat në mes të angazhimit të burrave dhe grave janë pothuajse të njëjta:*

Gatimi (koeficientit të variancës 41),

Kujdesi për të moshuarit (koeficientit të variancës 53),

Pjekja në zgarë (koeficientit të variancës 48) dhe

Larja e enëve (koeficientit të variancës 52)

6.1.4 Koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore të bashkëshortëve në familje

Në tabelat për mënyrën e ndarjes së punëve në familje pamë se shumica e punëve që duhet të bëhen çdo ditë, ose disa herë në ditë kryhen nga gratë. Gratë madje kontribuojnë edhe në detyrat që tradicionalisht cilësohen si punë burrash, çka do të thotë se ato shpenzojnë shumë më shumë kohë për përmbushjen e obligimeve ditore në familje se sa burrat e tyre. Për të paraqitur në mënyrë konkrete dallimet në mes të kohës së shpenzuar nga gratë dhe burrat kemi vendosur pytjen: *Sa kohë shpenzoni për të kryer punët e obligimet ditore të lartëpërmendura?.* Meqë kemi theksuar se faktorët social, siç janë niveli i arsimit dhe statusi i punësimit te gratë ndikojnë në sasinë e kohës së shpenzuar për të kryer punët e shtëpisë, kurse te burrat faktorë të tillë nuk kanë ndikim, rezultatet e përgjigjeve të bëra nga të dy gjinitë veç e veç do t'i analizojmë duke shtuar variablat për statusin e punësimit, nivelin arimor dhe strukturën e familjes ku jetojnë.

6.1.4.1 Koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore të bashkëshortëve në familje në raport me nivelin arimor të pjesëmarrësve

Table 14 Koha e shpenzuar nga gratë brenda javës për kryerjen e punëve në familje në raport me nivelin e tyre arimor

Niveli I arsimimit	Deri në 2 orë	Mbi 2-4 orë	Mbi 4-6 orë	Mbi 6-8 orë	Mbi 8 orë	Totali
Phd	1	0	1	2	0	4
	25.00%	0.00%	25.00%	50.00%	0.00%	100.00%
	5.56%	0.00%	8.33%	14.29%	0.00%	5.00%
	1.25%	0.00%	1.25%	2.50%	0.00%	5.00%
Fakulteti	8	3	7	6	12	36
	22.22%	8.33%	19.44%	16.67%	33.34%	100.00%
	44.44%	23.08%	58.33%	42.85%	52.17%	45.00%
	10.00%	3.75%	8.75%	7.50%	15.00%	45.00%
Shkolla e mesme	1	1	1	1	6	10
	10.00%	10.00%	10.00%	10.00%	60.00%	100.00%
	5.56%	7.69%	8.33%	7.14%	26.08%	12.50%
	1.25%	1.25%	1.25%	1.25%	7.50%	12.50%
Studimet master	8	9	3	5	5	30
	26.66%	30.00%	10.00%	16.67%	16.67%	100.00%
	44.44%	69.23%	25.00%	35.71%	21.73%	3.75%
	10.00%	11.25%	3.75%	6.25%	6.25%	37.50%

Siç po e shohim në rezultatet e parqitura në tabelë 44% e grave që shpenzojnë deri në 2 orë në javë për përmbushjen e obligimeve ditore në familje kanë kryer studimet Master dhe përbëjnë 26.66% të grave me këtë nivel arsimor. 44.44% kanë përfunduar studimet themelore Bachelor dhe përbëjnë 22.22% të grave me këtë nivel arsimor dhe 5.56 % e grave që kanë kryer studimet PhD, që përbëjnë 25% të grave me këtë nivel arsimor, si dhe 5.56% të grave me shkollë të mesme, që përbëjnë 10% të grave me këtë nivel arsimor.

69.23% e grave që shpenzojnë mbi 2-4 orë në javë për përmbushjen e obligimeve ditore në familje kanë kryer studimet master, që përbëjnë 30% të grave me këtë nivel arsimor. 23.08% e grave kanë përfunduar studimet Bachelor dhe përbëjnë 8.03% të grave me këtë nivel arsimor dhe 7.69% kanë kryer shkollën e mesme dhe përbëjnë 10% të grave me këtë nivel arsimor.

25% e grave që shpenzojnë mbi 4-6 orë në javë për përmbushjen e obligimeve ditore në familje kanë kryer studimet master dhe përbëjnë 10% të grave me këtë nivel arsimor, 58.3% kanë kryer studimet themelore Bachelor dhe përbëjnë 19.44% të grave me këtë nivel arsimor. 8.33% kanë

kryer shkollën e mesme dhe përbëjnë 10% të grave me këtë nivel arsimor dhe 8.33% e grave kanë kryer studimet PhD dhe përbëjnë 25% të grave me këtë nivel arsimor.

Për përmbushjen e obligimeve ditore në familje shpenzojnë mbi 6-8 orë në javë 16.67% e grave që kanë kryer studimet master, që përbëjnë që përbëjnë 21.73% të grave që kalojnë deri në 8 orë në javë në punë familjare. Shumë, e cila është më e ulët se 42.85% e grave që kanë të kryer fakultetin dhe përbëjnë 16.73% të grave me nivel të tillë arsimor.

Kurse mbi 8 orë në javë shpenzojnë 60% e grave me shkollë të mesme, mbi 33% e grave me fakultet dhe afër 17% me nivel master të studimeve. Pra, përqindja e pjesëmarrjes së grave në këtë kategori vie duke rënë me rritjen e nivelit arsimor.

Table 15 Koha e shpenzua nga burrat brenda javës për kryerjen e punëve në familje në raport me nivelin e tyre arsimor

Burra	Deri në 2 orë	Mbi 2-4 orë	Mbi 4-6 orë	Mbi 6-8 orë	Mbi 8 orë	Totali
Phd	0	1	1	0	0	2
	0.00%	50.00%	50.00%	0.00%	0.00%	100.00%
	0.00%	5.56%	5.26%	0.00%	0.00%	2.78%
	0.00%	1.39%	1.39%	0.00%	0.00%	2.78%
Studimet Bachelor	8	12	13	6	7	46
	17.39%	26.09%	28.26%	13.04%	15.22%	100.00%
	57.14%	66.67%	68.42%	75.00%	53.85%	63.89%
	11.11%	16.67%	18.06%	8.33%	9.72%	63.89%
Shkolla e mesme	3	1	0	0	2	6
	50.00%	16.67%	0.00%	0.00%	33.33%	100.00%
	21.43%	5.56%	0.00%	0.00%	15.38%	8.33%
	4.17%	1.39%	0.00%	0.00%	2.78%	8.33%
Studimet master	3	4	5	2	4	18
	16.67%	22.22%	27.78%	11.11%	22.22%	100.00%
	21.43%	22.22%	26.32%	25.00%	30.77%	25.00%
	4.17%	5.56%	6.94%	2.78%	5.56%	25.00%

Siç po e shohim në tabelën e mësipërme mbi 57% e burrave që shpenzojnë deri në 2 orë brenda javës për kryerjen e obligimeve në familje kanë kryer studimet themelore Bachelor dhe përbëjnë 17% të burrave me këtë nivel arsimor. 21 % kanë përfunduar shkollën e mesme dhe përbëjnë 50% të burrave me këtë nivel arsimor, kurse mbi 21% e burrave që kalojnë deri në 2 orë në javë për kryerjen e punëve në familje, kanë kryer studimet master dhe përbëjnë afër 17% të burrave me këtë nivel arsimor dhe 5% kanë kryer studimet PhD dhe përbëjnë 50% të burrave me këtë nivel arsimor. Kurse pjesën tjetër e përbëjnë mbi 68% e burrave me studime Bachelor dhe 26% e burrave që kanë kryer studimet master.

Mbi 4 deri në 6 orë shpenzojnë 50% e burrave që kanë kryer studimet PhD dhe përbëjnë mbi 5% të burrave që kalojnë kohëtë njëjtë për përmbushjen e obligimeve në familje.

Afër 67% e burrave që kalojnë mbi dy orë brenda javës për kryerjen e obligimeve në familje kanë kryer studimet themelore Bachelor dhe përbëjnë 26% të burrave me të njëjtin nivel arsimor, mbi 22% e burrave kanë kryer studimet mastër dhe përbëjnë 22% të burrave me të njëjtin nivel arsimor, ndërsa vetëm 5% kanë kryer shkollën e mesme dhe përbëjnë 16% të burrave me këtë nivel arsimor.

Mbi 6-8 orë kalojnë 75% e burrave me studime Bachelor dhe 25% e burrave që kanë përfunduar studimet master. Kurse mbi 8 orë shpenzojnë vetëm 13 burra, 30% e të cilëve kanë përfunduar studimet master dhe përbëjnë mbi 22% të burrave me të njëjtin nivel arsimor, gati 54 % janë burra që kanë mbaruar studimet themelore dhe përbëjnë mbi 15% të burrave me të njëjtin nivel arsimor, kurse 15% kanë përfunduar shkollën e mesme dhe përbëjnë mbi 33 përqind të burrave me këtë nivel të arsimit.

6.1.4.2 *Koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore të bashkëshortëve në familje në raport me statusin e punësimit të pjesëmarrësve*

Statusi i punësimit	Deri në 2 orë	Mbi 2-4 orë	Mbi 4-6 orë	Mbi 6-8 orë	Mbi 8 orë	Totali
I/e papunësuar	2	1	0	6	7	16
	12.50%	6.25%	0.00%	37.50%	43.75%	100.00%
	11.11%	7.70%	0.00%	41.86%	30.43%	20.00%
	2.50%	1.25%	0.00%	7.50%	8.75%	20.00%

I/e punësuar	16	10	10	8	16	60
	26.67%	16.67%	16.66%	13.33%	26.67%	100.00%
	88.89%	76.92%	83.33%	57.14%	69.57%	75.00%
	20.00%	12.50%	12.50%	10.00%	20.00%	75.00%
I/e vetëpunësuar	0	2	2	0	0	4
	0.00%	50.00%	50.00%	0.00%	0.00%	100.00%
	0.00%	15.38%	16.67%	0.00%	0.00%	5.00%
	0.00%	2.50%	2.50%	0.00%	0.00%	5.00%

Rezultatet e paraqitura në tabelë tregojnë se afër 29 % e grave shpenzojnë më shumë se 8 orë për përmbushjen e obligimeve ditore në familje, prej të cilave afër 70 % janë të punësuar, që përbëjnë afër 27% të grave me këtë status të punësimit, kurse mbi 30% janë të papunësuar dhe përbëjnë afër 44% të grave me këtë status të punësimit. Pjesa tjetër e grave të papunësuar (37%) kalojnë 6-8 orë në përmbushjen e obligimeve ditore në familje dhe përbëjnë mbi 41% të grave që kalojnë orë të njejta në punët e shtëpinë. Pjesën tjetër e përbëjnë gratë e punësuar që përbëjnë afër 13 % të grave me status të tillë të punësimit.

Përqindje më e ulët e grave të papunësuar vërehet në grupin e grave që kalojnë më pak se 2 orë duke kryer obligime ditore në familje, përkatësisht 12.50% e tyre, kurse vetëm 1 grua (6% e tyre) kryen 2-4 orë në javë për kryerjen e obligimeve ditore në familje dhe përbëjnë mbi 11% të grave që kalojnë 2-4 për kryerjen e këtyre punëve. Afër 77% e përbëjnë gratë e punësuar (mbi 88%), kurse pjesën tjetër e përbëjnë gratë e vetëpunësuar, që përbëjnë 50% të grave me status të tillë të punësimit.

Sa i përket grave që shpenzojnë 6-8 orë brenda javës për përmbushjen e obligimeve ditore në familje, mbi 83% janë të punësuar kurse pjesa tjetër (mbi 16%) janë të vetëpunësuar.

Table 17 Koha e shpenzua nga burrat brenda javës për kryerjen e punëve në familje ne raport me statusin e tyre te punesimit

Statusi i punësimit	Deri në 2 orë	Mbi 2-4 orë	Mbi 4-6 orë	Mbi 6-8 orë	Mbi 8 orë	Totali
I/ e papunësuar	1	5	2	0	0	8
	12.50%	62.50%	25.00%	0.00%	0.00%	100.00%
	7.14%	27.78%	10.52%	0.00%	0.00%	4.17%
	1.39%	6.94%	2.78%	0.00%	0.00%	4.17%

I/e punësuar	10	9	16	8	12	55
	18.18%	16.36%	29.09%	14.55%	21.82%	100.00%
	71.43%	72.22%	84.21%	100.00%	92.31%	83.33%
	13.89%	18.06%	22.22%	11.11%	16.67%	83.33%
I/e vetëpunësuar	3	4	1	0	1	9
	33.33%	44.44%	11.11%	0.00%	11.11%	100.00%
	21.43%	22.22%	5.26%	0.00%	7.69%	12.50%
	4.17%	5.56%	1.39%	0.00%	1.39%	12.50%

Siç e shohim në rezultatet e paraqitura në tabelle statusi i punësimit nuk ndikon në sasinë e kohës së shpenzuar për kryerjen e obligimeve ditore në familje. 62 % e burrave të papunësuar shpenzojnë mbi 2 deri në 4 orë brenda javës duke kryer detyra të tilla dhe përbëjnë 27% të burrave që kalojnë 2-4 orë në punët e shtëpisë. Asnjë burrë i papunësuar nuk shpenzon më shumë se 8 orë për kryerjen e detyrave në familje, përderisa sasi të tillë kohore shpenzojnë afër 22% të burrave të punësuar dhe mbi 12% të burrave të vetëpunësuar.

6.1.4.3 koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore të bashkëshortëve në familje në raport me strukturën e familjes, ku ata jetojnë

Table 18 Koha e shpenzuar nga gratë brenda javës për kryerjen e punëve në familje në raport me strukturën e familjes, ku jetojnë

Struktura e familjes	Deri në 2 orë	Mbi 2-4 orë	Mbi 4-6 orë	Mbi 6-8 orë	Mbi 8 orë	Totali
Familje e zgjeruar	8	7	1	4	10	30
	26.67%	23.33%	3.33%	13.33%	33.33%	100.00%
	44.44%	53.85%	8.33%	28.57%	43.48%	37.50%
	10.00%	8.75%	1.25%	5.00%	12.50%	37.50%
Familje me dy ose më shumë bërthama	0	0	1	0	1	2
	0.00%	0.00%	50.00%	0.00%	50.00%	100.00%
	0.00%	0.00%	8.33%	0.00%	4.35%	2.50%
	0.00%	0.00%	1.25%	0.00%	1.25%	2.50%
Familje bërthamë	10	6	10	10	12	48
	20.83%	12.50%	20.83%	20.83%	25.00%	100.00%
	55.56%	46.15%	83.33%	71.43%	52.17%	60.00%
	12.50%	7.50%	12.50%	12.50%	15.00%	60.00%

Siç e shohin në rezultatet e paraqitura në tabelë koha e shpenzuar nga gratë për kryerjen e obligimeve ditore në familje varet nga statusi i familjes, ku ato jetojnë. Përderisa afër 27% të grave, që jetojnë në familje të zgjeruar kalojnë më pak se dy orë për kryerjen e këtyre obligimeve, këtë sasi të kohës e kalojnë afër 21% e grave, që jetojnë në familje bërthamë (7% më pak) dhe asnjë grua e familjeve me dy ose më shumë bërthama nuk e ka privilegjin të shpenzojnë sasinë minimale të kohës për të përmbushur këto obligime.

Mbi 8 orë brenda javës, shpenzojnë 25% e grave të familjeve bërthamë kurse mbi 33% e grave, që jetojnë në familje të zgjeruara (8% më shumë) dhe 50% e grave e familjeve me dy ose më shumë bërthama.

Table 19 Koha e shpenzuar nga burrat brenda javës për kryerjen e punëve në familje në raport me strukturën e familjes, ku jetojnë

Struktura e familjes	Deri në 2 orë	Mbi 2-4 orë	Mbi 4-6 orë	Mbi 6-8 orë	Mbi 8 orë	Totali
Familje e zgjeruar	5	7	5	4	5	26
	19.23%	26.92%	19.23%	15.38%	19.23%	100.00%
	35.71%	38.89%	26.32%	50.00%	38.46%	36.11%
Familje me dy ose më shumë bërthama	6.94%	9.72%	6.94%	5.56%	6.94%	36.11%
	1	1	2	0	0	4
	25.00%	25.00%	50.00%	0.00%	0.00%	100.00%
Familje bërthamë	7.14%	5.56%	10.53%	0.00%	0.00%	5.56%
	1.39%	1.39%	2.78%	0.00%	0.00%	5.56%
	8	10	12	4	8	42
Familje bërthamë	19.05%	23.81%	28.57%	9.52%	19.05%	100.00%
	57.14%	55.56%	63.16%	50.00%	61.54%	58.33%
	11.11%	13.89%	16.67%	5.56%	11.11%	58.33%

Rezultatet interesante të paraqitura në tabelë tregojnë se sasia e kohës së shpenzuar nga burrat për kryerjen e obligimeve ditore në familje nuk varet nga struktura e familjes ku ata jetojnë. Më pak se dy orë dhe mbi 8 orë brenda javës shpenzojnë mbi 19% të burrave që jetojnë në familje bërthamë. Edhe mbi 19% e burrave që jetojnë në familje të zgjeruara, shpenzojnë më pak se dy orë, kurse shumica mbi 19% e pjesës së mbetur, shpenzojnë mbi 8 orë. E vetmja variabël që bënë ndryshim

është pjesëmarrja shumë më e madhe e burrave, që jetojnë në familjet me dy ose më shumë bërthama në kolonat që përcaktojnë sasinë më të vogël të kohës. Meqë 25% e burrave që jetojnë në familjet me dy ose më shumë bërthama, tregojnë se shpenzojnë më pak se dy orë dhe 25% 2-4, kurse gjysma tjetër e burrave që jetojnë në familje me strukturë të tillë shpenzojnë më pak se 6 orë brenda javës për kryerjen e obligimeve në familje, mund të themi se sa më e gjerë që është struktura e familjes, aq më pak kohë kalojnë burrat për të kryer obligime të tilla.

6.1.5 Kujdesi për fëmijë

Për të paraqitur angazhimin e bashkëshortëve në kujdesin për fëmijë, kemi formuluar pyetjen me shkallë lineare, ku pjesëmarrësit e kanë vlerësuar veten nga 1 (angazhim minimal) deri në 10 (angazhim maksimal) në detyra të caktuara të kujdesit për fëmijë, që janë ushqyerja, larja, kujdesi gjatë natës, etj.

Analiza e kësaj pyetje është bërë duke i klasifikuar vlerësimet e pjesëmarrësve në tri kategori: në kategorinë e parë kemi vendosur vlerësimet nga 1 deri në 3, të cilën e kemi emërtuar angazhim minimal; në kategorinë e dytë kemi vendosur vlerësimet nga 4 deri në 6 dhe e kemi emërtuar angazhim mesatar, kurse në kategorinë e tretë kemi vendosur vlerësimet nga 7 deri në 10 dhe e kemi emërtuar angazhim maksimal. Meqë variabla e gjinisë ka natyrë nominale kurse variablat për nivelin e angazhimit për fëmijë ka natyrë të shkallëzuar (scale), për të nxjerrur korelacionin në mes të këtyre dy kategorive kemi marrë në konsiderim vlerën ETA në analizën kros tabulare. Nga kjo analizë janë paraqitur këto rezultate

6.1.5.1 Ushqyerja

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Angazhim i vogël	Burra	4		2	4						
	Totali	4		2	4						
Angazhim mesatar	Gra		0	0	0	2	2	2	2	2	14
	Burra		2	4	14	6	2	6	8	0	0
	Totali		2	4	14	8	4	8	10	2	14
Angazhim i Madh	Gra							0		6	38
	Burra							6		2	2
	Totali							6		8	40

Total	Gra	0	0	0	0	2	2	2	2	8	52
	Burra	4	2	6	18	6	2	12	8	2	2
	Totali	4	2	6	18	8	4	14	10	10	54
Nominal by Interval	Eta	Përcaktohuni nga një deri në dhjetë se sa jeni të angazhuar në kujdesin për fëmijë, kur bëhet fjalë për ushqyerjen: Dependent Gjinia Dependent									.681
											.796

Në tabelë shohim asnjë grua nuk e ka notuar veten si e angazhuar minimalisht në detyrën e ushqyerjes së fëmijëve, përderisa në këtë kategori e kanë vendosur veten 10 burra. Si të angazhuara mesatarisht në ushqyerje e fëmijëve janë 24 gra dhe 68 burra. Kurse angazhim maksimal në këtë detyrë kanë treguar se kanë 44 gra dhe 10 burra.

Madhësia e ndikimit të faktorëve e përcaktuar nga intervali nominal ETA është 0.63.

6.1.5.2 *Larja*

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Angazhim i vogël	Burra	4	4	2							
	Totali	4	4	2							
angazhim mesatar	Gra	2	0	0	0	2	2	6	4		8
	Burra	6	4	12	8	4	8	0	0		0
	Totali	8	4	12	8	6	10	6	4		8
angazhim i madh	Gjinia Gra				0		0			2	42
	Burra				2		4			0	4
	Totali				2		4			2	46
Totali	Gra	2	0	0	0	2	2	6	4	2	50
	Burra	10	8	14	10	4	12	0	0	0	4
	Totali	12	8	14	10	6	14	6	4	2	54
Nominal by Interval	Eta	Përcaktohuni nga një deri në dhjetë se sa jeni të angazhuar në kujdesin për fëmijë, kur bëhet fjalë për larjen: Dependent gjinia Dependent									.753
											.816

Edhe në detyrën e larjes së fëmijëve/foshnjave asnjë grua nuk ka treguar se është e angazhuar minimalisht, përderisa në këtë detyrë janë të angazhuar minimalisht 10 burra. Angazhim mesatarë në këtë detyrë kanë treguar 24 gra dhe 42 burra. Kurse maksimalisht në larjen e foshnjave/fëmijëve marrin pjesë 44 gra dhe 10 burra.

Madhësia e ndikimit të faktorëve e përcaktuar nga intervali nominal ETA është 0.66

6.1.5.3 Ndrirrimi i pelenave

Table 22

Vetëvlerësimi i burrave dhe i grave në detyrën e larjes së fëmijëve

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
angazhim i vogël	Burra	8	2									10
	Totali	8	2									10
angazhim mesatar	Gra	0	2	0	0	4	8		4		6	24
	Burra	14	2	6	6	2	12		0		0	42
	Totali	14	4	6	6	6	20		4		6	66
angazhim i madh	Gra		0				0	2	0	4	38	44
	Burra		2				2	0	2	0	4	10
	Totali		2				2	2	2	4	42	54
Totali	Gra	0	2	0	0	4	8	2	4	4	44	68
	Burra	22	6	6	6	2	14	0	2	0	4	62
	Totali	22	8	6	6	6	22	2	6	4	48	130
Nominal Interval	by Eta	Përcaktohet nga një deri në dhjetë se sa jeni të angazhuar në kujdesin për fëmijë, kur bëhet fjalë për ndërrimin e pelenave: Dependent										.729
		gjinia1 Dependent										.776

Si në dy detyrat e para edhe në detyrën e ndërrimit të pelevave minimalisht nuk është e angazhuar asnjë grua dhe 10 burra. Mesatarisht në këtë detyrë marrin pjesë 24 gra dhe 42 burra kurse maksimalisht janë të angazhuar 44 gra dhe vetëm 10 burra.

Madhësia e ndikimit të faktorëve e përcaktuar nga intervali nominal ETA 0.60

6.1.5.4 Kujdesi gjatë natës

Table 23

Vetëvlerësimi i burrave dhe i grave në detyrën e kujdesin gjatë natës për fëmijët

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Angazhim i vogël	Burra	2		4	2	2					
	Totali	2		4	2	2					
Angazhim mesatar	Gra	0	0	0	0	2	2	2	6	0	12
	Burra	2	4	2	2	22	4	0	4	2	0
	Totali	2	4	2	2	24	6	2	10	2	12
Angazhim i madh	Gra					2	2	0	2	4	34
	Burra					0	0	4	0	2	4
	Totali					2	2	4	2	6	38
Totali	Femër	0	0	0	0	4	4	2	8	4	46
	Mashkull	4	4	6	4	24	4	4	4	4	4
	Total	4	4	6	4	28	8	6	12	8	50

Nominal by Interval	Eta	Përcaktohet nga një deri në dhjetë se sa jeni të angazhuar në kujdesin për fëmijë, kur bëhet fjalë për ushqyerjen dhe kujdesin gjatë natës:	.654
		Dependent	
		gjinial Dependent	.689

Edhe pse ndryshe nga detyrat e para, detyra e tretë, kujdesi gjatë natës nuk kërkon aftësi dhe nuk ka natyrë të njohur tradicionalisht si femërore, edhe në kujdesin gjatë natës minimalisht nuk është e angazhuar asnjë grua dhe 10 burra. Mesatarisht në këtë detyrë marrin pjesë 24 gra dhe 42 burra kurse maksimalisht janë të angazhuar 44 gra dhe vetëm 10 burra. Madhësia e ndikimit të faktorëve e përcaktuar nga intervali nominal 0.47

6.1.5.5 Tregimi i përrallave para gjumit

Table 24
Vetëvlerësimi i burrave dhe i grave në detyrën e tregimit të përrallave për fëmijët para gjumit

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
angazhim i vogel	Burra	2	2	4	2						10
	Totali	2	2	4	2						10
angazhim mesatar	Gra	0	0	4	2	8	6	2		2	24
	Burra	4	4	10	6	10	2	6		0	42
	Totali	4	4	14	8	18	8	8		2	66
angazhim i madh	Gra				2		4	10	2	26	44
	Burra				0		0	2	2	6	10
	Totali				2		4	12	4	32	54
Totali	Gra	0	0	4	4	8	10	12	2	28	68
	Burra	6	6	14	8	10	2	8	2	6	62
	Totali	6	6	18	12	18	12	20	4	34	130

Nominal by Interval	Eta	Përcaktohet nga një deri në dhjetë se sa jeni të angazhuar në kujdesin për fëmijë, kur bëhet fjalë për tregimin e përrallave para gjumit	.470
		Dependent	
		gjinial Dependent	.524

Edhe në kujdesin për tregimin e përrallave para gjumit asnjë grua nuk është deklaruar se angazhohet minimalisht, kurse në këtë detyrë nuk angazhohen, ose angazhohen minimalisht 10 burra. Mesatarisht në këtë detyrë marrin pjesë 24 gra dhe 42 burra kurse maksimalisht janë të angazhuar 44 gra dhe vetëm 10 burra. Madhësia e ndikimit të faktorëve e përcaktuar nga intervali nominal 0.52.

6.1.5.6 *Dërgimi dhe marrja nga çerdhja/shkolla dhe ndihma në mësim*

Table 25

Vetëvlerësimi i burrave dhe i grave në detyrën e dërgimit dhe marrjes nga çerdhja/shkolla dhe ndihma në mësim

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
Angazhim i vogël	Gra	2	4	2								
	Totali	2	4	2								
Angazhim mesatar	Gra				10	12	2					
	Burra				4	8	6					
	Totali				14	20	8					
Angazhim i madh	Gra							4	4	8	25	
	Burra							2	18	10	19	
	Totali							6	22	18	44	
Totali	Gra	2	4	2	10	12	2	4	4	8	25	
	Burra	0	0	0	4	8	6	2	18	10	19	
	Totali	2	4	2	14	20	8	6	22	18	44	
Nominal by Interval	Eta	Përcaktohuni nga një deri në dhjetë se sa jeni të angazhuar në kujdesin për fëmijët, kur bëhet fjalë për dërgimin dhe marrjen nga çerdhja/shkolla									Dependent	.184
		gjinia									Dependent	.412

Ndryshe nga tabelat e mësipërme në dërgimin dhe marrjen nga çerdhja/shkolla minimalisht janë të angazhuara 8 gra dhe asnjë burrë. Mesatarisht janë të anagazhuara 24 gra dhe 18 burra, kurse maksimalisht angazohen 37 gra dhe 49 burra. Madhësia e ndikimit të faktorëve e përcaktuar nga intervali nominal 0.17

6.1.5.7 *Shëtitja në park apo lodra për fëmijë*

Table 26

Vetëvlerësimi i burrave dhe i grave në detyrën e shëtitjen e fëmijeve në park apo lodra për fëmijë

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Angazhim i vogël	Gra	2	4	12							
	Burra	0	2	2							
	Totali	2	6	14							
Angazhim mesatar	Gra				12	6	4				
	Burra				2	8	4				
	Totali				14	14	8				
Angazhim i madh	Gra							14	2	29	
	Burra							14	16	21	
	Totali							28	18	50	

Totali		Gra	2	4	12	6	4	14	2	29	73	
		Burra	0	2	2	8	4	14	16	21	67	
		Totali	2	6	14	14	8	28	18	50	140	
Nominal by Interval	Eta	Përcaktohuni nga një deri në dhjetë se sa jeni të angazhuar në kujdesin për fëmijët, kur bëhet fjalë për shëtitjen në park apo lodra për fëmijë									.158	
		Dependent										
		gjinia1	Dependent									.397

Sa i përket kalimit të kohës së lirë me fëmijët, respektivisht shëtitjen e tyre në pakqe apo lodra për fëmijë, angazhimi i bashkëshortëve është më i barabartë. Minimalisht në këtë aktivitet janë të angazhuara 18 gra dhe 4 burra, mesatarisht janë të angazhuar 22 gra dhe 14 burra, kurse maksimalisht në këtë aktivitet marrin pjesë 45 gra dhe 41 burra. Madhësia e ndikimit të faktorëve e përcaktuar nga intervali nominal eta është 0.15.

6.1.5.8 Sigurimi i të mirave materiale për rritjen e fëmijëve

Table 27

Vetëvlerësimi i burrave dhe i grave në detyrën e sigurimit të të mirave materiale për rritjen e fëmijëve

			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
angazhim i vogel	gjinia1	Femër	2	2								
		Mashkull	0	0								
		Totali	2	2								
angazhim mesatar	gjinia1	Femër					18	8				
		Mashkull					0	0				
		Total					18	8				
angazhim i madh	gjinia1	Femër							4	6	8	25
		Mashkull							0	8	16	43
		Total							4	14	24	68
Total	gjinia1	Femër	2	2			18	8	4	6	8	25
		Mashkull	0	0			0	0	0	8	16	43
		Total	2	2			18	8	4	14	24	68
Nominal by Interval	Eta	Përcaktohuni nga një deri në dhjetë se sa jeni të angazhuar në kujdesin për fëmijët, kur bëhet fjalë për sigurimin e të mirave materiale për rritjen e tij: Dependent									.499	
		gjinia1	Dependent									.545

Në detyrën e sigurimit të të mirave materiale për rritjen e fëmijëve, marrin pjesë minimalisht vetëm 4 gra dhe asnjë burrë. Edhe angazhim mesatar kanë treguar 26 gra dhe asnjë burrë, kurse

maksimalisht në këtë detyrë kontribuojnë 43 gra dhe 67 burra, ose shumica prej tyre. Madhësia e ndikimit të faktorëve e përcaktuar nga intervali nominal 0.54.

Nëse analizojnë vlerën e *Partial Eta Squared*, mund të themi detyrat e kujdesit për fëmijë janë të ndara në mënyrë të ndarjes tradicionale gjinore të punëve në familje. Përveç kujdesit gjatë natës, dërgimit dhe marrjes nga çerdhja/ shkolla dhe shetitjes në park apo lodra për fëmijë që ndikimi i faktorit gjini (*Eta Squared*) ka qenë më i ulët se 0.50. Në ndarjen e përgjegjësive të tjera, gjinia luan rol vendimtar në pjesëmarrjen e njëres apo tjetres palë, ku përveç sigurimit të të mirave materiale për rritjen e fëmijës që vërehet si obligim i baballarëve, detyrat e tjera shihen se janë punë që u takojnë nënave.

6.1.6 Marrja e përgjegjësive të kujdesit për fëmijë në mungesë të bashkëshortit/ es

Meqenë se rezultatet e shumë hulumtimeve kanë treguar se kur gratë nuk janë në shtëpi, burrat kujdesen plotësisht për fëmijët e tyre, në pyetësor kemi vendosur pyetjen »*si ia bëni me aktivitetet, në të cilat nuk jeni përgjigjur me dhjetë, kur bashkëshorti/ bashkëshortja nuk është në shtëpi?*», kurse si njësi matëse kemi vendosur parametrat: Të gjitha detyrat i kryej vetëm; *Detyrat e domosdoshme për tu kryer i kryej vetëm; Thërras familjar timin apo të bashkëshortit/ es për ndihmë; dhe Bashkëshorti/ ja bënë zgjidhje para se të ik nga shtëpia.*

Për të analizuar këtë çështje, kemi veçuar rastet kur pjesërrësit e kanë vlerësuar angazhimin e tyre me 1 (angazhim minimal) dhe i kemi analizuar në raport me parametrat matëse të pyetjes në lidhje me kujdesit e tyre për fëmijët. Përgjigjet po i paraqesim në tabelën në vijim:

Tabela 28 Angazhimi i burrave në aktivitetet në të cilat përgjithësisht nuk angazhohen, në rastet kur nuk i kanë bashkëshortet në shtëpi

		Burra Totali	
Si ia bëni me aktivitetet, në të cilat nuk jeni përgjigjur me dhjetë, kur bashkëshorti/ bashkëshortja nuk është në shtëpi?	Të gjitha detyrat i kryej vetëm	4	4
	Bashkëshorti/ ja bënë zgjidhje para se të ik nga shtëpia	1	1
	Detyrat e domosdoshme për tu kryer i kryej vetëm	5	5
Totali		10	10
Totali Si ia bëni me aktivitetet, në të cilat nuk jeni përgjigjur me dhjetë, kur bashkëshorti/ bashkëshortja nuk është në shtëpi?	Të gjitha detyrat i kryej vetëm	4	4
	Bashkëshorti/ ja bënë zgjidhje para se të ik nga shtëpia	1	1
	Detyrat e domosdoshme për tu kryer i kryej vetëm	5	5

Meqë me numrin një, nuk e ka vlerësuar veten asnjë grua, nuk kemi mundur ta gjejmë ndikimin e faktorit gjini (eta), në kryerjen e këtyre punëve, por këto rezultate na tregojnë, 40 përqind e burrave që nuk angazhohen në kujdesin për fëmijë, mund t'i kryejnë të gjitha detyrat, kur bashkëshortja e tyre nuk është në shtëpi, kurse 50% e tyre i kryejnë aktivitetet e domosdoshme për tu kryer dhe vetëm 10% e tyre nuk marrin përgjegjësi të tilla, edhe kur bashkëshortja duhet të dal nga shtëpia. Çka do të thotë se 90% e burrave mund t'i kryejnë detyrat që kanë të bëjnë me kujdesin, por meqë kanë luksin e trajtimit të angazhimit të tyre si ndihmë e jo si detyrë, nuk marrin pjesë ose marrim pjesë minimalisht në kryerjen e tyre.

6.1.7 Qëndrimi i pjesmarrësve në lidhje me ideologjinë për kujdesin e mangët për fëmijët nga ana e nënave të punësuar në raport me statusin e punësimit

6.1.7.1 Qëndrimi i grave në lidhje me ideologjinë për kujdesin e mangët për fëmijët nga ana e nënave të punësuar në raport me statusin e punësimit

Tabela 28 Qëndrimi i grave në lidhje me ideologjinë për kujdesin e magët për fëmijët nga ana e nënave të punësuar në raport me statusin e punësimit

		E papunësuar	E punësuar	E vetëpunësuar	Totali
A mendoni se kujdesi për fëmijën nga ana e nënave të punësuar është më i mangët se kujdesi nga nënat që nuk punojnë?	E papërcaktuar	4	6	0	10
	Nuk pajtohem	5	51	4	60
	Pajtohem	3	0	0	3
	Pajtohem plotësisht	4	3	0	7
Total		16	60	4	80
Nominal by Interval	Eta	A mendoni se kujdesi për fëmijën nga ana e nënave të punësuar është më i mangët se kujdesi nga nënat që nuk punojnë? Dependent			.323
		Statusi i punësimit	Dependent		.562

Siç e shohim në rezultatet në tabelë, statusi i punësimit ndikon në krijimin e qëndrimit të grave në lidhje me ideologjinë për kujdesin e mangët për fëmijët nga ana e nënave të punësuar. Nga 60 gra të punësuar, 51 (85%) kanë qëndrim negativ në lidhje me këtë ideologji, 10% e tyre kanë qëndrim neutral kurse 4 % kanë qëndrim pozitiv. Rezultate të ndryshme na paraqiten te gratë e papunësuar, afër 44% e të cilave kanë qëndrim pozitiv në lidhje me këtë ideologji, kurse vetëm 31% e tyre kanë

qëndrim negativ. Edhe gratë e vetëpunësuar kanë qëndrim negativ. Niveli i ndikimit të faktorit punësim (eta) në krijimin e ideologjisë së tillë është 0.31.

6.1.7.2 *Qëndrimi i burrave në lidhje me ideologjinë për kujdesin e mangët për fëmijët nga ana e nënave të punësuar në raport me statusin e punësimit*

Tabela 30 Qëndrimi i burrave në lidhje me ideologjinë për kujdesin e mangët për fëmijët nga ana e nënave të punësuar në raport me statusin e punësimit

		I papunësuar	I punësuar	I vetëpunësuar	Totali
A mendoni se kujdesi për fëmijën nga ana e nënave të punësuar është më i mangët se kujdesi nga nënat që nuk punojnë?	I papërcaktuar	5	6	1	12
	Nuk pajtohem	0	18	6	24
	Pajtohem	0	28	1	29
	Pajtohem plotësisht	3	3	0	6
Totali		8	55	8	71
Nominal by Interval	Eta	A mendoni se kujdesi për fëmijën nga ana e nënave të punësuar është më i mangët se kujdesi nga nënat që nuk punojnë? Dependent			.494
		Statusi i punësimit Dependent			.403

Te burrat, në krijimin e ideologjisë në lidhje me cilësinë e kujdesit për fëmijë nga ana e nënave të punësuar, statusi i punësimit ka ndikim më të vogël se te gratë. Nga 55 burra të punësuar, 31 (mbi 56%) kanë qëndrim pozitiv në lidhje me këtë ideologji kurse 18 (afër 33%) kanë qëndrim negativ dhe vetëm 10 (afër 11%) kanë qëndrim neutral. Vlera të shpërndara shihen edhe te burrat e papunësuar, 62 % e të cilëve kanë qëndrim neutral, kurse 37 kanë qëndrim pozitiv në lidhje me këtë ideologji. Niveli i ndikimit të faktorit punësim (eta) në krijimin e ideologjisë së tillë te burrat është 0.16.

6.1.8 *Qëndrimi i pjesëmarrësve në lidhje me pushimin e atësisë*

Table 28
Qëndrimi i pjesëmarrësve në lidhje me pushimin e atësisë

		Gra	Burra	Totali
Not	A pajtoheni që në ligjin e punës të futet pushimi i atësisë dhe baballarët të kujdesen për foshnjat, nëse nëna ka	Nuk pajtohem aspak	2	2
		I papërcaktuar	8	8

	kontratë pune të cilën nuk mund ta ndërpres?	Pajtohem	42		42
		Pajtohem plotësisht	28		28
	Totali		80		80
Selected	A pajtoheni që në ligjin e punës të futet pushimi i atësisë dhe baballarët të kujdesen për foshnjat, nëse nëna ka kontratë pune të cilën nuk mund ta ndërpres?	Nuk pajtohem aspak		4	4
		I papërcaktuar		5	5
		Nuk pajtohem		4	4
		Pajtohem		38	38
		Pajtohem plotësisht		20	20
	Totali			71	71
Totali	A pajtoheni që në ligjin e punës të futet pushimi i atësisë dhe baballarët të kujdesen për foshnjat, nëse nëna ka kontratë pune të cilën nuk mund ta ndërpres?	Nuk pajtohem aspak	2	4	6
		I papërcaktuar	8	5	13
		Nuk pajtohem	0	4	4
		Pajtohem	42	38	80
		Pajtohem plotësisht	28	20	48
	Totali		80	71	151

Rezultatet e paraqitura në tabela tregojnë se si burrat ashtu edhe gratë kanë kryesisht qëndrim pozitiv në lidhje me futjen e pushimit të atësisë në ligjin e punës dhe angazhimin e baballarëve në kujdesin ndaj fëmijëve, në rastet kur nënat kanë kontrata pune që nuk mund t'i ndërpresin. Edhe pse nga 80 gra që janë përgjigjur në këtë pyetje 70 (87.5%), pajtohen ose pajtohen plotësisht me futjen e pushimit të atësisë në ligjin e punës dhe vetëm 2.5% e tyre nuk pajtohen që baballarët të kujdesen për fëmijët nëse nënat kanë kontrata pune, që nuk mund t'i ndërpresin, dhe 10 % nuk kanë mundur ta përcaktojnë qëndrimin e tyre pro apo kundër marrjes së përgjegjësisë së baballarëve për rritjen e fëmijëve. Poashtu afër 82% e burrave kanë qëndrim pozitiv apo shumë pozitiv në lidhje me futjen e pushimit të atësisë në ligjin e punës, ndryshe nga gratë që kundër një pushimit të tillë ishin vetëm 2.5%, kundër një ligji të tillë janë mbi 14% e burrave, kurse qëndrim neutral kanë treguar se kanë afër 6% e burrave.

6.1.9 Qëndrimi i pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen e pushimit prindëror

Qëndrimin e pjesëmarrësve në lidhje me pushimin prindëror e kemi matur me pyetjen: *Cila nga fjalitë e mëposhtme mendoni se është më të drejta në lidhje me pushimin prindërorë?*, kurse si parametra matës kemi përdorur fjalitë: *Në moshën 1-6 muaj vetëm nëna është në gjendje të kujdeset për fëmijën; Mundësia e zgjedhjes se cili prind ta shfrytëzojë pushimin prindëror është më e drejtë.; dhe Mundësia e ndarjes së pushimit 40-60% të orarit të plotë në mes të prindërve është më e drejtë.*

Idea e përdorimit të fjalive të lartpërmendura ka qenë, paraqitja e qëndimeve negative në lidhje me pushimin e atësisë deri te qëndrimi pozitiv që ka të bëjë me ndarjen e pushimit në dy pjesë të rezervuara për secilën palë. Për shkak të trajtimit të tillë të këtyre fjalive, pyetjen e kemi trajtuar si të shkallëzuar, prandaj edhe kemi përdorur koeficientin eta për të nxjerrur korelacionin në mes të qëndrimit të pjesëmarrësve në lidhje me ndarjen apo jo të pushimit prindëror dhe gjinisë së tyre.

Rezultatet i kemi paraqitur në tabelën në vijim.

	Gra		Burra		Totali	
	N	%	N	%	N	%
Në moshën 1-6 muaj vetëm nëna është në gjendje të kujdeset për fëmijën.	15 _a	18.8%	24 _b	33.8%	39	25.8%
Mundësia ndarjes së pushimit 40-60% të orarit të plotë në mes të prindërve është më e drejtë	53 _a	66.3%	11 _b	15.5%	64	42.4%
Mundësia e zgjedhjes se cili prind ta shfrytëzojë pushimin prindëror është më e drejtë	12 _a	15.0%	36 _b	50.7%	48	31.8%
Total	80	100.0%	71	100.0%	151	100.0%
Nominal by Interval	Eta	Dependent gjinia1	Dependent	.136		.523

Rezultatet tregojnë se afër 34 % e burrave mendojnë se në gjashtëmujorin e parë të fëmijës vetëm nëna duhet të kujdeset për të. Të këtij mendimi janë edhe afër 19% e grave. Numër më i madh i përqindjes së burrave vërehet edhe në opsionin, me të cilin kemi paraqitur qëndrimin neutral të pjesëmarrësve ku ipet mundësia e përzgjedhjes në mes të prindërve se cili ta shfrytëzojë pushimin prindëror. Këtë opsion e kanë përzgjedhur afër 51% e burrave dhe vetëm 15% e grave. Ndërsa për ndarjen e pushimit 40-60% të pushimit të plotë në mes të bashkëshortëve janë mbi 63% e grave dhe mbi 15% e burrave. Edhe pse vlera e koeficientit eta është 0.43, çka nuk mund të konsiderohen si vlerë që tregon ndikim të madh të faktorit gjini në ndarjen e pushimit prindëror, sipas rezultave në tabelë mund të themi se gjinia ruan rol të rëndësishëm në lidhje me qëndrimin e pjesëmarrësve për mënyrën e ndarjes së pushimit prindëror. Përderisa burrat parapërcejnë t'ua lënë përgjegjësinë e kujdesit për fëmijë grave (34%) apo të negociojnë me gra që ta ndajnë këtë pushim me

marrëveshje (51%), gratë parapërquejnë që ndarja e pushimit të tillë të paracaktohet me ligj, dhe ato të përzgjedhin që ta shfrytëzojnë ose 40% apo ose 60% të tij.

6.2 Rezultatet e intervistës

6.2.1 Të dhënat demografike dhe sociale të të intervistuarve

Ndryshe nga synimi ynë për të përzgjedhur pjesmarrës së të gjitha kategorive në shoqërore, në intervistë kemi dashur të marrim përgjigje nga personat që janë të involvuar drejtpërdrejtë në çështjet e barazisë gjinore në familje. Për këtë arsye intervista gjysëm e strukturuar është bërë me përfaqësues të OJQ-ve, që mirren me barazi gjinore. Kampioni i përzgjedhur kishte si qëllim marrjen e informacionit sa më të saktë dhe në fuksion të qëllimit të studimit. Fakti që studimi kishte si qëllim eksplorimin e nivelit të barazisë gjinore në familje, që manifestohet me ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve u përzgjedhën 10 të punësuar në OJQ të ndyshme, prej të cilëve janë përgjigjur vetëm 4, të shpërndarë në këto intervale gjinore dhe moshore.

		Gra	Burra	Totali
Grupmoshat	25 – 29	1	0	1
	30 – 34	2	1	3
Totali		3	1	4

Në intervistë janë përgjigjur 4 përfaqësues të OJQ-ve. Të gjithë me nivel më të lartë të arsimimit dhe të punësuar në organizatat përkatëse.

Pasiqë të gjitha përgjigjet të cilat kanë paraqitur qëndrimin e organizatave, ku pjesmarrësit punojnë, të dhënat bio-sociale që i kemi mbledhur në tri pyetjet e para të intervistes nuk do ti krahasojmë me pyetjet në lidhje me objektin e studimit.

6.2.2 Përceptimi i OJQ-ve për rolet gjinore dhe diskriminimit gjinor në familje

Intervista është hapur me pyetjet në lidhje me karakteristikat e roleve gjinore në shoqërinë kosovare dhe të diskriminimit gjinorë në familjet kosovare.

Sa i përket roleve gjinore pjesmarrësit janë nisur nga fakti se rolet gjinore janë të paracaktuara nga ndarja tradicionale e punës në familje, vetëm njëra nga ta ka shënuar atributet që e karakterizojnë rolin gjinor të njëjës ose tjetrës gjini:

Për gratë.: e bukur, e zonja, grua mikpritëse, e arsimuar/intelektuale, e ndershme, emocionale, fjalëmirë, modeste.

-Për burrat: djalë asllan (se ju doket pak me thane i bukur), zoteri, i shkolluar, i mençur/, punëtor i madh, i fuqishëm, i kujdesshëm etj.

Edhe atributet e shënuara nga e intervistuarja S. M. na aludojnë në ndarjen gjinore të roleve shoqërore. Pra, gruaja duhet të karakterizohet me tiparet që e bëjnë një shtëpiake të mirë, sipas ideologjisë borxheze të rolit të gruas në famije dhe shoqëri, kurse burri karakterizohet me tipare të tjera që lidhen me fuqinë dhe jetën jashtë shtëpisë.

Edhe në pyetjen në lidhje me diskriminimin gjinor në familje, të gjithë të intervistuarit kanë shprehur mendim se diskriminimi gjinor në familje:

- *“lidhet ngusht me pozitën jo të favorshme të gruas në tregun e punës dhe në jetën publike në përgjithësi” (V. Z.),*
- *“me pjesmarrjen jo proporcionale të grave në vendimmarrje (A. H.), si dhe me shoqërinë patriakale në të cilën jetojmë” (S. M.).*

Thuajse të gjithë të intervistuarit posedonin informacion të plotë në lidhje me diskriminimin gjinor, por përgjigjet konsistojnë me diskriminimin gjinor në vend të punës ose shoqëri përveç të intervistuarës F. K. Që diskriminimin e ka shpjeguar me shembull të jetës së saj të përditshme. Ja si shprehet F. K. e punësuar si juriste që merret ekskluzivisht me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore në lidhje me diskriminimin e bazuar në gjini:

- *Shpesh familjarët ma thonin se gratë që merren me barazi gjinore njihen si tepër llafazane dhe të papërshtatshme për tu shoqëruar, por ti të paktën je e martuar dhe nuk do të kesh problem ta zgjerosh rrethin tënd social. Shpesh edhe më theksonin faktin se duhet të ndihesh i privilegjuar për këtë. Ndjeja paragjykimin bazuar në gjini, i cili shoqërohej dhe me sjellje diskriminuese..*

Vlenë të theksohet fakti se format e të menduarit të tillë ndikojnë në krijimin e një mendësie shoqërore për të mos u ndikuar nga qëndrimet e OJQ-ve në lidhje me barazinë gjinore, mendësi që mund të influencojë në izolimin e tyre dhe hezitimin e masës (sidomos të grave) për tu marrë me çështje të tilla.

6.2.3 Përceptimi i OJQ-ve për ndikimin e faktorëve biologjik në ndarjen gjinore të punës

Sa i përket ndikimit të natyrës biologjike të të dy gjinive në ndarjen e punës sipas gjinisë, të intervistuarit kanë shprehur mendim *se* në vendin tonë ndarja e punës duke u nisur nga natyra biologjike e të dy gjinive “*keqpërdoret si vlerë tradicionale që vë gratë dhe burrat në role që janë gabimshëm të lidhura me natyrën biologjike të tyre*” (V. Z.) dhe *se rolet gjinore janë koncepte shoqërore* (A. H.) që nuk duhet të ndikojnë në ndarjen e punës sipas gjinisë.

6.2.4 Ndikimi i përgjegjësive familjare në ngritjen në karrierë

Në këtë hulumtim kemi dashur ta marrim mendimin e përfaqësuesëve të OJQ-ve në lidhje me ndikimin përgjegjësive familjare në ngritjen në karrierë. Edhe pse pyetja nuk ka përmbajtur terme si burrë ose grua, asnjë pjesëmarrës nuk ka përmendur se si përgjegjësitet familjare mund të pengojnë burrat për tu ngritur në karrierë, përderisa të gjithë janë pajtuar se këto përgjegjësi u pamundësojnë grave ndjekjen e karrierës. Për këtë çështje e intervistuar V. Z. shprehet:

“Ndër arsyet kryesore pse gratë në tregun e punës në Kosovë janë jashtëzakonisht të nënperfaqësuar (me 81% normë të joaktivitetit në treg të punës), konsiderohen obligimet familjare në përkujdesje ndaj fëmijëve dhe pleqve. Sigurisht që përgjegjësitet familjare, bërë bashkë më procesin diskriminues të punësimit ndaj grave, ndikojnë në karrieren e grave”.

Në këtë mes po paraqesim edhe mendimin e një të intervistuar tjetër, e cila pohon se dallimi gjinor në ngritjen në karrierë fillon edhe para se gratë ose burrat të futen në tregun e punës. Duke qenë se shumica prej tyre janë të diskriminuara nga fëmijëria sepse në shoqërinë tonë parapëlqehet të mos investohet në mënyrë proporcionale si në shkollimin e vajzave, ashtu edhe në atë të djemëve. Për këtë po citojmë përgjigjen në vijim:

- *“Mendoj se ende është i shprehur stimulimi ose përkrahja më e madhe e djemve për shkollim sesa e vajzave. Kjo për arsyen se familja duhet me ngris djalin sepse vajza është*

për “derën e huaj”. Fatkeqësisht nëse i shohim zonat rurale ende është kjo teori. Në qendrat urbane ka një ngjyrim të lehtë”.

Për të ilustruar mendimin e dy të intervistuarave që cituam më lart po citoj një të intervistuar tjetër, e cila ka paraqitur reagimet e të njohurve në lidhje me ndjekjen e karrierës së saj personale:

- *“Shumë të njohur nuk më kanë lavdëruar mua për sukseset në studime dhe punë, por bashkëshortin tim dhe familjen e tij që nuk kërkojnë të lind fëmijë dhe të kaloj kohë më të gjatë me ta. Kariera ime, në shumë raste është konsideruar si shprehje e mungesës së empatisë e edhe e egoizmit”.*

6.2.4.1 Përceptimi i OJQ-ve për dallimet gjinore në lidhje marrjen përsipër të përgjegjësive familjare për të lënë menjëherë karrierën

Në pyetjen në lidhje me mendimin e të intervistuarave për dallimet gjinore për marrjen përsipër të përgjegjësive familjare për të lënë menjëherë karrierën kemi parë poashtu se të gjithë pjesëmarrësit pajtohen *se burrat janë më pak të predispozuar që të sakrifikojnë karrierën; dhe e kundërta*. Në lidhje me këtë çështje një e intervistuar shprehet:

- *“Një vajzë e re po që se martohet ajo zgjedh me qëndru në shtëpi dhe t’i rrisë fëmijët të kujdeset për shtëpi sepse burri i saj duhet të punojë, duke qenëse ai merr pagë më të mirë se ajo”.*

Tendencën e grave për të marrë përsipër këto përgjegjësi, të intervistuarit e konsiderojnë si dëmtim afatgjatë të kualitetit të tyre të jetesës, prandaj edhe janë kundër kësaj tendence. Në lidhje me këtë e intervistuar V.Z. shprehet:

- *“Gratë kanë tendencë më të madhe për të sakrifikuar për të mirën e përgjithshme të familjes, duke marrë përsipër obligime të shumta familjare, e duke u dhënë mundësinë burrave që të ngriten në karriere. Rrjedhimisht, kjo i dëmton ato në kohë afatgjate”.*

6.2.4.2 Ndikimi i rritjes së kapacitetit në çerdhet publike dhe në shtëpitë e të moshuarve në punësimin më të madh të grave?

Të gjithë pjesëmarrësit pajtohen se rritja e kapacitetit në çerdhet publike dhe në shtëpitë e të moshuarve do të ndikonte në punësimin e një numri më të madh të grave në Kosovë. Kapacitetin e ulët në këto institucionet shtetërore dhe çmimet që nuk përkojnë me ekonominë familjare të

Kosovës në institucionet private për përkujdesje, ata i shohin si faktorët kryesorë për joaktivitetin e grave në tregun e punës së Kosovës. Për këtë, V. Z. pohon:

- *“Ka komuna në Kosovë të cilat nuk kanë kopshte të fëmijëve fare. Nëse arsye kryesore e grave pse nuk futen në treg të punës janë obligimet për përkujdesje ndaj të moshuraëve dhe fëmijëve në familje, sigurisht që rritja e numrit të shërbimeve për kujdes ditor për fëmijë dhe të moshuar, si dhe bërja e këtyre shërbimeve të përballueshme me ekonominë familjare, është mundësi e mirë për të rritur punësimin e grave”.*

Kurse e intervistuar S. H. Pohon:

- *“Edhe hulumtimet e tregojnë këtë. Agjenda Nacionale për Fuqizimin Ekonomik të Grave, nxjerr se barriera kryesore që lë jashtë tregut të punës gratë është kujdesi ndaj fëmijëve dhe të moshuarave. Mungojnë çerdhet publike, standardi është i ulët në Kosovë që të gjithë të dërgojnë fëmijët në çerdhe private”.*

6.2.5 Përceptimi i OJQ-ve në lidhje me ndarja e të drejtave dhe përgjegjësive në bashkeshortësi dhe të kujdesit për fëmijët

Për të paraqitur mënyrën e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive në mes të bashkeshortëve, në intervistë kemi vendosur një seksion të përbërë me pyetje që ka të bëjnë ekskluzivisht me mënyrën e ndarjes së përgjegjësive në familje. Pyetja e parë e këtij seksioni është:

Çfarë mendoni, të drejtat dhe përgjegjësitë e burrit dhe gruas në familjen kosovare, janë të njejta?

Të gjithë pjesmarrësit kanë shprehur mendimin se ekziston një diproporcionalitet në ndarjen e këtyre përgjegjësive, këto përgjigje i kanë dhënë duke na referuar në hulumtimet e institucioneve ku ata punojnë: si: Raporti i Institutit Riinvest të viti 2017 (Gratë në tregun e punës), Agjenda Nacionale për Fuqizimin Ekonomik të Grave, Joaktiviteti i grave në tregun e punës në Kosovë, etj.

Vetëm njëra nga të intervistuarat ka theksuar *“se të drejtat janë të njejta, por zbatimi i tyre nuk është në nivel të barabartë. Kurse një tjetër është shprehur se: përgjegjësitë e burrave në familjet kosovare janë të kufizuara në rregullimin e shtratit, hekurosjen e këmbës së tij apo në nxjerrjen e familjes gjatë vikendit. Për kontributin e këtij lloji ata krenohen se marrin pjesë në ndarjen e përgjegjësive në bashkeshortësi, kurse gratë lindin dhe kujdesen për fëmijët, kryejnë punët e shtëpisë, kujdesen ndaj rrobave dhe higjienës, gatuajnë dhe në të njejtën kohë edhe punojnë”.*

6.2.6 Përceptimi i OJQ-ve në lidhje me ligjin në fuqi për pushimin e lehonisë

Për të paraqitur qëndrimin e përfaqësuesve të OJQ-ve në lidhje me pushimin e lehonisë, kemi vendosur pyetjet në lidhje me periudhën e gjatë të pushimit të lehonisë dhe ndikimin e tij në karrierën e nënave të reja dhe në lidhje me të drejtën e babait për shfrytëzimin e pushimit prindërorë në vend të nënës.

Sa i përket kohëzgjatjes së këtij pushimi, pjesëmarrsit kanë paraqitur mendime të ndryshme, një pjesëparrëse pohon:

- *“Mendoj se forma e pushimit të lehonisë në Kosovë (9 muaj me pagës dhe 3) pa pagës është periudhë optimale. Mos te harrojmë se nënës i duhet 4-6 muaj rehabilitim pas lindjes dhe ajo periudhë është gati pushim mjekësor. Në Kosovë pas parasysh edhe sektorin publik dhe privat në mesatare rreth 8 muaj shfrytëzohet pushim i lindjes. Rregullimi i kompensimit është çështje tjetër por shumë e rëndësishme. Prandaj për të stimuluar punësimin të grave, shteti duhet të marr pagesën e 6 muajve të parë”.*
- *Gratë duhet të qëndrojnë një kohë në leje të lehonisë për kujdesin e të porsalindurve.*

Kurse pjesëmarrësit e tjerë mendojnë se kohëzgjatja 1 vjeçare e pushimit të lehonisë ndikon negativisht në karrierën e grave, duke pohuar se:

- *“Pushimi i gjatë i lehonisë mund të ndikojë në demotivim të grave për t’u rifutur në treg të punës, mund të ndikojë në humbjen e aftësisë për të qenë në hap me zhvillimet e shpejta të teknologjisë dhe në përgjithësi të kërkesës së tregut të punës. Ndikon gjithashtu edhe në mospunësim, meqenëse pushimi i gjatë i lehonisë shihet si barrë për bizneset punëdhënëse, gjë që i bëjnë t’i diskriminojnë gratë në procesin e punësimit”.*
- *“Periudha më e gjatë se 3 maksimumi 4 muaj jashtë tregut të punës dhe rrethit social për shkak të kujdesit për fëmijë të nënat e reja shkakton te ato ndjenjën e izolimit, lakmisë dhe probleme të tjera që lidhjen me shëndetin psikik të saj, mos të flasim pastaj për problemet në lidhje me kthimin në vend të punës”.*

Kjo pyetje është pasuar me pyetjen që ka të bëjë me qëndrimin e pjesëmarrësve në lidhje me pushimin prindëror, dhe ndarjen e këtij pushimi në mes të bashkëshortëve, për të cilën janë pajtuar

të gjithë pjesmarrësit, të cilët kanë treguar se edhe institutet ku ata punojnë avokojnë që t'i sigurohet babait e drejta për ta shfrytëzuar këtë pushim. Kështu i intervistuari A. H. pohon:

- *“Instituti Riinvest në vijimësi avokon që kjo të ndodhë sepse beson që me këtë arrihen shumë efekte pozitive”.*

Një e intervistuar pohon se me garantimin e kësaj të drejteje, nuk përfiton vetëm babi, por edhe fëmija, duke u shprehur:

- *“Pushimi prindëror, si dhe ai i atësisë, duhen të jenë të garantuara për babain. Është e drejtë e babait, përveç përgjegjësisë, që të jetë afër fëmijëve të tij prej momentit kur lindin. Përmes pushimit të prindërimit, babai arrin të krijojë lidhje emocionale me fëmijun, përderisa fëmija arrin të zhvillohet më mirë emocionalisht, fizikisht, dhe kognitivisht, me prezencën e të dy prindërve gjatë rritjes së tij”.*

Pra pushimi i lehonisë dhe mënyra e zbatimit të tij në shoqërinë tonë, është diskriminuese, jo vetëm për nënat, të cilat si pasojë e shpërndarjes për një periudhë të gjatë kohore nga tregu i punës humbin aftësinë për punë dhe mundësinë e apdejtimit me zhvillimet e shpejta teknologjike; Kjo periudhë e gjatë shoqërohet me ndjenjën e izolimit të nënave dhe ndikon negativisht edhe në shëndetin e tyre psikik të tyre; por edhe të baballarët dhe fëmijët. Prandaj babait duhet t'i garantohet mundësia e shfrytëzimit të pushimit prindërorë. Vetëm kështu krijohet lidhja emocionale në mes të baballarëve dhe fëmijëve dhe fëmijët zhvillohen më mirë emocionalisht, fizikisht, dhe kognitivisht. Pëveç ndikimit direkt të pushimit të atësisë në edukimin e fëmijëve, pjesmarrësit kanë pohur se garantimi i të drejtës për shfrytëzimin e pushit të tillë do të ndikonte indirekt edhe në ndarjen më simetrike të përgjegjësisë në familje. Këtë ndikim do ta paraqesim me përgjigjet e pjesëmarrësve në pyetjen e fundit të intervistës: *A mendoni se e drejta e babait për të shfrytëzuar pushimin prindërorë do të ndikonte në angazhimin më të madh të burrave në punët e shtëpisë?* Në lidhje me këtë çështje pjesëmarrësit mendojnë se:

- *“Të qëndruarit në shtëpi për tu përkujdesur për fëmijët së bashku, ndikon pozitivisht edhe në ndarjen e përgjegjësisë të tjera rreth shtëpisë”.*
- *“Të qëndruarit në shtëpi për tu kujdesur për fëmijën do të ndikonte në lidhjen e babait me familjën dhe krijimin e aftësive të nevojshme të tij për kryerjen e punëve të shtëpisë”.*

7 DISKUTIMI

Gjetjet kuantitative të këtij hulumtimi kanë treguar se ekzistojnë dallime gjinore bio-sociale të prindërve kosovarë, që kanë fëmijë më të vegjël se 5 vjeç. Ndër dallimet që bien në sy është mosha mesatare e nënave, që është më e ulët se sa ajo e baballarëve. Niveli i arsimit që është më i lartë te burrat se sa te gratë, si dhe statusi i punësimit, që karakterizohet me dallime të dukshme, p.sh. shuma totale e grave të papunësuar është dy herë më e lartë se sa shuma totale e burrave të papunësuar. Kurse pjesëmarrje tri herë më të lartë të burrave se sa të grave kemi parë te pjesëmarrësit me status të të vetëpunësuarit, çka tregon se gratë në Kosovë nuk janë të pavarura për të krijuar vend pune ose pavarësi ekonomike, shumica prej të cilave parapëlqejnë një vend pune në sektorin publik.

Ekzistenca e dallimeve gjinore në strukturën bio-sociale të popullsisë flet për ekzistencën e dallimeve edhe më të mëdha në strukturën psiko-sociale e sociale në përgjithësi. Meqë ky hulumtim ka të bëjë me ndikimin e dallimeve gjinore në ndarjen e përgjegjësive në mes të bashkëshortëve në familje, dallimet gjinore bio-sociale do t'i trajtojmë për të paraqitur shkallën e ndikimit të tyre në ideologjinë gjinore për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në familje, si dhe në ndarjen e këtyre përgjegjësive në jetën e përditshme.

Për të shqyrtuar të gjitha këto, në hipotezat e ngritura, konfirmimi, përkatësisht moskonfirmimi i të cilave do të na mundësojë të paraqesim elementet e rendit patriakal në familjet kosovare dhe gjetjen e mënyrave të duhura për zhdukjen e këtij rendi, hipoteza të cilat me këtë hulumtim janë konfirmuar.

7.1 Hipoteza e parë: Gratë janë më të ngarkuara me punë të shtëpisë se sa burrat, Për kryerjen e obligimeve ditore në familje ato shpenzojnë 2 herë më shumë kohë se sa burrat është konfirmuar

Konfirmimi i kësaj hipoteze është verifikuar duke testuar mesataren e nxjerrë nga parametrat matës 1= më pak se dy orë, 2=Mbi 2-4 orë, 3=Mbi 4-6 orë 4=Mbi 6-8 orë dhe 5=Mbi 8 orë të përgjigjeve të burrave dhe grave në pyetjen *Sa orë brenda javës shpenzoni për kryerjen e obligimeve ditore në familje?* Kjo analizë është bërë me ndihmën e metodës T-test, për mes së cilës kemi marrë këto rezultate:

Sipas rezultateve të analizës *Independent-Samples T-test*, shihet se mesatarja e 79 grave pjesëmarrëse është 3.63 dhe mesatarja e 72 burrave pjesëmarrës është 2.69. Këto rezultate

tregojnë se gratë shpenzojnë më shumë kohë për kryerjen e obligimeve ditore në familje se sa burrat.

Për të shpjeguar më detajisht konfirmimin e kësaj hipoteze, në tabelën në vijim do të paraqesim vlerat Levene për ekzistencën e dallimit ndërmjet mesatareve të dy grupeve:

Edhe rezultati i Sig (2-tailed) ($p=0.000$) tregon që ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet mesatareve të dy grupeve. (Vlera e Sig. është më e vogël se 0.05 brenda intervalit të besueshmërisë 95%). Po këtë rezultat do ta paraqisim po të niseshim nga vlera Sig. (0.38). Pra, si në vendet e tjera edhe në Kosovë ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet kohës së shpenzuar në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore në familje te burrat dhe te gratë.

7.2 Hipoteza e dytë: Ideologjia gjinore ndikon në qëndrimin e grave dhe të burrave në lidhje me ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare është konfirmuar

7.2.1 Ndikimi i ideologjisë gjinore në ndarjen tradicionale të punëve në familje

Kjo hipotezë është ngritur për të paraqitur ndikimin e ideologjisë gjinore në krijimin e qëndrimit për ndarjen tradicionale të punëve në familje dhe të kujdesit për fëmijë. Dallimet gjinore ideologjike janë paraqitur me ndihmën e përgjigjeve të pjesëmarrësve në pyetjen e parë të objektit të studimit në pyetësor: “*A mendoni se ndarja tradicionale e punëve në familje: Burrat punojnë, gratë kryejnë punët e shtëpisë është e drejtë?*”. Hipoteza është verifikuar duke testuar mesataren e nxjerrë nga parametrat matës 1= pajtohem plotësisht, 2=pajtohem, 3=i/e papërcaktuar 4= nuk pajtohem dhe 5=nuk pajtohem aspak.

Sipas rezultateve të analizës Independent-Samples T-test, shihet se mesatarja e 80 grave pjesëmarrëse është 3.22 dhe mesatarja e 72 burrave pjesëmarrës është 2.06. Pra, gratë nuk pajtohen me mënyrën e ndarjes tradicionale të punëve në familje, kurse burrat pajtohen pjesërisht. Pra, ekziston një dallim ndërmjet qëndrimit të grave dhe të burrave në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje.

Për të shpjeguar më detajisht konfirmimin e kësaj hipoteze, në tabelën në vijim do të paraqesim vlerat Levene për ekzistencën e dallimit ndërmjet mesatareve të dy grupeve.

Edhe rezultati i koeficientit $p = 0.000$ (Sig 2-tailed) tregon që ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet mesatareve të grupeve. (Vlera e Sig. është më e vogël se 0.05 brenda intervalit të

besueshmërisë 95%). Po këtë rezultat do ta paraqisnim po të niseshim nga vlera Sig. (0.003), e cila është më e vogël se 0.05. Këto vlera na sigurojnë konfirmimin e hipotezës së parë në lidhje me dallimit në mes të qëndrimit të grave dhe të burrave kosovarë për ndarjen tradicionale të punëve në familje.

7.2.2 Ndikimi i ideologjisë gjinore në ndarjen e kujdesit për fëmijë

Kjo hipotezë është analizuar me ndihmën e metodës ANOVA njëdrejtimëshe, për mes të cilës është verifikuar se a ka homogjenitet në mes të përgjigjeve të burrave dhe grave në pyetjen e pyetësorit: A pajtoheni që në ligjin e punës të futet pushimi i atësisë dhe baballarët të kujdesen për foshnjat, nëse nëna ka kontratë pune të cilën nuk mund ta ndërpres?

Në tabelën 35 mund të shihet rezultati i testit të supozimit themelor të ANOVA-së një drejtimëshe, homogjenitetit të variancës. Për arsye se këtu vlera e koeficientit p (Sig. 0,42) është më e vogël se 0.05, mund të themi se variancat nuk janë homogjene.

Tabela ANOVA teston dallimin ndërmjet qëndrimit të burrave dhe grave në lidhje me marrjen e kujdesit për fëmijë nga ana e baballarëve, kur nënat kanë kontratë pune që nuk mund ta ndërpresin. Edhe në këtë tabelë vlera e p-së (Sig.) është më e vogël se 0.05, kështu që hipoteza 0 refuzohet dhe themi se se ekziston një dallim ndërmjet qëndrimit të burrave dhe grave në lidhje me futjen e pushimit të atësisë, këto dallime do t'i paraqesim me ndihmën e mesatareve të nxjerra nga T-testi:

Vlerat e mesatareve në tabelë tregojnë se gratë kanë qëndrim më pozitiv në lidhje me futjen e pushimit të atësisë në Ligjin e Punës se sa burrat, çka do të thotë se hipoteza zero nuk konfirmohet edhe dhe vie në shprehje hipoteza alternative, pra, burrat dhe gratë nuk kanë qëndrim të njejtë në lidhje me futjen e pushimit të atësisë në Ligjin e Punës.

Rezultate të tilla tregojnë se ideologjia gjinore është faktori kryesorë që ndikon në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare. Burrat kanë qëndrim pozitiv në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje dhe qëndrim negativ në lidhje me futjen e pushimit të atësisë në Ligjin e Punës. Ndryshe nga gratë, të cilat kanë qëndrim negativ në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje, kurse qëndrim pozitiv për futjen e pushimit të atësisë në Ligjin e Punës. Por marrë parasyshë rezultatet kualitative në lidhje me tendencën e grave për tu ndier falenderuese ndaj mirësisë së burrit për meritat e tyre në karrierë, si dhe tendencën e tyre për të sakrifikuar karrierën në të mirë të familjes, themi se përkundër qëndrimit të tyre negativ

në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje, ideologjia është ajo që ndikon në nënshkrimin e grave në rendin patriakal dhe hezitimin e tyre për të kundërshtuar këtë rend, pa marrë parasysh qëndrimin e tyre personal.

7.3 Hipoteza e tretë: makropolitikat adekuate ndikojnë në zbehjen e ideologjisë gjinore për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi në bashkëshortësi është konfirmuar

Konfirmimi i kësaj hipoteze është vërtetuar pas shqyrtimit të ndikimit të kushteve sociale në zbehjen e ideologjisë gjinore për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve, si:

7.3.1 Ndikimi i krijimit të institucioneve shtetërore në zbehjen e rendit zakonor të manifestuar me ideologji të fortë gjinore për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi në bashkëshortësi

Kjo hipotezë është verifikuar duke testuar mesataren e nxjerrë nga parametrat matës $1 = pajtohem plotësisht$, $2 = \text{pajtohem}$, $3 = i/e \text{ papërcaktuar}$, $4 = \text{nuk pajtohem}$ dhe $5 = \text{nuk pajtohem aspak}$ të përgjigjeve të burrave dhe grave që kanë lindur dhe janë zhvilluar pas luftës (18-24 vjeç) dhe të moshuarve mbi 56 vjeç, që janë formuar në rrethe me natyrë kryesisht patriakale në pyetjen: *A mendoni se ndarja tradicionale e punëve në familje "Burrat punojnë, gratë kryejn punët e shtëpisë është e drejtë?"*.

Sipas rezultateve të analizës *Independent-Samples T-test*, shihet se mesatarja e 16 pjesëmarrësve të rinj është 3.46 dhe mesatarja e 9 pjesëmarrësve më të moshuar se 56 vjeç është 1.55. Këto rezultate tregojnë se të rinjtë nuk pajtohen me mënyrën e ndarjes tradicionale të punëve në familje, kurse të moshuarit pajtohen me një mënyrë të tillë. Pra, ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet qëndrimit të të rinjëve dhe të moshuarve në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje.

Për të shpjeguar më detajisht konfirmimin e kësaj hipoteze, në tabelën në vijim do të paraqesim vlerat Levene për ekzistencën e dallimit ndërmjet mesatareve të dy grupeve.

Edhe rezultati i Sig (2-tailed) ($p=0,000$) tregon që ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet mesatareve të grupeve. (Vlera e Sig. është më e vogël se 0.05 brenda intervalit të besueshmërisë 95%). Po këtë rezultat do ta paraqisim po të niseshim nga vlera Sig. (0.05), çka na siguron

konfirmimin e hipotezës së dytë në lidhje me eksistencën e një dallimi të rëndësishëm ndërgjeneratash në lidhje me qëndrimin e tyre për ndarjen tradicionale të punëve në familje.

7.3.2 Ndikimi i punësimit në intenzitetin e përfshirjes së grave në punët e shtëpisë

Kjo hipotezë është analizuar me anë të metodës Hi-Katrori. Me këtë metodë është krahasuar marrëdhënia në mes të statusit të punësimit (e paraqitur me ndihmën e përgjegjjeve në pyetjen e pyetësorit për statusin e punësimit) dhe të kohës së shpenzuar në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore në familje (e paraqitur me ndihmë e përgjegjjeve në pyetjen *Sa kohë brenda javës shpenzoni për të kryer obligime ditore në familje*). Marrëdhëniet në mes të variablave janë analizuar pasi janë menjanuar përgjigjet e burrave në pyetjet përkatëse me metodën Select cases. Rezultatet i kemi paraqitur në tabelën në vijim:

Sipas rezultateve të paraqitura në tabelë shohim se afër 69 % të grave të papunësuar shpenzojnë mbi 6 orë brenda javës për kryerjen e obligimeve ditore në familje, kurse kohë të njejtë për kryerjen e obligimeve ditore shpenzojnë afër 40% e grave të punësuar apo të vetëpunësuar.

Deri në 4 orë në javë, që është një kohë masararisht e shkurtur për të kryer punë të shtëpisë brenda javës kalojnë afër 19% të grave të papunësuar kurse të njejtin interval kohorë e kanë të rezervuar për të kryer obligime të tilla mbi 44% e grave të punësuar apo të vetëpunësuar. Këto rezultate tregojnë se statusi i punësimit ndikon në kohën në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore në familje. Përqindja e grave të punësuar që shpenzojnë kohë maksimale në punë të shtëpisë është dukshëm më e ulët se përqindja e grave të papunësuar. Po kështu përqindja e grave që shpenzojnë kohë minimale për kryerjen e këtyre punëve është dukshëm më e ulët se gratë e papunësuar se sa te gratë e punësuar.

Siç shihet më lartë, vlera Hi-katrorit e llogaritur nga *SPSS-i e Pearson Chi-Square* është $X^2=12,73$, me nivel të lirisë 8. Për arsye se vlera e Asym. Sig. (2-sided) $p=0.12>0.05$, themi se nuk ekziston homogjenitet në mes të grupeve, dhe nëse rishikojmë rezultatet krostabulare mund të themi se statusi i punësimit është faktorë që ndikon në shpërndarjen e grupeve.

Meqë kemi të bëjmë me krahasimin e marrëdhënieve të dy variablave ordinale, asaj të pavarur që është statusi i punësimit dhe asaj të varur, që është koha në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore në familje, për të konfirmuar moseksistencën e homogjenitetit të shpërndarjes së grupeve kemi përdorur koeficientin Kendall TauB. Vlera e TauB është 0.10, çka do të thotë se gratë e

punësuara nuk shpenzojnë kohë të barabartë me gratë e papunësuara për kryerjen e punëve të shtëpisë.

7.3.3 Ndikimi i punësimit në intenzitetin e përfshirjes së burrave në punët e shtëpisë

Kjo hipotezë është analizuar me anë të metodës Hi-Katrori. Me këtë metodë është krahasuar marrëdhënia në mes të statusit të punësimit (e paraqitur me ndihmën e përgjegjjeve në pyetjen e pyetësorit për statusin e punësimit) dhe të kohës së shpenzuar në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore në familje (e paraqitur me ndihmë e përgjegjjeve në pyetjen *Sa kohë brenda javës shpenzoni për të kryer obligime ditore në familje*). Marrëdhëniet në mes të variablave janë analizuar pasi janë menjanuar përgjigjet e grave në pyetjet përkatëse me metodën Select cases. Rezultatet i kemi paraqitur në tabelën në vijim:

Rezultatet e paraqitura në tabelë tregojnë se 75 % e burrave të papunësuar shpenzojnë kohë minimale (më pak se 4 orë në javë) për kryerjen e punëve të shtëpisë ndërsa kohë mesatarisht të ulët shpenzojnë mbi 42 % të burrave të punësuar apo të vetëpunësuar. Mbi 6 orë në javë shpenzojnë afër 30% e burrave të punësuar apo të vetëpunësuar, kurse asnjë burrë i papunësuar nuk shpenzon një kohë maksimale për kryerjen e punëve në familje.

Siç shihet më lartë, vlera Hi-katrorit e llogaritur nga SPSS-i e Pearson Chi-Square është $X^2=7,61$, me nivel të lirisë 8. Për arsye se vlera e Asym. Sig. (2-sided) $p=0.4>0.05$, themi se nuk ekziston homogjenitet në mes të grupeve, dhe nëse rishikojmë rezultatet krostabulare mund të themi se burrat e papunësuar shpenzojnë më pak kohë për përmbushjen e obligimeve ditore në familje se sa burrat e punësuar.

Rezultate të tilla na mundësojnë të themi se makropolitikat adekuate ndikojnë në zbehjen e ideologjisë gjinore për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi në bashkëshortësi. Këtë përfundim na kanë mundësuar:

- ndryshimet në mes të qëndrimit të rinjëve (që janë rritur dhe zhvilluar në periudhën e pasluftës, kur janë krijuar institucionet shtetërore) në lidhje me ndarjen tradicionale të punëve në familje, në krahasim me qëndrimin pozitiv të pjesëmarrësve më të moshuar (që janë rritur dhe formuar në periudhën e paraluftës kur popullësia hezitote të mbështetej në insitucionet e shtetit okupes).

- ndikimi i punësimit në kohën e shpenzuar nga gratë dhe burrat në përmbushjen e obligimeve ditore në familje. Koha e shpenzuar në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore nga gratë e punësuara është më e shkurtur se sa nga gratë e papunësuara, përkundrazi, koha e shpenzuar në funksion të përmbushjes së obligimeve ditore nga burrat e punësuar është më e gjatë se sa nga burrat e papunësuar.

8 PËRFUNDIM

8.1 Konkludime

Qëllimi i këtij studimi ishte paraqitja e përceptimeve të bashkëshortëve dhe OJQ-ve në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare, gjë që na ka shtyer që në mënyrë të veçantë të trajtojmë ndikimin e ideologjisë gjinore në ndarjen e punëve sipas roleve gjinore në familje dhe e politikave të ndërmarra kombëtare për çrënjosjen e kësaj ideologjie.

Rezultatet e hulumtimit kanë treguar se:

- Në shoqërinë kosovare vërehen elemente të sistemit patriakal që manifestohen me ideologji të fortë gjinore për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve në familje;
- Ideologjia gjinore është bariera kryesore që i pengon burrat të kontribuojnë në punët e shtëpisë dhe në kujdesin për fëmijë;
- Gratë i janë nënshtruar rendit patriakal, si pasojë e të cilit, sakrifikimi i karrierës së nënave kosovare ka vlera të larta morale dhe çdo sjellje e ndryshme karakterizohet si egoizëm dhe mungesë empatie për bashkëshortin dhe familjen e tij;
- Në Kosovë nuk respektohet mjaftueshëm barazia gjinore;
- Gratë janë më të diskriminuara në raport me burrat. Ato kryejnë 82% të punëve që tradicionalisht njihen si punë grashë, përfshirë edhe kujdesin ndaj fëmijëve, me të cilin ngarkohen edhe me ligj;

- Ndërpërfaqësimi i grave në tregun e punës dhe ligji në fuqi për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror, tregojnë se shteti vazhdon të mbështes ndarjen e punëve në sferën private (për gra) dhe publike (për burra).
- Politikat në nivel makro për çrrënjosjen e ideologjisë gjinore për ndarjen tradicionale të punëve në mes të bashkëshortëve ndikojnë në nivelet mikro të familjeve.
- Punësimi i grave ndikon drejtpërdrejtë në kohën e shpenzuar nga ato për të kryer punë në familje, si dhe në dozën e kundërshtimit ndaj ndarjes tradicionale të punëve në familje dhe etiketimit të grave të punësuar si nëna të këqija.

8.2 Rekomendime

Barazia gjinore në familje dhe shoqëri nuk arrihet pa mposhtjen e regjimit patriakal, që në Kosovë manifestohet me ideologji të fortë gjinore për mënyrën e ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësisë në mes të bashkëshortëve në familje. Mposhtja e këtij regjimi mund të bëhet vetëm me anë bashkëpunimit midis çdo institucioni publik apo privat, përfshirë edhe organizatat joqeveritare dhe mjetet e informimit. Disa nga makro-politikat që duhet të ndërmerren janë:

- Qeveria duhet të organizojë një plejadë për inkuadrimin masiv të grave në tregun e punës.
- Plejada për inkuadrimin masiv të grave në tregun e punës duhet të bëhet pjesë e programit të qeverisë qendrore dhe të qeverive lokale, në mënyrë që në të gjithë vendin të hapen më shumë kopshte publike për fëmijë dhe të krijohen qendra për kujdesë ditorë. Hapja e këtyre institucioneve që do të ndihmojë në zhdukjen e barrierave që i privojnë gratë nga e drejta për pjesmarrje në jetën publike për shkak të obligimeve në familje, si dhe kontribuojnë në zhdukjen e mendësisë së shoqërisë se ndërprerja e karrierës në të mirë të familjes është obligim i secilës grua;
- Pjesë e programit të plejadës për inkuadrimin masiv të grave në tregun e punës duhet të jetë rishikimi dhe riformulimi i ligjit për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindërorë, i cili duhet t'i detyrojë të dy prindërit të kujdesen në mënyrë të barabartë për fëmijët deri në moshën 1 vjeçare;
- Në ligjin për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindërorë duhet të rishikohet edhe mënyra e mbulimit të pagave, në mënyrë që të stimulohen punëdhënësit të punësojnë punonjës

potencial për tu bërë prindër dhe të mos ngarkohen me mbulesë të një pjese të pagave gjatë periudhës së pushimit prindëror;

- Përderisa është vërtetuar se pjesmarrja më e madhe e popullësisë në institucionet shoqërore, arsimore dhe politike ndikon në zbehjen mbështetjes së shoqërisë në ligjet zakonore, si dhe në zbehjen e ideologjisë gjinore për ndarjen e detyrave në familje, Ministria e Arsimit, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale duhet të krijojë programe, ku do të promovohet barazia gjinore dhe do të kundërshtohet ndarja e punëve sipas roleve gjinore në shoqëri.
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë duhet të rishikojë tekstet mësimore dhe të zëvendësojë përmbajtjet që promovojnë rolet gjinore sipas ideologjisë borxheze të familjes. Ajo duhet të organizojë seminare dhe trajnime edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuere për edukatorët/ mësimdhënësit në lidhje me formën e trajtimit të fëmijëve dhe të rinjëve pa diferenca gjinore.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit duhet të organizojë shfaqje teatrale kundër seksizmit, roleve gjinore dhe shoqërisë patriakale.
- Mjetet e informimit/mediat, përmes programeve të ndryshme televizive duhet të promovojnë barazinë gjinore, duke inkuadruar gratë në emisionet e sportit, duke ftuar gra police apo shofere, si dhe burra edukator apo kuzhinier të prezantojnë përvojat e tyre.

8.3 Kufizimet e studimit dhe rekomandime për hulumtime të mëtutjehme

Meqë hulumtimi në fjalë është bërë në qendra urbane, ku popullsia ka qasje në institucionet arsimore, kulturore e sociale, hulumtimi nuk përfshinë të dhëna për popullsinë e viseve të largëta rurale, prandaj mungojnë të dhënat për mënyrën e ndarjes së punëve në mes të bashkëshortëve në familjet që jetojnë në viset rurale, ndikimin e punësimit, arsimimit dhe e strukturës familjare në ndarjen e punëve në familjet e viseve rurale dhe për dozën e ideologjisë gjinore për ndarjen e punëve në familjet e këtyre viseve. Për të parë se cilat mekanizma do të ndihmonin në arritjen e barazisë gjinore në këto vise, rekomandohet të bëhet një hulumtim i veçantë, ku përzgjedhja e pjesëmarrësve do të bëhet në fshatra të largët, banorët e të cilëve nuk kanë qasje në qendrat socio-kulturore në vend.

8.4 Përmbledhje

Në këtë punim kemi bërë një përmbledhje të studimeve të deritashme në lidhje me mënyrën e ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësive në mes të bashkëshortëve, si në shtetet e zhvilluara, ashtu edhe në shtetet në zhvillim. Duke trajtuar studimet e tilla kemi parë se punët në familje nuk ndahen në mënyrë simetrike dhe se barra e kryerjes së këtyre punëve u bie grave si diçka e qenë dhe e pakontestueshme. Duke dashur të paraqesim përceptimin e bashkëshortëve dhe të OJQ-ve në lidhje me ndarjen e përgjegjësive në mes të bashkëshortëve në familje, vëmendje të veçantë u kemi kushtuar studimeve në lidhje me ndikimin e ideologjisë gjinore, që vlerësohet si faktori kryesor që ndikon në mënyrën e ndarjes tradicionale të punëve në familje, si dhe studimeve në lidhje me ndikimin e makro politikave shtetërore në largimin e grave nga punët në sferën private të familjes dhe inkuadrimit të burrave në këtë sferë.

Pas krahasimit të studimeve nëpër vende të ndryshme kemi ardhur në përfundim se në vendet në zhvillim, ku nuk vërehet përpjekje institucionale për zhdukjen e roleve gjinore në familje, ideologjia gjinore për ndarjen e përgjegjësive në familje është shumë më e theksuar se sa në shtetet e zhvilluara, ku prej kohësh implementohen politika të ndryshme, si: inkuadrimi masiv i grave në tregun e punës, që ka ndikuar në minimizimin e kohës së shpenzuar nga ana e tyre për të kryer punë të shtëpisë; kuotat e babait dhe pushimi i atësisë, që kanë ndikuar në angazhimin e burrave jo vetëm në kujdesin për fëmijë, por edhe në punët e shtëpisë, etj. Meqë shteti i Kosovës deri tani ka pasur përpjekje për të luftuar diskriminimin gjinor në familje dhe shoqëri, implementimi i politikave të tilla është pjesë qenësore e programit të shumë OJQ-ve, që po japin kontribut të madh në zhdukjen e ideologjisë gjinore për ndarjen e punëve në familje, përkatësisht zhdukjen e stereotipave gjinor dhe të roleve gjinore në familje që manifestohet me ndarjen e sferave të veçanta për burrat dhe gratë.

Mungesa e implementimit të politikave të tilla nga ana e shtetit, sipas rezultateve të këtij punimi manifestohet me një ideologji të theksuar për ndarjen tradicionale të punëve në familje. Shprehja e hapur e qëndrimit pozitiv të burrave për ndarjen tradicionale të punëve në familje kurse qëndrimi negativ i grave për një ndarje të tillë, por shprehja e hapur e hezitimit të tyre për tu shoqëruar me përfaqësuese të OJQ-ve që ngrisin zërin kundër pabarazisë gjinore dhe etiketimi i tyre si llafazane, flet për preferencën e grave për t'iu nënshtruar rregullave shoqërore në lidhje me rolet gjinore në familje dhe shoqëri. Pra, burrat kosovar shprehin lirshëm qëndrimin e tyre pro ideologjisë gjinore

për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në familje, kurse gratë preferojnë të shprehin lirshëm hezitimin e tyre për të ngritur zërin kundër diskriminimit gjinor, edhe pse kanë qëndrim negativ në lidhje me të.

Si pasojë e kësaj ideologjie gratë në Kosovë me vetëdije sakrifikojnë karrierën, vendin e tyre në shoqëri, etj. në të mirën e përgjithshme të familjes. Kjo ideologji ka bërë që një sakrificë e tillë të ketë vlera të larta morale dhe secila sjellje e ndryshme të cilësohet si mungesë humaniteti e empatie.

Ideologjia me nuanca kaq të forta gjinore, nuk është vetëm pasojë e okupimit të gjatë dhe shtetëndërtimit të vonë, por edhe e makro-politikave, ndër të cilat kemi veçuar ligjin për pushimin e lehonisë në fuqi, mungesën e kapacitetit në kopshtet publike për fëmijë apo mungesën e plotë e tyre (në komuna të caktuara), si dhe politikat e pranimit të fëmijëve më të moshuar se një vit në kopshtet përkatëse, që po vazhdonjë të kontribuojë në krijimin e roleve gjinore dhe diskriminimin gjinor në familje.

Vet përjashtimi me ligj i baballarëve nga përgjegjësia e kujdesit për fëmijë dhe përgjegjësia ligjore e punëdhësve për të mbuluar pagën mujore të nënave, për një periudhë të caktuar gjatë pushimit të lehonisë, vazhdon të kontribuojë në rritjen e barrierave për inkuadrimin e grave në tregun e punës.

Ndikimi i mekanizmave të tilla, por edhe i ideologjisë për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësive në mes të bashkëshortëve në familje vërehen në ndarjen joproportionale të punëve në familjet kosovare. Edhe pse kemi vërejtur një tendencë të burrave për tu përfshirë në punë grashë (larja e enëve, gatimi, etj.) dhe një tendencë të grave për tu përfshirë në punë burrash (pjakja në zgarë, kositja e barit, ngasja e automjetit, etj.), në përgjithësi, ndarja e punëve në mes të bashkëshortëve kosovarë është tradicionale, që karakterizohet me mospjesmarrje të burrave në shumicën e punëve të shtëpisë, e sidomos në kujdesin për fëmijë dhe të moshur, 90% e të cilëve, në mungesë të grave, janë në gjendje t'i kryejnë të gjitha obligimet apo shumicën prej tyre, por prezenca e gruas në shtëpi (bëhet fjalë për 81% të grave që nuk janë aktive në tregun e punës) i bën ata të kënaqen me privilegjin e të qenit burrë.

Në këtë punim kemi vërejtur se makro politikat e duhura ndikojnë në zbehjen e roleve gjinore në shoqëri. Gratë e punësuar shpenzojnë 1 deri në 3 orë në javë më pak për të kryer punë të shtëpisë

se sa gratë e papunësuar, statusi i punësimit ndikon edhe në qëndrimin më negativ të tyre për ndarjen tradicionale të punëve në familje dhe qëndrimin më pozitiv të tyre për futjen e pushimit të atësisë në ligjin e punës. Në këto qëndrime ndikon edhe niveli i tyre i arsimimit. Mbetet të shihet se si do të ndikojë pushimi i atësisë në angazhimin e burrave në punët e shtëpisë, sepse, siç kemi vërejtur në këtë punim statusi i punësimit nuk ka ndikim në angazhimin e tyre në shtëpi. Burrat e papunësuar nuk shpenzojnë më shumë kohë për të kryer punë të shtëpisë se sa burrat e punësuar, përkundrazi. Statusi i punësimit ndikon në krijimin e qëndrimin më negativ të tyre për ndarjen tradicionale të punëve në familje, por jo edhe në qëndrimin pozitiv të tyre në lidhje me futjen e pushimit të atësisë në tregun e punës.

Se ata kanë besim në mosshembjen e ideologjisë në lidhje me kujdesin për fëmijë, flasin përgjigjet të pyetjen e fundit të pyetësorit, ku vërehet parapërqimi i burrave për tu futur në fuqi ndarja e pushimit prindërorë përmes marrëveshjes në mes të prindërve, çka do të thotë se burrat janë të vetëdijshëm se gratë do të hezitojnë të luftojnë për pozitën e tyre në sferën publike dhe do të përziejdhin vendin e rezervuar për to – shtëpinë.

Në këtë punim kemi vërejtur se OJQ-të e njohin mirë problematikën e nënshtrimit të grave përballë rregullave shoqërore, për këtë arsye këmbëngulin që të krijohen makro-politika përmes të cilave i sigurohet gëzimi i të drejtave të barabarta, duke mos iu kërkuar sakrificat e vendit të tyre në sferën publike të shoqërisë.

9 LITERATURA

1. Abazi Morina, L. et al. (2017). Joaktiviteti i grave në tregun e punës: Faktorët që mbajnë gratë jashtë tregut të punës. Prishtine: D4D
2. Akanle, O. & Adesina, J. O. & Ogbimi, A.O. (2016). Men at Work Keep-Off: Male Roles and household Chores in Nigeria. *Gender & Behaviour*, 14 (3), 2016, 7833-7854. E qashme në: https://www.researchgate.net/publication/315046640_Men_at_Work_Keep_Off_Male_Roles_and_Household_Chores_in_Nigeria

3. Burkeman, O. 2017. Dirty secret: why is there still a housework gender gap?. The guardian. 17. Februar 2017. Qasja në link: <https://www.theguardian.com/inequality/2018/feb/17/dirty-secret-why-housework-gender-gap>
4. Claire M. & Miles G. (2012). Trajectories of Marital Conflict Across the Life Course: Predictors and Interactions With Marital Happiness Trajectories. J Fam Issues. 2012 Mar 1; 33(3): 341–368. DOI: 10.1177/0192513X11409684
5. Coleman, M. & Lawrence H. G. 2004. Handbook of contemporary families: considering the past, contemplating the future. California: Sage Publications.
6. Connelly, R., & Kimmel, J. (2009). Spousal influences on parents' non-market time choices. Review of Economics of the Household, 7(4), 361–394.
7. Crompton, R. 2006. Employment and the family: The reconfiguration of work and family life in contemporary societies. Cambridge: Cambridge university press.
8. Crossman, Ashley. 2020. The Definition of Marriage in Sociology. Qasja në: <https://www.thoughtco.com/marriage-3026396>
9. Dermott, E. 2008. Intimate fatherhood: A sociological analysis. London: Routledge.
10. Edwards, R. 2012. Key Concepts in Family Studies. London: Sage Publications. DOI: <http://www.uk.sagepub.com/booksProdDesc.nav?prodId=Book228813&>
11. Elezi, P. 2018. Faktorët që ndikojnë në krijimin e hendekut gjinor në punët shtëpiake tek fëmijët. Revista Kërkimi. Tiranë, Nr. 1/2018
12. Fursman, L. & Callister, P. (2009). Men's participation in unpaid care. Department of Labour dhe Ministry of Women's Affairs. New Zeland
13. Hochschild, A. dhe Machung, A. (2012). The Second Shift: Working Families and the Revolution at Home. Në York: Penguin Publishing Group.
14. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2015). 'Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore'. Neni 17 (2). E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>
15. Hakim, Ch. 2004. *Key issues in women's work: Female diversity and the polarization of women's employment*. London: The Glass House press.

16. Hook, J. (2006). Care in context: Men's unpaid work in 20 countries, 1965–2003. *American Sociological Review*, 71, 639–660.
17. How Europeans spend their time everyday life of women and men: Data 1998-2002: European Communities, 2004
<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3930297/5953614/KS-58-04-998-EN.PDF/c789a2ce-ed5b-4a0c-bcbf-693e699db7d7?version=1.0>
18. Geist & Cohen, 2011. Work—family balance: An analysis of European, Japanese, and US work-time policies (Briefing Paper No. 189). Washington, DC: Economic Policy Institute.
19. Juan F., M. Ángeles Q., Sergio E. dhe Jesús P. (2016). The gendered division of housework; në: *Psicothema*, Vol. 28, No. 2, f. 130-136 DOI: 10.7334/psicothema2015.169
20. Kërqeli. 2017. Ndryshimi i paradigmës Barazi përmes lejes prindërore, Instituti kërkimor Demokraci për Zhvillim Seria: Interesi publik, Nr. 13, Prishtinë, 2017, Qasja në: https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D_PI_13_SHQ_WEB.pdf
21. Kotsadam, A. & Finseraas, H. 2011. The state intervenes in the battle of the sexes: Causal effects of paternity leave, *Social Science Research*, Vol. 40, Iss. 6.
22. Luke, N., Xu, H., & Thampi, B. V. (2014). Husbands' Participation in Housework and Child Care in India. *Journal of marriage and the family*, 76(3), 620–637. <https://doi.org/10.1111/jomf.12108>
23. Nizam Ud D., Xinsheng Ch. & Shama N. (2018) Women's skills and career advancement: a review of gender (in)equality in an accounting workplace, *Economic Research-Ekonomska Istraživanja*, 31:1, 1512-1525, DOI: <https://doi.org/10.1080/1331677X.2018.1496845>
24. Kamberi, F. 2017. Roli dhe ndryshimet strukturore të familjes shqiptare. Në: *Gazata Impakt*, 11. Maj 2017
25. McGinn , K. L. & Ruiz Castro, M. 2015. Mums the Word! Cross-national Effects of Maternal Employment on Gender Inequalities at work and at Home. Harvard Busines School. Qasja përmes: https://ëëë.med.uni-muenchen.de/einrichtungen/fb_mentoring/dateien/kinder-berufstaetige-frauen.pdf

26. Latifi, T. 2016. Family, Kinship Relations and Social Security in Kosovo: The Case Study of Isniq. Preliminary Project Report of the FĚF Project “The Kosovar Albanian Family Revisited” DOI: [10.13140/RG.2.1.3517.2720](https://doi.org/10.13140/RG.2.1.3517.2720)
27. Ligji i ri i aprovuar në vitin 2015 nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Gazeta zyrtare e Republikë së Kosovës nr. 16/26 Qershor 2015
28. Noonan, M. 2013. The Impact of Social Policy on the Gendered Division of Housework. *Journal of Family Theory & Review*, June 2013 DOI: 10.1111/jftr.12008
29. Rrahmani, Gresë. 2020. Ligji për barazinë gjinore në Kosovë: Analiza e përmbajtjes, vlerësimi i zbatimit dhe hapat e ardhshëm, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP). Qasja në: https://indep.info/wp-content/uploads/2020/06/INDEP_Ligji-p%C3%ABr-Barazin%C3%AB-Gjinore-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-Analiza-e-P%C3%ABrmbajtjes-Vler%C3%ABsimi-i-Zbatimit-dhe-Hapat-e-Ardhsh%C3%ABm_06022020.pdf
30. Rrjeti i Grave të Kosovës. 2017. Buxhetimi për Përmirësimin e Barazisë Gjinore në Programet për Diasporën. Qasja në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20171117095149559.pdf>
31. Shalter, B. A. 2006. Gender and unpaid work. *Handbook for sociology and social research*, 375-390.
32. Švab, A. 2001. Družina: od modernosti k postmodernosti; Znanstveno in publicistično središče, Ljubljana (zbirka Sodobna družba).
33. Tamm, M. 2018. Fathers' Parental Leave-Taking, Childcare Involvement and Mothers' Labor Market Participation. IZA Discussion Papers 11873, Institute of Labor Economics (IZA).
34. Vandeweyer, J., & Glorieux, I. (2008). Men taking up career leave: An opportunity for a better work and family life balance? *Journal of Social Policy*, 37(2), 271–294.
35. Van der Lippe, T. (2010). *Women’s employment and housework*. Stanford, CA: Stanford University Press.

9.1 Burimet nga interneti

1. ASK. 2019. Statistikat e lindjeve 2019. Qasja në: <https://ask.rks.gov.net/media/5455/statistikat-e-lindjeve-2019.pdf>
2. "Career and Family . "Encyclopedia of Small Business". Retrieved October 16, 2020. Qasja në: Encyclopedia.com: <https://www.encyclopedia.com/entrepreneurs/encyclopedias-almanacs-transcripts-and-maps/career-and-family>
3. "Family Roles ." International Encyclopedia of Marriage and Family. . Retrieved October 16, 2020. Në: Encyclopedia.com: <https://www.encyclopedia.com/reference/encyclopedias-almanacs-transcripts-and-maps/family-roles>
4. "Gender Roles ." Encyclopedia of Sex and Gender: Culture Society History. . Retrieved October 16, 2020. Qasja në: Encyclopedia.com <https://www.encyclopedia.com/social-sciences/encyclopedias-almanacs-transcripts-and-maps/gender-roles>
5. Hasani, N. 2019. Punët e nënave. Koha Ditore, 8 mars 2019. Qasja në: http://kgscenter.net/site/assets/files/1702/koha_per_grate_2019.pdf
6. Hernmarck Ahliny, K. 2020: Feminizmi familjar. Në: koha ditore. Koha për gratë, Prishtinë 7. 03. 2020. Qasja në: <http://kgscenter.net/site/assets/files/1758/koha-per-grate-finale.pdf>
7. Nushi, V. 2020. Barazia gjinore nuk është “çështje e grave” - u përket të gjithëve. Ne: koha ditore. Koha per grate, Prishtine 7. 03. 2020. Qasja në: <http://kgscenter.net/site/assets/files/1758/koha-per-grate-finale.pdf>
8. Planprogrami për të Drejtat e Grave. 2014. Qasja në: <https://www.ecmikosovo.org/uploads/Ëomens-Rights-Curriculum-for-students-Albanian1.pdf>
9. Riinvest, 2017: Çka nëse puna e papaguar do të paguhej? Qasja në: <https://www.riinvestinstitute.org/Al/riinvest-story/241/cka-nese-puna-e-papaguar-do-te-paguhej/>
10. Riinvest, 2017. Ndarja e punëve shtëpiake dhe pavarësia ekonomike si mjet fuqizimi. Qasja në: <https://www.riinvestinstitute.org/Al/riinvest-story/247/ndarja-e-puneve-shtepiake-dhe-pavaresia-ekonomike-si-mjet->

[fuqizimi/?fbclid=IëAR3YUx-9fL8sHvK5iyH0iRNnUPvGKIJaxJJqFxlqEëcaaqZjtv2pr2nb2Uo](https://www.facebook.com/fuqizimi/?fbclid=IëAR3YUx-9fL8sHvK5iyH0iRNnUPvGKIJaxJJqFxlqEëcaaqZjtv2pr2nb2Uo)

11. Rekomandimi KM/Rek (2019). Parandalimi dhe luftimi i seksizmit. Miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës 27 mars 2019. DOI: <https://rm.coe.int/cm-rec-2019-preventing-and-combating-sexism-albanian-/168097f2b0>
12. The British Sociological Association. 2017. "Statement of Ethical Practice" Qasja në: https://www.britsoc.co.uk/media/24310/bsa_statement_of_ethical_practice.pdf
13. "Work and Family ." International Encyclopedia of Marriage and Family. Retrieved August 11, 2020 from Encyclopedia.com: Qasja në: <https://www.encyclopedia.com/reference/encyclopedias-almanacs-transcripts-and-maps/ëork-and-family>
14. Zogjani, Valeza. 2020. Leje prindërore për barazi gjinore. Koha Ditore. 7 mars 2020. Qasja në: <http://kgscenter.net/site/assets/files/1758/koha-per-grate-finale.pdf>

Shtojcë

Shtojca I: Pyetësori

Të nderuar!

Ju drejtohem me kërkesë që të ofroni përgjigjet tuaja të çmuara në lidhje me mënyrën e ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësi në mes të bashkëshortëve në familjet kosovare.

Përgjigjet tuaja janë të rëndësishme për mua dhe do të më ndihmojnë ta përfundoj punimin tim të masterit me titull "Përceptimet e bashkëshortëve dhe të OJQ-ve për ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi në bashkëshortësi".

Me respekt, Bjondina Çanta

I – Të dhënat bio-sociale

1. Gjinia

- Femër
 - Mashkull
- (Rrumbullakso vetëm a ose b)

2. Moshë

- a) 8-24 vjeç
 - b) 25-34 vjeç
 - c) 35-44 vjeç.
 - d) 45-54 vjeç
- .(Rrumbullakso vetëm a, b, c ose d)

3. Niveli i Juaj arsimor:

- a/ Shkollimi i mesëm
- b/ Studimet Bachelor
- c/ Studimet master
- d/ Phd

(Rrumbullakso vetëm a, b, c ose d)

4. Statusi i punësimit

- I/e punësuar
- I/e vetëpunësuar
- I/e papunësuar

5. Struktura e familjes ku jetoj:

- Familje me dy ose më shumë bërthama (partneri, fëmijët. Kunati/kunata me parnterin/en e tij/saj)
- Familje e zgjeruar (partneri, fëmijët, prindërit e mi apo të parnerit/partneses)
- Familje bërthamore (partneri dhe fëmijët)

II – Pyetje për objektin e hulumtimit:

1. Rrumbullakosni qëndrimin tuaj në lidhje me pyetjet në vijim:

Pyetjet	Pajtohem plotësisht	Partoem	I/e papërcaktuar	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
A pajtoheni me faktin se ndarja tradicionale e punëve sipas modelit: <i>Burri punon për të siguruar mirëqenien ekonomike të familjes dhe gruaja kryen punët e shtëpisë është e drejtë ?</i>					
A mendoni se kujdesi për fëmijën nga ana e nënave të punësuar është më i mangët se kujdesi nga nënat që nuk punojnë?					

A pajtoheni që në ligjin e punës të futet pushimi i atësisë dhe baballarët të kujdesen për foshnjat, nëse nëna ka kontratë pune të cilën nuk mund ta ndërpres?					
--	--	--	--	--	--

2. Ju lutem përcaktoni intenzitetin e përfshirjes suaj në obligimet ditore në familje duke vendosur një tik \sqrt vetëm në njërin nga optionet e ofruara në anën e djathtë të tabelës, prej Gjithnjë, e deri te opcionit Kurrë:

Aktivitetet	Gjithnjë	Shpeshherë	Herë pas here	Në raste të veçanta	Rrallë	Kurrë
Gatimi						
Larja e enëve						
Pastrimi i oborrit						
Pastrimi i shtëpisë						
Sistemimi dhe palimi i rrobave						
Kujdesi për rregullin në shtëpi						
Kujdesi për fëmijët						
Kujdesi për të moshuarit në familje						
Përgatitja e listave të blerjeve javore / mujore						
Bërja e pazareve						
Pjekja në zgarë						
Ndërrimi i gomave/vajit të automobilin						
Larja e automobilin						
Sinkronizimi i TV/së						

Rregullimi i bravave të dyerve/ çelësave						
Kositja e barit						
Sistemimi dhe palimi i rrobave të anëtarëve të familjes						
Hekurosja						
Ngasja e automobilit për nevoja të familjes						

3. Sa orë brenda javës shpenzoni për të kryer këto punë?

- a) Deri në 2 orë
- b) Mbi 2-4 orë
- c) Mbi 4-6 orë
- d) Mbi 6-8 orë
- e) Mbi 8 orë

(Rrumbullakos vetëm a, b, c, d ose e)

4. Në hapësirën para aktiviteteve përcaktohuni nga një (aktivitet shumë i rëndësishëm) deri në dhjetë (aktivitet më pak i rëndësishëm) se sa jeni të angazhuar në kujdesin për fëmijët, kur bëhet fjalë për:

- _____ Larjen (nga një deri në dhjetë)
- _____ Ushqyerjen (nga një deri në dhjetë)
- _____ Ndërrimin e pelenave (nga një deri në dhjetë)
- _____ Shetitjen në park apo lodra për fëmijë (nga një deri në dhjetë)
- _____ Tregimin e përrallave para gjumit (nga një deri në dhjetë)
- _____ Dërgimin në çerdhe dhe marrjen, ndihmën në mësim (nga një deri në dhjetë)
- _____ Ushqimin apo kujdesin gjatë natës (nga një deri në dhjetë)
- _____ Sigurimin e mirave materiale për rritjen e fëmijës (nga një deri në dhjetë)

5. Kur partneri/partnerja nuk është në shtëpi, si ia bëni me aktivitetet, në të cilat nuk jeni përgjigjur me dhjetë (aktivitet më pak i rëndësishëm)?

- Të gjitha aktivitetet i kryej vetëm
- Aktivitetet e domosdoshme për tu kryer, i kryej vetëm
- Thërras ndonjë familjar timin/parterit/partneres për ndihmë
- Thërras dadon për ndihmë
- Partneri/partnerja bënë zgjidhje para se të bëjë plane për të ikur nga shtëpia

9. Cila nga fjalitë e mëposhtme mendoni se janë më të drejta në lidhje me pushimin prindërorë?

- Në moshën 1-6 muaj vetë nëna është në gjendje të kujdeset për fëmijën.
- Mundësia e zgjedhjes se cili prind ta shfrytëzojë pushimin prindëror është më e drejtë.
- Mundësia e ndarjes së pushimit 40-60% të orarit të plotë në mes të prindërve është më e drejtë.

Shtojca II – Protokoli i Intervistimit

Përshëndetje,

Qudem Bjondina Çanta, studente e Fakultetit të Edukimit, drejtimi Pedagogji e Përgjithshme. Aktualisht po kryej punimin e masterit në lidhje me ndarjen e të drejtave dhe të përgjegjësive në mes të bashkëshortëve, prandaj kam nevojë për përgjigjet tuaja në disa pyetje përkitazi me temën që po trajtoj. Përgjigjet tuaja do të përdoren vetëm për arsye studimore dhe të njejtat do të mbeten konfidenciale. Në disa raste do të evidentoj vetëm inicialet tuaja për të vërtetuar origjinalitetin e intervistës.

I Administrimi i intervistimit:

1. A pranoni ta zhvillojmë bashkë këtë intervistë.

a) Po

b) Jo

2. Niveli i arsimit: _____

3. Pranoni që përgjigjet në pyetjet vijuese të regjistrohen? _____

4. Intervistimi sygjeroni të bëhet me datën: _____, në orën: _____, në lokacionin: _____.

II Të kuptuarit e rolit gjinorë

1. Si mendoni, cilat janë karakteristikat gjinore të një burri dhe të një gruaje në shoqërinë tonë?

2. Çfarë mendoni, a ka diskriminim gjinorë në familjet kosovare?

III Dallimi në mes të punës me pagesë dhe asaj pa pagesë

3. A mendoni se, (në shoqërinë tonë), natyra biologjike e të dy gjinive është faktorë që ndikon në ndarjen e punëve sipas gjinisë?

4. A mendoni se përgjegjësitë familjare ndikojnë në ngritjen në karrierë?

4.1. Çfarë mendoni, a ka dallime gjinore në lidhje marrjen përsipër të këtyre përgjegjësive për të lënë menjëherë karrierën?

5. A mendoni se numri më i madh i çerdheve publike dhe i shtëpive të të moshuarve do të ndikonte në punësimin më të madh të grave?

IV Ndarja e të drejtave dhe përgjegjësi në bashkshortësi dhe kujdesi për fëmijët

6. Të drejtat dhe përgjegjësitë e burrit dhe gruas në familjen kosovare, janë të njejta?
7. A mendoni se periudha e gjatë e pushimit të lehonisë ndikon negativisht në karrierën e nënave të reja?
8. Çfarë mendoni në lidhje me të drejtën e babait për shfrytëzimin e pushimit prindërorë në vend të nënës?
9. A mendoni se e drejta e babait për të shfrytëzuar pushimin prindërorë do të ndikonte në angazhimin më të madh të burrave në punët e shtëpisë?